



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2023

Prishtinë, gusht 2024

# Tabela e përmbajtjes

Fjala e Auditorës së Përgjithshme .....	9
Përmbledhja ekzekutive.....	13
<b>Kapitulli I: AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023 .....</b>	<b>19</b>
1. Opinioni i auditimit .....	21
2. Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	22
3. Deficiti buxhetor .....	25
4. Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore .....	27
5. Analiza e buxhetit të shtetit .....	36
5.1. Analiza e të hyrave/pranimeve sipas kategorive ekonomike .....	38
5.2. Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike .....	41
5.3. Analiza e shpenzimeve sipas funksionit.....	49
5.4. Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike .....	50
5.5. Analiza e subvencionimit të Ndërmarrjeve Publike nga buxheti i shtetit.....	52
6. Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe balanceve të fondeve .....	54
7. Pasuritë jo financiare kapitale, jokatitale dhe stoqet.....	55
8. Llogaritë e arkëtueshme .....	58
9. Detyrimet e papaguara dhe kontingjente .....	60
10. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore .....	64
11. Të dhënat e punësimit .....	66
<b>Kapitulli II: AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË.....</b>	<b>69</b>
Përmbledhje e opinionëve, konkluzioneve dhe rekomandimeve .....	71
1. Niveli Qendror .....	73
1.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre .....	73
1.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre.....	74
1.3. Çështje tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë.....	75
1.4. Rekomandimet e dhëna .....	78
2. Niveli Lokal .....	78
2.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre .....	78
2.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre.....	79
2.3. Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë .....	80
2.4. Rekomandimet e dhëna .....	84

<b>3.Ndërmarrjet Publike .....</b>	<b>84</b>
3.1.Opinionet e auditimit dhe çështjet në modifikimin e tyre .....	85
3.2.Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre.....	88
3.3.Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar.....	90
3.4.Çështjet tjera të Menaxhimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë .....	93
3.5.Rekomandimet e vitit 2023 dhe niveli i zbatimit për vitin 2022.....	94
<b>4.Sistemi i auditimit të brendshëm .....</b>	<b>95</b>
<b>Kapitulli III: AUDITIMET E PERFORMANCËS, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PAJTUESHMËRISË .....</b>	<b>97</b>
<b>1.Auditimet e Performances, teknologjisë së informacionit dhe pajtueshmërisë.....</b>	<b>99</b>
1.1.Auditimet e performancës .....	100
1.2.Auditimet e teknologjisë së informacionit .....	112
1.3.Auditimet e pajtueshmërisë.....	115
<b>Kapitulli IV: REKOMANDIMET E AUDITIMIT .....</b>	<b>117</b>
<b>Përmbledhje për zbatimin e rekomandimeve.....</b>	<b>119</b>
<b>1.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2022 .....</b>	<b>119</b>
<b>2.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2022.....</b>	<b>120</b>
<b>3.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës.....</b>	<b>122</b>
<b>4.Ndikimi i auditimit.....</b>	<b>123</b>
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>125</b>
<b>Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2022.....</b>	<b>127</b>
<b>Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës pas shqyrtimit të raporteve të auditimit .....</b>	<b>132</b>
<b>Shtojca III: Llojet e opinionëve për OB-të e audituara në tri vitet e fundit.....</b>	<b>134</b>
<b>Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinionëve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA .....</b>	<b>137</b>
<b>Shtojca V: Letër Konfirmimi/Komentet.....</b>	<b>140</b>
<b>Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë .....</b>	<b>143</b>



## Lista e shkurtesave

<b>AP</b>	Auditori i Përgjithshëm	<b>LIVTh</b>	Llogaria e Vetme e Thesarit
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit	<b>KOSTT</b>	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës	<b>KRPP</b>	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
<b>ARKEP</b>	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	<b>MMPHI</b>	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
<b>ARC</b>	Agjencia e Regjistrimit Civil	<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>AME</b>	Agjencia për Menagjimin e Emergjencave	<b>MAPL</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>ANZH</b>	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim	<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>AQP</b>	Agjencia Qendrore e Prokurimit	<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>BB</b>	Banka Botërore	<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian	<b>ME</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>BERZH</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	<b>NJQH/AB</b>	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
<b>BPV</b>	Bruto Produkti Vendor	<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>BRK</b>	Buxheti i Republikës së Kosovës	<b>NP</b>	Ndërmarrjet Publike
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës	<b>OB</b>	Organizata Buxhetore
<b>BZHKE</b>	Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës	<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>DK</b>	Doganat e Kosovës	<b>PVF</b>	Pasqyrat Vjetore Financiare
<b>GPD</b>	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	<b>ShSKUK</b>	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar	<b>RFV/BRK</b>	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
<b>IFN</b>	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	<b>RVA</b>	Raporti Vjetor i Auditimit
<b>INTOSAI/ ONISA</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit	<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>KA</b>	Komiteti i Auditimit	<b>SIMFK</b>	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
<b>KBFP</b>	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	<b>SNISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

<b>KMFP</b>	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	<b>SNKSP</b>	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>KPMM</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	<b>SISH</b>	Sistemi Informativ Shëndetësor
<b>KASH</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve	<b>SGJC</b>	Sistemi i Gjendjes Civile
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës	<b>TVSH</b>	Tatimi në Vlerën e Shtuar
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	<b>TI</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>LMFPP</b>	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	<b>ZKA</b>	Zyra Kombëtare e Auditimit
<b>LPP</b>	Ligji për Prokurim Publik		







## Fjala e Auditorës së Përgjithshme



Taksapaguesit e vendit tonë, janë kontribuesit kyç që përmes përmbushjes së obligimeve të tyre në baza vjetore sigurojnë buxhetin e shtetit. Ata i mundësojnë qeverisë dhe institucioneve tjera që paratë e tyre t'i përdorin në ofrimin e shërbimeve cilësore në infrastrukturë, shëndetësi, arsim, siguri, sport, kulturë dhe mirëqenie sa më të mirë për qytetarët.

Nevoja dhe rëndësia e madhe që ka përdorimi dhe ruajtja sa më e mirë e parasë dhe pasurisë publike, historikisht e ka nxitur botën, në veçanti atë demokratike për t'i dhënë peshë të veçantë mbikëqyrjes dhe rishikimit të proceseve të menaxhimit të sajë. Ligjet dhe aktet tjera nënligjore kërkojnë nga zyrtarët e ngarkuar për administrimin e parasë publike që përmes punës së tyre të sigurojnë se paratë e taksapaguesve shpenzohen në pajtueshmëri me kornizën ligjore, me efikasitet, efektivitet dhe në të mirë të

qytetarëve. Përderisa, taksapaguesit kanë të drejtë të jenë të informuar në lidhje me atë se ku dhe si po shpenzohen kontributet e tyre financiare. Për këtë arsye, ata kërkojnë nga zyrtarët publik që për veprimet që kryejnë karshi parasë publike të jenë transparent dhe llogaridhënës.

Për t'i dhënë përgjigje të arsyeshme kësaj, në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor kemi kryer auditime në të gjitha institucionet publike, përfshirë Raportin Vjetor Financiar të buxhetit të shtetit. Rezultatet e përgjithshme të këtyre auditimeve janë përfshirë në këtë Raport Vjetor të Auditimit për vitin 2023.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka arritur të përmbush plotësisht planin vjetor për sezonin auditues 2023/2024. Gjatë këtij sezoni janë kryer gjithsejtë 126 auditime për të cilat janë lëshuar raportet e auditimit. Prej tyre, 86 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë janë kryer për organizata buxhetore, 12 të ndërmarrjeve publike, 14 auditime të performancës, nëntë auditime të projekteve të Bankës Botërore, si dhe pesë auditime të pajtueshmërisë. Ndërsa, sezoni i auditimit është përmbyllur me auditimin e Raportit Vjetor Financiar të qeverisë për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Edhe këtë vit, kemi zgjeruar fushëveprimin e auditimit në institucione dhe fusha me interes të lartë publik të cilat nuk ishin audituar nga ZKA vite me radhë. Tri ndërmarrje të mëdha publike me interes për qytetarët, si: Trepça, KOSTT-i dhe K.R.U. "Hidrodrini" janë audituar për herë të parë këtë vit nga ZKA në kontekstin e raportimit financiar.

Po ashtu, duke e ditur rëndësinë e projekteve dhe aktiviteteve që ndërlidhen drejtpërdrejt me rritjen e mirëqenies së qytetarëve, theks i veçantë i është dhënë auditimeve të performancës. Auditimet janë fokusuar në; shërbime shëndetësore, menaxhimin e pronave publike, licencimin e mediave, sponsorizimin e sportit, menaxhimin e sistemeve të TI-së dhe sigurinë e informacioneve, në prokurimin publik dhe fusha të tjera më rëndësi.

Bazuar në rezultatet e auditimit, unë nxis zyrtarët përgjegjës që të kenë vëmendje më të theksuar në menaxhimin e pronave publike për të cilat auditori ka vënë në pah parregullsi, në shitje, shpronësime, po ashtu edhe në dhënien më qira. Një numër kontratash për projekte kapitale janë nënshkruar në mungesë të fondeve, por edhe pa u miratuar këto fonde me ligj. Kjo e kërcënon dëmtimin e buxhetit të shtetit nga kosto shtesë të pa planifikuara, ndërsa mungesa e kontrolleve në këto projekte mund të rezultojë edhe në keq menaxhim të tyre. Prokurimi publik dhe menaxhimi i kontratave vazhdon të mbetet sfidë për institucionet publike. Ka nevojë të përmirësohet procesi i menaxhimit të listës së pritjes së pacientëve në sistemin shëndetësor. Procesi i sponsorizimit të sportit në Kosovë duhet të rishikohet dhe të evitohen parregullsitë e evidentuara. Ndërsa edhe fusha e menaxhimit të teknologjisë së informacionit dhe siguria e saj kërkojnë vëmendje nga bartësit e institucioneve. Menaxhimi i sistemit e-edukimi, sistemit të menaxhimit të stokut farmaceutik dhe sistemi i ujësjellësit rajonal Prishtina janë disa nga sistemet e TI-së tek të cilat kemi gjetur mangësi.

Për sa i përket auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë, duhet theksuar se cilësia e raportimit financiar ende ka nevojë për përmirësime si në nivel të organizatave buxhetore ashtu edhe tek ndërmarrjet publike.

Sfidë edhe më tutje mbetet kryerja e transaksioneve dhe aktiviteteve në përputhje me kornizën ligjore, klasifikimi adekuat i shpenzimeve, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive, detyrimeve të pa paguara, procedurat e prokurimit dhe menaxhimi i kontratave, rritja e llogarive të arkëtueshme.

Forcimi i kontrolleve të brendshme është më se i nevojshëm në menaxhimin e projekteve infrastrukturore për të siguruar që ato udhëhiqen në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Tek ndërmarrjet publike, menaxhimi dhe zvogëlimi i humbjeve kishte përmirësim të dukshëm për vitin 2023, mirëpo sfidë mbetet forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrolleve në Ndërmarrjen Publike Trepça.

Për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e proceseve kemi dhënë 817 rekomandime në vitin 2023. Megjithatë, rekomandimet e auditimit të dhëna në vitin 2022 janë zbatuar vetëm 46% e tyre, duke pësuar rënie për 3% krahasuar me vitin paraprak. Kjo për mua si Auditore e Përgjithshme tregon mungesën e veprimeve të mjaftueshme përmirësuese nga krerët e institucioneve. Sidoqoftë, më inkurajon fakti se një situatë më e mirë është tek ndërmarrjet publike, ngase 58% e tyre janë zbatuar tërësisht.

Në lidhje më këtë, ftojë krerët e institucioneve publike të rrisin përgjegjshmërinë dhe kujdesin në administrimin e pasurisë publike me qëllim që kundërvlera e tyre t'i kthehet qytetarëve në rritjen e mirëqenies së tyre. Ndërsa, inkurajojë Kuvendin e Republikës së Kosovës që të luaj një rol më proaktiv duke shfrytëzuar rezultatet tona të auditimit për t'i mbajtur llogaridhënës administruesit e pasurisë publike.

Auditorja e Përgjithshme,  
Vlora Spanca

*Prishtinë, Gusht 2024*





## Përmbledhja ekzekutive

Në përputhje me mandatin kushtetues, ligjor dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë sezonit auditues 2023/2024 ka kryer 126 auditime për të cilat janë lëshuar raportet përkatëse të auditimit. Prej tyre, 86 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë janë kryer për organizata buxhetore, 12 auditime të ndërmarrjeve publike, nëntë (9) auditime të projekteve të Bankës Botërore dhe donatorëve tjerë, pesë (5) auditime të pajtueshmërisë (prej tyre tre me informata të klasifikuara me nivel të kufizuar) si dhe 14 auditime të performancës. Gjithashtu kemi kryer, auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për Buxhetin e Kosovës.

Rezultatet e auditimeve janë prezantuar në Raportin Vjetor të Auditimit mbi ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës. Ky raport përgatitet në bazë të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ky raport, për Kuvendin, Qeverinë dhe palët e tjera të interesit paraqet:

- Opinionin e Auditorit lidhur me faktin nëse deklaratat financiare japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë;
- Deklaratën lidhur me kufirin e deficitit buxhetor dhe me kushtet dhe kërkesat ligjore; dhe
- Rezultatet e auditimit që përfshijnë konkluzionet dhe rekomandimet të rëndësishme nga të gjitha auditimet e kryera gjatë sezonit auditues që mbulon vitin 2023/2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

**Deklarata e pajtueshmërisë për deficitin buxhetor** - Kufiri i deficitit buxhetor gjatë vitit 2023 ishte në kuadër të limiteve të përcaktuara ligjore dhe nga realizimi i buxhetit vërehet se niveli i inkasimit të të hyrave ishte përmirësuar dhe ishte ulur kërkesa për financim. Për vitin 2023, deficitin i përgjithshëm i përlllogarit sipas buxhetit me rishikim ishte -205,959,000€ apo -2%. Po ashtu, nga auditimi vërehet që në fund të vitit sipas realizimit kishte suficit në vlerë prej 52,928,000€ apo 0.54% e BPV-së.

**Planifikimi dhe realizimi i buxhetit** - Sipas trendit historik të tri viteve të fundit vërehet se pranimet dhe pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Projeksionet fillestare dhe finale për të hyrat/pranimet sipas buxhetit për vitin 2023 ishin planifikuar 3,481,392,000€, ndërsa ishin realizuar në vlerë prej 2,865,640,000€ apo 82% e buxhetit. Krahasuar me vitin 2022, pranimet e realizuara janë rritur për 237,579,000€, apo rreth 9%.

Buxheti final për shpenzime ishte në vlerë prej 3,518,467,000€, ndërsa ishte realizuar në vlerë 2,925,998,000€ apo 83%. Krahasuar me vitin 2022 kishte rritje të shpenzimeve për 300,990,000€ apo rreth 12%. Niveli më i ulët i shpenzimeve ishte te investimet kapitale me 65%.

Paraja e gatshme në fund të vitit 2023 është zvogëluar për 60,358,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2022. Bilanci bankar i pasurive financiare - parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2023 ishte 385,375,000€.

**Borxhi shtetëror<sup>1</sup>** - Në fund të vitit 2023, vlera e borxheve shtetërore ishte 1,663,040,000€ apo rreth 17.5% të BPV-së dhe është brenda kufijve të përcaktuar ligjor. Prej tyre, 692,850,000€ janë borxhe të jashtme dhe 970,190,000€ borxhe të brendshme. Në raport me vitin e kaluar borxhi i përgjithshëm ka shënuar rënie prej 90,160,000€ apo rreth 5%.

Borxhi i jashtëm në raport me vitin e kaluar është rritur për 51,650,000€ derisa borxhi i brendshëm është zvogëluar për 141,810,000€.

Nga fondet e huamarrjes, bazuar në paratë e gatshme në fund të vitit fiskal 2023, vërehet progres në investime krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, nga analiza e realizimit të projekteve prej borxhit shtetëror, ka ende ngecje në shfrytëzimin e fondeve të marra si hua të jashtme. Kjo është shkaktuar kryesisht nga problemet me menaxhimin e projekteve infrastrukturore, shpronësimet qoftë në fazën e planifikimit apo zbatimit të tyre.

**Llogaritë e arkëtueshme** - Vlera e përgjithshme e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF-BRK ishte 918,025,967€ (nga këto 669,401,679€ të nivelit qendror dhe 248,624,288€ të nivelit lokal). Krahasuar me vitin paraprak llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 76,927,603€, apo mbi 9% dhe kjo është një tregues që institucionet publike nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për mbledhjen e të hyrave. Në vitin 2023, nga auditimi është identifikuar se llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar në vlerë prej 2,413,587€.

**Detyrimet e papaguara dhe kontingjente** - Vlera e përgjithshme e prezantuar e detyrimeve të papaguara në RVF-BRK ishte 158,650,800€ (nga këto 131,979,380€ të nivelit qendror dhe 26,671,420€ të nivelit lokal). Krahasuar me vitin paraprak detyrimet e papaguara janë rritur për 8,954,176€ apo rreth 6%. Në vitin 2023, nga auditimi është identifikuar se detyrimet e papaguara ishin mbivlerësuar për 327,650€.

Po ashtu, sipas RVF-BRK detyrimet kontingjente për vitin 2023 janë gjithsej 331,978,298€, mirëpo nga auditimi është identifikuar se vlera e detyrimeve kontingjente ishte e nënvlerësuar për 19,791,076€.

**Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve** - për vitin 2023 ishin në vlerë 51,936,244€. Në raport me vitin 2022, shuma e këtyre pagesave është rritur për 5,586,897€ apo rreth 12%. Shpenzimet e kësaj natyre të cilat derivojnë nga këto procedura vazhdojnë të jenë sfidë për buxhetin e shtetit edhe për faktin se shpenzimet shtesë përtej borgjit kryesor ishin 7,899,248€, apo 15% e totalit të pagesave.

Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ri destinuar për t'u paguar këto detyrime.

<sup>1</sup> Informatat për borxhin shtetëror në këtë raport janë prezantuar bazuar në Buletinin Vjetor 2023 mbi borxhin shtetëror të publikuar nga MFPT/Thesar

**Pasuritë jo financiare** - Rezultatet e auditimit tregojnë progres të kufizuar në raport me vitin paraprak, megjithatë shpalosjet mbi pasuritë jo financiare në vitin 2023 ende nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se Organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre. Të dhënat e pasurive jo financiare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri në vitin 2023, janë jo të plota dhe gjendja e tyre është përcjellë me pasaktësi në raportim në vlerë prej 20,801,678€, derisa në vitin 2022 pasaktësia ishte 55,865,029€. Sipas kësaj rezulton se Organizatat buxhetore kanë ndërmarrë masa përmirësuese, megjithatë edhe më tutje mbetet sfida menaxhimi i pasurisë.

## Rezultatet nga auditimet individuale

**Organizatave buxhetore** - Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur për shkak se nga 86 auditimet e pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore 35 prej tyre kishin keqdeklarime materiale, të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar/kualifikuar. Ndërsa, 51 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar.

Duhet theksuar se në nivelin qendror ka një përmirësim në lidhje me raportimin financiar, ku në vitin 2023 janë 12 OB me opinione të modifikuara ndërsa në vitin 2022 ishin 17 me opinione të modifikuara, ndërsa tek niveli lokal në vitin 2023 ka 23 opinione të modifikuara që krahasuar me vitin 2022 ishin vetëm 16 opinione të modifikuara, që tregon një gjendje jo të mirë sa i përket raportimit financiar. Prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare e rrit besueshmërinë e lexuesve ndaj raportimit financiar.

Po ashtu, gjendja në lidhje me pajtueshmërinë nëse aktivitetet dhe transaksionet po kryhen në pajtim me kornizën ligjore ishte jo e mirë sidomos te niveli lokal. Në vitin 2023 nga 86 OB-të e audituara 37 kishin konkluzion të pamodifikuar kurse 49 e kishin konkluzionin e modifikuar. Te niveli lokal, prej 38 komunave, 35 e kishin konkluzionin e modifikuar, përderisa te niveli qendror, prej 48 OB-ve të audituara, 14 ishin me konkluzionin e modifikuar. Në raport me vitin paraprak gjendja është pothuajse e njëjtë.

**Ndërmarrjet Publike** - Cilësia e raportimit financiar edhe pse krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, megjithatë edhe te ndërmarrjet publike ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga 12 auditimet e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, tek tre NP është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa te nëntë (9) të tjera opinion i modifikuar (5 opinione të kualifikuara dhe 4 të kundërta). Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli në ndërmarrjet publike ka nevojë për përmirësime të mëtejme, marrë parasysh që në nëntë (9) prej tyre pasqyrat financiare për 2023 përmbanin keqdeklarime materiale.

Po ashtu, sa i përket pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, krahasuar me vitin 2022, dy ndërmarrje kanë bërë progres duke kryer aktivitetet dhe transaksionet e tyre në pajtim me kornizën ligjore, ndërsa ndërmarrjet tjera në raste të caktuara nuk kishin kryer transaksionet dhe aktivitetet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ndërsa, sa i përket performancës financiare, tetë (8) prej tyre kanë operuar me fitim prej 26mil.€. ndërsa katër (4) tjerat kanë operuar me humbje prej 24.6mil.€.

**Auditimet e Performancës, Teknologjisë së Informacionit dhe Pajtushmërisë** - Auditimet e kryera gjatë 2023, kanë identifikuar mangësi në fusha me rëndësi ekonomike, shëndetësore, të mirëqenies sociale dhe prokurimit publik, që tregojnë për mungesën e efikasitetit, llogaridhëniesë, efektivitetit dhe mos arritjen e vlerës për parane e shpenzuar dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.

Shërbimet publike në Kosovë përballen me sfida si në efikasitet ashtu edhe në efektivitet. Auditimet kanë nxjerr në pah joefikasitet në shërbimet shëndetësore, koha e pritjes së pacientëve në klinika, veçanërisht në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ka raste që është mbi katër vite. Përveç kësaj, programet për integrimin e grave rurale në tregun e punës nuk kanë arritur rezultate të kënaqshme.

Shqetësimet e mëtejshme përfshijnë llogaridhënien dhe transparencën. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dështoi të mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe ato që përfitojnë vërtetim sponsorizimi nga bizneset private. Në mënyrë të ngjashme, Administrata Tatimore nuk ka arritur t'i identifikoj dhe të ndërmarrë masat ligjore ndaj kompanive të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim dhe të cilat nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim. Auditimet evidentuan edhe mangësi në licencimin e mediave, ku disa media operojnë pa përmbushur detyrimet e tarifës vjetore. Për më tepër, menaxhimi i parkingjeve publike është karakterizuar me mungesë të planifikimit dhe lëshim i lejeve të parkingut pa dokumentacionin e duhur. Këta shembuj ngrenë shqetësime në lidhje me efektivitetin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe të zbatimit brenda organizatave apo institucioneve publike. Gjatë përmbylljes së shitjeve direkte të aseteve, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk ishte efikase, pasi kërkesat për blerje nuk u trajtuan në kohë optimale.

Në fushën e TI-së institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë veprime të mjaftueshme për të siguruar menaxhim të mirë të projekteve dhe ka mangësi në shtrirjen dhe përdorimin e sistemit dhe sigurinë e të dhënave.

Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, ka dështuar për të menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës. Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur të zbatoj Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik i cili nuk përdoret nga të gjitha barnatoret e niveleve të ndryshme shëndetësore deri në shpërndarjen e barnave tek pacientët si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të duhura rreth sigurisë së informacionit për këtë sistem.

Ndërsa auditimi paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë i kryer në Ujësjetit Rajonal të Prishtinës dhe Tiranës, nxjerr në pah mangësi të theksuara në qeverisjen e TI-së, sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve në të dy kompanitë e ujësjetit.

**Rekomandimet dhe zbatimi i tyre** – Raportet e auditimit për vitin 2023 kanë rezultuar gjithësejt me 817 gjetje dhe rekomandime për adresimin e tyre.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Vjetor të Auditorit për RVF-BRK e vitit 2022 ende vazhdon të mbetet i ulët. Niveli i adresimit të rekomandimeve të dhëna në RVA 2022 ishte rreth 19%.

Në auditimet individuale për organizatat buxhetore është vlerësuar se 46% e rekomandimeve të dhëna në vitin 2022 janë zbatuar plotësisht.



Ndërsa, nga 152 rekomandime sa janë dhënë në vitin 2022 për ndërmarrje publike 58% e tyre janë zbatuar.

Edhe pse rekomandimet e auditimit të dhëna për organizatat buxhetore janë zbatuar vetëm 46%, ndikimi i tyre në përmirësimin e menaxhimit të parasë dhe pasurisë publike ka pasur efekt pozitiv në disa fusha. Përmirësimet janë vërejtur tek cilësia e raportimit financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë publike, ku si rezultat i zbatimit të rekomandimeve janë regjistruar pasuri në vlerë prej 295mil.€ dhe te regjistrimi i drejtë i detyrimeve kontigjente në vlerë prej mbi 27mil.€.

Tek ndërmarrjet publike zbatimi i rekomandimeve ka pasur ndikim pozitiv në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportin vjetor brenda afatit kohor, prezantimin e saktë të detyrimeve kontingjente, përditësimi i kontratave të punës, hartimi i rregulloreve të brendshme për menaxhimin e aktiviteteve në ndërmarrje etj.



# *Kapitulli - I*

---

## *AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023*



# 1. Opinioni i auditimit

ZKA-ja ka audituar RVF-të e BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, i cili përfshinë Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve, shënimet shpjeguese dhe anekset.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

## Baza për opinionin e kualifikuar

- **Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve** - Gjatë vitit 2023 janë identifikuar klasifikime jo adekuate të shpenzimeve në vlerë prej 25,139,272€. Prej tyre 11,129,100€ apo 44% të nivelit qendror dhe 14,010,172€ apo 56% të nivelit lokal.  
Kjo ka ndodhur si rezultat i pagesave të bëra me vendime gjyqësore në vlerë 11,017,837€, buxhetimit jo adekuat 8,848,371€ dhe të ndikuara nga vetë organizatat buxhetore 5,273,064€.
- **Pasuritë** - Në fund të vitit 2023, totali i pasurive ishte 9,895,775,311€, Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i pasurive prej 20,801,678€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK-së. Problemet më të mëdha të cilat e kanë përcjellur këtë kategori ishin: regjistrimi jo i plotë i pasurive, regjistrimi i pasurive finale si investime në vijim përkundër pranimit teknik, dhe aplikimi jo i duhur i normave të zhvlerësimit.
- **Llogaritë e arkëtueshme** - Vlera e përgjithshme e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF-BRK ishte 918,025,967€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme prej 2,413,587€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK.
- **Detyrimet kontingjente** - Detyrimet kontingjente, janë rezultat i pretendimeve përmes padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritjet të marrin epilogun gjyqësor në një të ardhme. Sipas RVF-BRK detyrimet kontingjente për vitin 2023 janë gjithsej 331,978,298€. Sipas auditimeve individuale, është identifikuar nënvlerësim i detyrimeve kontingjente për 19,791,076€.

Përshkrim më i detajuar i çështjeve të përmendura te Baza për Opinion gjenden në kapitujt përkatës të këtij raporti.

### Rekomandime për Qeverinë

- Përmes MFPT-së të siguroj përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar për të përmbushur kërkesat për raportim të plotë dhe të saktë, përfshirë pasqyrat e shpalosjeve (anekseve).

## 2. Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

### Korniza ligjore

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për realizimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë ministritë, komunitat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

Auditori i Përgjithshëm, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, një herë në vit kryen auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë 2023 bazohet në dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (nenet 6 dhe 18);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar (neni 47 dhe 48);
- Plani Vjetor i Auditimit për sezonin auditues 2023/2024;
- Doracaku për Auditime Financiare dhe të Pajtueshmërisë;
- Udhëzues për kontrollin e cilësisë;
- Rregullorja e MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Korniza INTOSAI për Deklaratat Profesionale, përkatësisht, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe kryer bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit financiar të buxhetit të Kosovës sipas LMFP-së është baza e parasë së gatshme. Menaxhimi i parasë së gatshme është i organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohet për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari. Organizatat buxhetore kanë të deleguara përgjegjësit për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve. Po ashtu, bazuar në rregulloren MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë në bazë të të cilëve përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe raportojnë në MFPT/Thesar.

Raporti vjetor financiar për buxhetin e shtetit, përbëhet nga tri pasqyrat kryesore së bashku me shënimet shpjeguese si dhe anekset tjera, të cilat përgatiten nga Thesari, bazuar në shënimet e SIMFK-së.

Gjatë konsolidimit të RVF-BRK-së shënimet për anekset si në vijim: aneksi nr. 8 pasuritë me vlerë nën 1,000€, aneksi 9 stoqet, aneksi 10 të arkëtueshmet, aneksi 12 faturat e papaguara, aneksi 13 detyrimet kontingjente, aneksi 17 numri i të punësuarve jashtë listës së pagave dhe aneksi 18 numri i të punësuarve me kontratë për shërbime, bazohen në shënimet nga pasqyrat financiare individuale të Organizatave Buxhetore.

Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit. Ndërsa, raportet e auditimeve individuale i'u dërgohen Kuvendit të Kosovës, Kuvendeve Komunale, bordeve të drejtorëve dhe menaxhmentit të subjekteve të audituara.

Rishikimet tona analitike kanë rezultuar se asnjë nga 862 organizatat buxhetore nuk kishin mospërputhje me kërkesat e Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, sa i përket formatit, strukturës dhe afateve të raportimit.

Nga 86 OB të planifikuara për auditim 2023, të gjitha kishin dorëzuar pasqyrat financiare brenda afatit ligjor, deri më 31 janar 2024.

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesari është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatisë dhe të prezantojë në mënyrë të drejtë Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për aplikimin e kontroleve të brendshme.

Ud i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, me 26 mars 2024 i ka dorëzuar Qeverisë për aprovim, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2023 brenda afatit dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP me ndryshime dhe plotësime) si dhe në pajtim me SNKSP-të.

Zyra Kombëtare e Auditimit është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e RVF-ve të Qeverisë. Auditimi është fokusuar në tri pasqyrat kryesore dhe në shënimet shpjeguese/shpalosjet:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin;
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive financiare dhe bilancet e fondeve; dhe
- Plotësinë dhe cilësinë e informatave në shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

2 Në këtë numër nuk janë përfshirë, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Agjencia e Kosovës për Intelejencë.

Objektivë e auditimit ishte që të ofrojmë siguri të arsyeshme:

- Nëse RVF-BRK, paraqet në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse RVF-BRK, paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e kontrolleve të brendshme të aplikuara gjatë përgatitjes së RVF-BRK-së; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

Auditimi i RVF-ve të BRK-së për vitin 2023 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA-së. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit përmes të cilit janë hartuar RVF-të dhe me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për opinion, ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi.

Qasja e përzgjedhur përfshinë edhe vlerësimin e rezultateve të dala nga auditimet për disa anekse të RVF-ve të cilat konsolidohen nga pasqyrat financiare individuale, si: pasuritë, detyrimet, llogaritë e arkëtueshme, gjendja e borxheve publike dhe anekset tjera.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keqdeklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontrolleve të brendshme menaxheriale, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Pjesët e mëposhtme të raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që e kanë karakterizuar vitin 2023, por gjithsesi ofrojnë një nivel të arsyeshëm të sigurisë.



### 3. Deficiti buxhetor

Sipas nenit 46 të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, Ministri duhet t'i dorëzoj Qeverisë raportin përfundimtar mbi buxhetin, i cili përfshin një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore mes viteve lidhur me respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tilla.

Në bazë të nenit 22.A.1. të LMFPP Nr. 04/L-194, përcaktohet se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të BPV-së të parashikuar.

Ndërsa, neni 22.A.3 përcakton se me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

- Kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit; dhe
- Procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

Për mbulimin e rritjes së deficitit sipas propozimit, Ministria e Financave ka identifikuar burimet shtesë të financimit të deficitit, i cili do të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive të jashtme si dhe granteve.

Neni 22.A.4. përcakton se kufiri i deficitit mund të përshtatet edhe më herët nëse një përshtatje e tillë synon stabilizimin e nivelit të parashikuar total të borxhit në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit. Financimi i deficiteve buxhetore, sipas rregullave fiskale, bëhet nga fondet e huamarrjeve dhe të hyrat e njëhershme të AKP-së. Qeveria ka respektuar kërkesat e mësipërme dhe për qëllime të njëjta kishte planifikuar huamarrje prej 554,880,000€. Kjo shumë ishte planifikuar për të mbuluar shpenzimet të cilat ishin më të larta se të hyrat e planifikuara.

Ne analizuar përlllogaritjen e deficitit, në Aneksin nr.1 të RVF të shpalosjes së të dhënave në tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2023, dhe nuk kemi identifikuar mospërputhje.

Tabela 1- Përlllogaritja e deficitit buxhetor<sup>3</sup> për vitin 2023 (në '000€)

	Buxheti fillestar 2023	Buxheti i rishikuar 2023	Realizimi 2023 sipas RVF
<b>1. Të hyrat Buxhetore</b>	2,884,136	2,884,136	2,854,102
Te hyrat Tatimore	2,525,435	2,525,435	2,505,899
Kthimet Tatimore	-76,380	-76,380	-61,277
Të hyrat jo tatimore	261,200	261,200	266,881
nga të cilat: Taksa Koncesionare	19,000 <sup>4</sup>	19,000	25,980
nga të cilat: Renta minerare	30,150	30,150	26,722
Mbështetja buxhetore nga grantet	85,500	85,500	67,500
Grantet e përcaktuara të donatorëve	12,000	12,000	13,823
<b>2. Shpenzimet Buxhetore</b>	3,223,603	3,238,603	2,876,594
Paga dhe shtesa	745,528	745,528	766,557
Mallra dhe sherbime	493,546	493,546	423,728
Subvencione dhe transfere	1,100,284	1,100,284	1,078,206
Shpenzime kapitale	819,948	819,948	554,433
nga të cilat-Financimi I buxhetit të rregullt	686,439	686,439	536,914
nga të cilat - Shpenzime kapitale nga klauzola	133,509	133,509	17,519
Fondet e likuidimit nga AKP			
Rezerva	5,442	20,442	-
Pagesa e interesit	46,855	46,855	42,215
Grantete e përcaktuara të donatorëve	12,000	12,000	11,455
<b>3. Deficiti/suficiti I përgjithshëm</b>	-339,468	-354,468	-22,492
<b>4. Deficiti /suficiti I përgjithshëm në % të GDP</b>	-3.45%	-3.60%	-0.23%
<b>5. Shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale</b>	133,509	133,509	75,420
Shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura			57,900
Shenzimet nga pranimet e dedikuara të AKP			
Fondet e likuidimit nga AKP			
Shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve dhe AKP	133,509	133,509	17,519
<b>6. Deficiti/suficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale 5=4+3</b>	-205,959	-220,959	52,928
<b>7. Deficiti/suficiti i përgjithshëm në % të GDP</b>	-2%	-2%	0.54%
<b>8. Bruto produkti vendor i parashikuar</b>	9,843,000	9,843,000	9,652,890

3 Per qëllime të kalkulimit të deficitit buxhetor nuk përfshihen grantet, huamarrja dhe pranimet tjera (Të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga NP, Financimi i njehershëm nga AKP dhe Pranimet nga depozitat

4 Në raportin vjetor financiar, te tabela e Deficitit buxhetor për vitin 2023 (buxhetit fillestar) është pasqyruar gabimisht si vlerë 17 mil.€.

Tabela më lartë tregon se, deficitin e përllogaritur i përgjithshëm sipas buxhetit fillestar dhe me rishikim ishte -205,959,000€ apo -2% e BPV-së të parashikuar. Derisa në fund të vitit sipas realizimit, kishte suficit në vlerë prej 52,928,000€ apo 0.54% e BPV-së.

Kufiri i deficitit buxhetor ishte respektuar si me ligjin fillestar të buxhetit ashtu edhe me atë të rishikuar për vitin 2023. Ndërsa suficiti buxhetor në raport me vitin paraprak, është rritur nga 13,918,000€ në 52,928,000€ të BPV-së, në të cilin kishte ndikuar rritja në inkasimin e të hyrave.

## 4. Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore

Borxhi Shtetëror i Kosovës përbëhet nga borxhi i brendshëm, borxhi i jashtëm /ndërkombëtar dhe garancitë shtetërore. Borxhi i brendshëm nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar nga kreditor brenda vendit, ndërsa borxhi i jashtëm nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar përmes marrëveshjes ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjes financiare me kreditor që kanë selinë jashtë vendit.

Republika e Kosovës ka filluar të marrë borxhe ndërkombëtare nga viti 2009, ndërsa prej vitit 2012 ka filluar të marrë borxhe të brendshme përmes emetimit të letrave me vlerë.

Portofolio e borxhit shtetëror në fund të vitit 2023 përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe borxhi ndërkombëtar, si dhe dy garanci shtetërore<sup>5</sup>. Deri më tani, Republika e Kosovës nuk ka borxh komunal dhe as garanci komunale të emetuara.

Në fund të vitit 2023 borxhi shtetëror arriti vlerën 1,663,040,000€ që krahasuar me vitin paraprak shënoi një rënie prej 90,160,000€ apo rreth 5%. Rënia është si rrjedhojë e uljes së borxhit të brendshëm për 141,810,000€. Në tërësi, borxhi i përgjithshëm shtetëror në raport me BPV-në ka shënuar rënie, duke u reflektuar edhe në përqindjen e borxhit dhe garancive shtetërore ndaj BPV-së, e cila ka zbritur në 17.5% në vitin 2023 (në vitin 2022 ishte 20%).

Sipas Ligjit për Borxhet Publike Nr.03/L-175 është përcaktuar që në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë 40% të BPV-së. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) për vitin 2023 ka respektuar në tërësi limitin e lejuar ligjor për marrjen e borxheve publike.


<sup>5</sup> Garancitë shtetërore, paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik, dështon të paguaj obligimet kontraktuese të garantuara;

Tabela 2 - Borxhi i brendshëm dhe ndërkombëtar në tri vitet e fundit (‘000 në €)

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Borxhi ndërkombëtar	692,850	641,200	576,750
Borxhi i Brendshëm	970,190	1,112,000	1,106,140
Total Borxhi Shtetëror	1,663,040	1,753,200	1,682,890
Garancitë Shtetërore	28,590	29,610	30,630
Borxhi dhe Garancitë shtetërore (% e BPV-së)	17.52%	20.04%	21.53%
BPV nga ASK	9,652,890	8,895,730	7,958,880

Borxhi shtetëror përbëhet 58% nga huamarrja e brendshme dhe 42% nga huamarrja e jashtme. Qeveria aktualisht ka garancione shtetërore në vlerë 28,590,000€<sup>6</sup>.

Grafikoni 1 - Borxhi i brendshëm dhe ndërkombëtar (në milion €)



## Borxhi i brendshëm

Republika e Kosovës ka filluar marrjen e borxhit të brendshëm përmes emetimit të letrave me vlerë nga janari i vitit 2012, ky borxh paraqet katalizatorin kryesor në financimin e deficitit buxhetor.

Në fund të vitit 2023, borxhi i brendshëm ishte 970,190,000€, në raport me vitin paraprak ka shënuar rënie për 141,810,000€ apo 14.6%.

<sup>6</sup> Garancia aktuale për Trafikun Urban - Prishtinë është në vlerë prej 4,59 milion euro dhe Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë prej 24 milion euro.

Tabela 3 -Shpalosje për Emetimet e Reja të Letrave me Vlerë (‘000 në €)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2023
Maturimet	-248,491
Emetimet	106,690
Emetimet e Reja	-141,810

Gjatë vitit 2023 vlera e letrave me vlerë që kanë maturu ishte 248,490,000€, për rifinancim janë emetuar 106,690,000€, ndërsa vlera 141,810,000€ është paguar nga buxheti i Kosovës, që nënkupton se në total emetimet e reja për vitin 2023 ishin -141,810,000€.

Tabela 4 - Borxhi i Brendshëm në tre vitet e fundit (‘000 në €)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Emetimet e Reja	-141,810	5,850	144,250
Stoku i Borxhit të Brendshëm	970,190	1,112,000	1,106,140
Borxhi i Brendshëm (% e BPV)	10%	12.50%	14%

Përveç bankave komerciale<sup>7</sup> që janë akterë primar si dhe Trustit Pensional si participant primar, Letra me Vlerë mbajnë edhe investitorë të tjerë fizikë dhe juridikë (biznese dhe individë privat).

Në vitin 2021 janë emetuar Letra me Vlerë me pakicë Bono për Diasporën me maturitet 3 dhe 5 vjeçar në shumën 10,430,000€, dedikuar bashkatdhetarëve të cilat kishin për qëllim orientimin e fondeve të diasporës në financime produktive që mundësojnë zhvillimin ekonomik të vendit.

Tabela 5 - Mbajtësit e Letrave me Vlerë (‘000 në €)

Instrumenti	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Bankat Komerciale	231,500	279,510	327,390
Fondet Pensionale	444,540	550,270	490,470
Institucionet Publike	216,600	213,560	228,370
Kompanitë e Sigurimeve	50,330	45,910	41,420
Të tjerë	29,690	26,800	22,400
Total	972,660	1,116,050	1,110,050

<sup>7</sup> Sipas Rregullores MFPT-BQK Nr. 01/2014 për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## Borxhi ndërkombëtar

Në fund të vitit 2023, borxhi i jashtëm ishte 692,850,000€ që ka shënuar rritje për 51,650,000€ apo 8% krahasuar me vitin paraprak. Borxhi i jashtëm është huazuar me qëllim të financimit të projekteve në fushën e arsimit, bujqësisë, kadastrës, energjisë, shëndetësisë, ujit, trajtimit të ujërave të zeza, ngrohjes qendrore, sistemit bankar, rehabilitimit të rrugëve dhe hekurudhave si dhe mbështetjen e buxhetit.

Tabela 6 - Borxhi ndërkombëtar në tre vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Totali i Borxhit të jashtëm	692,850	641,200	576,750
Qeveria Qendrore	652,050	564,190	532,300
Borxhi i Nën-huazuar	40,800	47,010	44,440
Borxhi i jashtëm (% e BPV-së)	7.18%	7.46%	7.86%
BPV nga ASK	9,652,890	8,895,730	7,958,880

Kreditorët kryesor të borxhit ndërkombëtar janë Banka Botërore përmes ANZH me pjesëmarrje 36%, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) me pjesëmarrje 11%, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) me pjesëmarrje 13%, Bashkimi Evropian (BE) me pjesëmarrje 14% dhe Banka Evropiane për Investime (BEI) me pjesëmarrje 8%.

Gjatë vitit 2023 në Kuvend janë ratifikuar tetë (8) kredi/marrëveshje financiare, me qëllim të financimit të projekteve në sektorin e ambientit, energjisë, transportit, digjitalizimit të administratës publike si dhe reformës së financave publike dhe rritjes ekonomike.

Tërheqjet në shumat më të larta janë realizuar nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Evropiane për Investime (BEI) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Deri në fund të vitit 2023, Organizatat buxhetore për projekte të cilat financohen nga borxhi ndërkombëtar kanë tërhequr fonde nga kreditë, në vlerë 102,480,000€. Tërheqjet nga kreditë direkte ishin 96,970,000€, përderisa kompanitë publike kanë tërhequr fonde nga kreditë e nën-huazuara nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve në vlerë 5,510,000€.

Tabela 7 - Kreditë e ratifikuara në 2023 (‘000 në €)

Kredia/Projekti	Kreditore	Data e Marrëveshjes	Valuta	Vlera	OB Zbatuese	Statusi
Fondi për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri 2023	FMN	23.08.2023	€	75,460	MFPT	E ratifikuar
Aranzhimi për Kredi në Dispozicion 2023	FMN	07.06.2023	€	97,600	MFPT	E ratifikuar
Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10B	BEI	21.12.2022	€	38,000	INFRAKOOS	E ratifikuar
Korniza e Qyteteve të Gjelbërta 2 Dritarja 2 - Efiçienca e Energjisë në Ndërtesa Publike në Prishtinë	BERZH	12.04.2022	€	5,000	Komuna e Prishtinës	E ratifikuar
Efiçienca e Energjisë Në Ndërtesa Publike në Prizren	BERZH	10.05.2022	€	5,000	Komuna e Prizrenit	E ratifikuar
Ngrohtorja Solare e Prishtinës	BERZH	20.12.2022	€	23,200	Termokos	E ratifikuar
Zhvillimi i Sektorit të Energjisë VII – Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit	KFW	29.12.2022	€	25,500	KOSTT	E ratifikuar
Reforma e Sistemit të Ndhmës Sociale të Kosovës	ANZH	26.10.2021	€	47,000	MFPT	E ratifikuar

## Mangësi në shfrytëzimin e kredive të jashtme

Për vitin 2023 shuma e pa-tërhequr e kredive është 569,580,000€. Sipas aneksit 21.1 të PFV të BRK-së për shpalosjen e borxhit të jashtëm, për shtatë (7) projekte/kredi në vlerë totale prej 177,900,000€ të ratifikuara përgjatë viteve 2016 deri 2023, nuk janë tërhequr fare mjetet financiare.

### **Kreditë e ratifikuara të cilat nuk kishin disbursim të mjeteve deri në fund të 2023:**

1. Projekti Trajtimi i ujërave të zeza në Prishtinë në vlerë 66,000,000€, kreditori NATIXIS, zbatuese e projektit është Ministria e Ekonomisë, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2017 (me afat realizimi dhjetor 2026);
2. Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan në vlerë 11,000,000€, kreditori BEI, zbatuese e projektit është ME/komuna e Gjilanit/KRU Hidromorava, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2020 (me afat realizimi mars 2026);
3. Projekti për Masat e Energjisë Efiçiente në komunat: Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan, kreditori KFW, zbatues të projektit janë komunat përkatëse, në vlerë 2,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2016 (me afat realizimi 30 maj 2021);
4. Projekti Reagimi i Kosovës ndaj pandemisë COVID -19 për NVM-të, kreditori BEI, zbatues i projektit është MFPT/FKKG, në vlerë prej 40,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2021 (me afat të realizimit në janar 2024);
5. Projekti i Impianti i Ujërave të Zeza në Mitrovicë, kreditori BEI, zbatues i projektit është komuna e Mitrovicës, në vlerë prej 19,800,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2021 (me afat të realizimit në dhjetor 2026);
6. Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Mitrovicë, kreditori BERZH, zbatues i projektit është komuna e Mitrovicës, në vlerë prej 13,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2021 (me afat të realizimit në dhjetor 2026); dhe
7. Projekti Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit, kreditori ANZH zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë prej 25,100,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2022 (me afat të realizimit në nëntor 2025).

Përderisa për tetë (8) kreditë e reja të ratifikuara në 2023 me vlerë 316,760,000€, janë tërheq 52,800,000€.



**Kreditë e ratifikuara të cilat kishin vonesa në disbursimin e mjeteve deri në fund të 2023:**

Për dhjetë (10) kreditë e ratifikuara gjatë viteve 2014 - 2020, në vlerë prej 193,53,000€, të cilat kishin afat përmbyllje gjatë viteve 2022-2023, niveli i disbursimit deri në fund të 2023 ishte vetëm 95,360,000€.

1. Projekti i Zgjerimit të Magjistrales M2 Milloshevë-Mitrovicë, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë prej 18,120,000€, nga kreditori FOZHN, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 14,010,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2014 (me afat të realizimit dhjetor 2022);
2. Projekti për Magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë 14,490,000€, nga kreditori FSZH, ku shuma e patërhequr për kredi është 9,310,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2014 (me afat të realizimit dhjetor 2022);
3. Projekti për Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë prej 29,000,000€, nga kreditori BERZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 20,580,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2016 (me afat të realizimit gusht 2023);
4. Projekti i Fuqizimit të Sektorit Financiar, zbatues i projektit është MFPT/Fondi KGK, në vlerë prej 22,300,000€, nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 400,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2020 (me afat të realizimit dhjetor 2023);
5. Projekti për Patundshmëri dhe Infrastrukturë Gjeo-hapësinore, zbatues i projektit është ME, në vlerë prej 14,600,000€, nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 14,030,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit gusht 2023);
6. Projekti për Konkurrueshmëri dhe Gatishmëri për Eksport, zbatues i projektit është MTI, në vlerë prej 14,300,000€, nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 5,060,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit tetor 2023);
7. Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës, zbatues i projektit është ME, në vlerë prej 20,700,000€, nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 7,620,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit qershor 2023);
8. Projekti Rehabilitimi i Linjës së 10-të Hekurudhore, Segmenti Jugor Hani i Elezit-Kosovë, zbatues i projektit është MMPHI, INFRAKOS, në vlerë prej 39,900,000€, nga kreditori BEI, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 21,060,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2016 (me afat të realizimit dhjetor 2023);
9. Projekti për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit, zbatues i projektit është Ibër Lepenc SH.A, në vlerë prej 15,000,000€, nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 6.070,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2017 (me afat të realizimit prill 2022); dhe
10. Projekti për Ndërtimin e Sistemit të Ujësjellësit për Komunën e Graçanicës, zbatues i projektit është Komuna e Graçanicës, në vlerë prej 5,120,000€, nga kreditori UniCredit, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 20,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2019 (me afat të realizimit dhjetor 2022).

Gjatë viteve 2013-2017, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka zhvilluar projektin për digjitalizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, në vlerë prej 4,931,000€. Për zhvillimin e këtij projekti Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka negociuar marrëveshjen për kredi të butë, përmes bankës austriake UniCredit Bank Austria dhe Qeverisë Austriake si garantues, e cila është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2014 dhe do të paguhet deri më 30 shtator 2032 në një vlerë totale 5,637,519€ (përfshirë kryegjënë, interesin, tarifën). Mirëpo, projekti në fjalë nuk është funksionalizuar dhe nuk janë arritur qëllimet e këtij projekti për e-edukimin dhe digjitalizimin e

provimit të maturës. Ministria nuk ka siguruar pajisjet thelbësore dhe infrastrukturën harduerike dhe të rrjetit për qëllime të këtij projekti. Sistemi i zhvilluar nuk ka arritur të zbatohet në shkollë për shkak të mungesës së pajisjeve të nevojshme dhe qasjes në rrjet për përdoruesit.

Për projektet e lartpërmendura, organizatat zbatuese të projekteve përkatëse raportojnë çdo tre (3) muaj në MFPT, si dhe për të njëjtat, MFPT raporton çdo gjashtë (6) muaj në Qeveri mbi rrjedhën e ecurisë së realizimit të këtyre projekteve. Ne kemi vërejtur se raportimet nga njësitë implementuese të projekteve janë formale dhe jo të mirëfillta, duke mos i listuar në mënyrë të detajuar shkaqet dhe pengesat që paraqiten në terren në realizimin e këtyre projekteve, që të pasqyrojnë veprimet konkrete në eliminimin e tyre.

Hyrja në marrëveshje të kredive dhe vonesat në tërheqjen e fondeve në dispozicion, është pasojë e planifikimit të dobët, procesit të shpronësimit dhe mungesës së kapaciteteve qeveritare për t'i shfrytëzuar në kohë dhe në mënyrë efektive fondet e huamarrjes. Si pasojë e këtyre mangësive, Qeveria në vazhdimësi është duke paguar tarifë të zotimit për këto kredi të pashfrytëzuara.

Mospërputhje e dinamikës kohore në mes alokimit të kredive dhe realizimit të projekteve, për nëntë (9) kreditë efektive që përfshijnë vitet e ratifikimit 2016-2021, që parashihen tarifa zotimi për mjetet e kredive të pa tërhequra nga huamarrësit, Qeveria në vitin 2023 ka paguar tarifa të zotimit në vlerë prej 497,889€. Krahasuar me vitin paraprak ka një rritje të tarifave të zotimit për 160,561€, këto tarifa akoma paguhen për shkak të vonesave në tërheqjen e fondeve.

Vlen të theksohet se vlera prej 4.9mil.€ te shpalesjet për borxhin shtetëror në Raportin vjetor financiar, është prezentuar si vlerë e pa tërhequr edhe pse kjo kredi është anuluar.

## Garancitë shtetërore

Në fund të vitit 2023 portofolio e garancive shtetërore të Republikës e Kosovës përbehet nga dy garanci shtetërore të emetuara. Garancitë Shtetërore dhe Komunale trajtohen si borxh gjatë llogaritjes së treguesit Borxh/BPV.

Garancia e emetuar gjatë vitit 2016 në vlerë 10,000,000€, përmes së cilës Republika e Kosovës e garanton ndërmarrjen publike lokale Trafiku Urban për kredinë e huazuar nga BERZh. Deri në fund të vitit 2023 huamarrësi ka kthyer shumën e kredisë në vlerë 5,410,000€.

Në fund të vitit 2016, Republika e Kosovës ka emetuar garancinë tjetër shtetërore në shumën 24,000,000€, e cila i është vënë në dispozicion Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës për linjën e dytë kreditore të ofruar nga BERZh. Këto fonde nga linja kreditore e dytë janë në gjendje të disponueshme në rast se paraqitet nevoja për disbursim.

Tabela 8 - Gjendja e garancive shtetërore ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Garancitë Shtetërore	28,590	29,610	30,630
BERZh Garancia për Trafikun Urban-Prishtinë	4,590	5,610	6,630
BERZh Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	24,000	24,000	24,000
Garancitë Shtetërore (% BPV-së)	0.30%	0.33%	0.39%

### **Rekomandime për Qeverinë**

- Qeveria duhet të siguroj që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarrje, se janë bërë analiza të hollësishme dhe përgatitjet e duhura lidhur me projektet, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondeve; dhe
- Ngecjet apo dështimi në mos fillimin apo mos realizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjtat të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.

### **Rekomandime për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve**

- Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, Ministria në bashkëpunim me ministritë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuar, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Ministria duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave.

## 5. Analiza e buxhetit të shtetit

Të dhënat e prezantuara në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës janë reflektim i projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit për vitin 2023, dhe si rrjedhojë e pranimeve dhe pagesave kundrejt ndarjeve përkatëse buxhetore.

Projeksionet fillestare dhe finale për të hyrat/pranimet, sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore Nr.08/L-193 ishin në vlerë 3,481,392,000€ dhe nuk kishin ndryshuar gjatë vitit. Derisa realizimi i të hyrave/pranimeve për vitin 2023 ishte në vlerë prej 2,865,640,000€ apo 82% e buxhetit final. Krahasuar me realizimin e vitit 2022, pranimet janë rritur për 237,080,000€, apo rreth 9%.

Lëvizjet buxhetore tek shpenzimet (në vlerë totale 133,609,000€) përmes Vendimeve të Qeverisë përgjat vitit, kishin ndikuar në disa Organizata Buxhetore, ku në kategori të caktuara ekonomike dhe projekte kishte rritur buxhetin, kurse në disa të tjera e kishin zvogëluar atë. Këto lëvizje buxhetore, vijnë nga ndarjet nga ndryshimet sipas LMFP-së në vlerë prej 25,040,000€, duke vazhduar nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë prej 92,413,000€ dhe ndryshimet për grantet e përcaktuara te donatorëve në vlerë prej 16,156,000€.

Buxheti fillestar për shpenzime ishte 3,384,858,000€, kurse buxheti final ishte në vlerë prej 3,518,467,000€ i cili ishte realizuar në vlerë 2,925,998,000€ apo 83% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2022 kishte rritje të shpenzimeve për 300,990,000€.

Informata më në detaje mbi planifikimet fillestare dhe buxhetin final, janë prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 9 - Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizim (në '000€)

Nr.	Zërat Buxhetor	Realizimi	Sipas Ligjit të Buxhetit Final	Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-193 viti 2023
1	Tatimet direkte	490,294	504,516	504,516
2	Tatimet indirekte	2,076,882	2,097,299	2,097,299
3	Kthimet	-61,277	-76,380	-76,380
4	Të hyrat jo tatimore	266,881	261,200	261,200
5	Grantet dhe ndihmat	81,323	97,500	97,500
6	Financimi nga huamarrja	-34,845	554,880	554,880
7	Pranimet tjera	48,382	42,377	42,377
<b>Total pranimet</b>		<b>2,865,640</b>	<b>3,481,392</b>	<b>3,481,392</b>
1	Paga dhe mëditje	767,305	770,094	745,528
2	Mallra dhe shërbime	397,978	476,026	459,410
3	Shpenzime komunale	28,779	34,170	34,136

4	Subvencione dhe Transfere	1,079,450	1,160,817	1,100,284
5	Shpenzimet kapitale	560,868	868,893	819,948
6	Rezerva	-	357	5,442
7	Interesi	42,215	46,855	46,855
8	Të tjera	49,403	161,255	173,255
Total pagesat		2,925,998	3,518,467	3,384,858
Rritja/zvogëlimi i bilancit bankar		(60,358)	(37,075)	96,534

Sipas Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, në kategorinë e shpenzimeve "Rezervat" janë buxhetuar 4,800,000€ për nivelin qendror, të cilat gjatë vitit janë shpërndarë përmes vendimeve të qeverisë, kryesisht për shtesat për fëmijë dhe lehonave dhe për subvencionimin e kategorive tjera të ndryshme sociale, dhe 642,000€ si buxhet për projekte kapitale për nivelin lokal.

Sipas ligjit të rishikuar Nr. 08/L-213 me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, Qeveria ka rritur kufirin e shpenzimit prej 15,000,000€ nga fondi i Bankës Botërore (burimi i financimit Huamarrja (04) në kategorinë e shpenzimeve "Rezerva", të cilat janë shpërndarë për ndihmë për rimëkëmbje ekonomike për familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore, dhe pagat dhe shtesat në shëndetësi.

Ndërsa sipas vendimeve të qeverisë vlera prej 1,930,000€ nga Fondi Rezervë janë ndarë mjetet për financimin e projekteve të teknologjisë informative dhe financimin për shtesat për fëmijë dhe lehona.

## 5.1. Analiza e të hyrave/pranimeve sipas kategorive ekonomike

Projeksionet për të hyrat/pranimet, sipas Ligjit të Buxhetit nr.08/L-193 për vitin 2023 ishin në vlerë 3,481,392,000€, derisa realizimet ishin në vlerë 2,865,640,000€ apo 82% e planifikimit të tyre.

Pasqyra më poshtë ofron informata më në detaje për buxhetin fillestar, final dhe trendet buxhetore gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 10 - Pranimet sipas burimit sipas RVF/BRK-së ('000 në €)

Pranimet	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2023	Realizimi 2022	Realizimi 2021
Tatimet direkte	504,516	504,516	490,294	413,829	342,165
Tatimet indirekte	2,097,299	2,097,299	2,076,882	1,870,248	1,664,685
Kthimet	-76,380	-76,380	-61,277	-67,069	-58,912
Të hyrat jo tatimore	261,200	261,200	266,881	256,532	236,116
Grantet dhe ndihmat	97,500	97,500	81,323	19,988	16,801
Financimi nga huamarrja	554,880	554,880	-36,845	112,201	269,586
Pranimet tjera	42,377	42,377	48,382	22,823	20,533
<b>Total</b>	<b>3,481,392</b>	<b>3,481,392</b>	<b>2,865,640</b>	<b>2,628,552</b>	<b>2,490,973</b>

Në raport me tre vitet e fundit, ka një trend të rritjes së të hyrave buxhetore. Krahasuar me vitin e kaluar, realizimi i pranimeve/të hyrave është më i lartë për 9% apo 237,088,000€, ndërsa në raport me vitin 2021, realizimi është më i lartë për 15%.

### Tatimet direkte

Tatimet direkte përbëhen prej katër kategorive: tatimi në të ardhura të korporatave (TAK), tatimi në të ardhura personale (TAP), tatimi në pronë (TP), si dhe tatime tjera (gjobat e ATK-së). Realizimi i tatimeve direkte ishte në vlerë 490,294,000€ apo 97% e shumës së planifikuar me buxhetin vjetor për këtë kategori të të hyrave.

Burim kryesor i tatimeve direkte ishte: tatimi në të ardhura personale me 255,941,144€ apo 52%, tatimi në të ardhura të korporatave me 184,864,272€ apo 38%, tatimi në pronë me 46,085,201€ apo 9%, dhe tatimet tjera me 3,403,383€ apo rreth 1%. Prej tyre, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndërsa tatimi në pronë nga Komunitat. Krahasuar me vitin 2022, tatimet direkte kanë shënuar rritje për 18%, ndërsa 43% krahasuar me vitin 2021.

Realizimi i tatimit në pronë për vitin 2023, ishte më i lartë se në vitin paraprak për 11,531,000€. Në katër komunat: Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku nuk janë realizuar fare të hyra nga tatimi në pronë. Mos realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë në këto komuna është një

dukuri që vazhdon nga viti në vit, dhe kjo për arsye të mos zbatimit të ligjeve në fuqi dhe mos hartimit të rregulloreve të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.

## Tatimet indirekte

Burimet kryesore të tatimeve indirekte janë: tatimi në vlerën e shtuar (TVSH), detyrimi doganor, akcizat dhe tatimet tjera indirekte. Realizimi total për këtë kategori të të hyrave ishte 2,076,882,000€ apo 99% nga shuma e planifikuar me buxhetin vjetor. Tatimi i mbledhur në vlerën e shtuar ishte 1,365,587,236€ apo 66% e realizimit total, akcizat 554,990,496€ apo 27%. taksat doganore 156,215,116€ apo 7%, dhe tatimet tjera indirekte prej 89,966€. Krahasuar me vitin 2022, tatimet indirekte kanë shënuar rritje për 206,634,000€ apo 11%, ndërsa krahasuar me vitin 2021, rritja është për 412,197,000€ apo 25%.

## Kthimet tatimore

Kthimet tatimore ndodhin për shkak të shumave të paguara nga tatimpaguesit mbi shumën e detyrimit tatimor. Me rastin e barazimit të gjendjes së tatimeve me ATK-në dhe Doganën, përlllogariten diferencat, dhe si të tilla u kthehen subjekteve të ndryshme pas shqyrtimit të kërkesave për rimbursim.

Sipas buxhetit, shuma e kthimeve ishte planifikuar në vlerën prej 76,380,000€, ndërkaq shumat e kthyera deri në përfundim të vitit ishin 61,277,000€ ose 80% e planit apo rreth 2.4% të tatimeve të inkasuara. Prej tyre, vlera e kthimeve nga ATK ishte 59,337,000€, kurse 1,940,000€ janë kthimet nga Dogana.

Shuma e kthyer e tatimeve direkte dhe indirekte tek Dogana e Kosovës ka të bëjë me kthimet e: akcizës 134,000€, taksës doganore 534,000€, TVSH-së doganore 1,072,000€ si dhe kthimi nga tatimet taksa tjera doganore 200,000€, ndërsa tek ATK kthimet ishin nga: TVSH-së 57,971,000€, tatimit për pagat e mbajtur në burim 152,000€, tatimi për biznese 80,000€, tatimi për korporata 1,128,000€, si dhe llojet e tjera të tatimeve prej 6,000€.

Në krahasim me vitin 2023, kthimet e tatimeve ishin për 5,792,000€ më të ulëta apo për 9%.

## Të hyrat jo tatimore

Në kategorinë e të hyrave jo tatimore bëjnë pjesë të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, llojet e ndryshme të gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifatat e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj.

Të hyra jo tatimore mblidhen nga niveli qendror, niveli lokal, agjencitë e pavarura buxhetore dhe ndërmarrjet publike.

Të hyrat jo tatimore për vitin 2023 sipas Ligjit të Buxhetit Fillestar dhe final ishin planifikuar në vlerë prej 261,200,000€. Prej tyre në nivelin qendror ishin planifikuar 154,600,000€, në nivelin lokal 53,900,000€, renta minerare 30,200,000€, taksa koncesionare 19,000,000 si dhe të hyrat nga interesi 3,500,000€.

Shuma totale e realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2023 ishte 266,881,000€ apo 102% e planit. Prej tyre, 148,074,000€ ishte shuma e mbledhur nga niveli qendror, ndërsa nga niveli lokal 62,511,000€, realizimi nga rentat minerare ishte 26,722,000€, nga taksa koncesionare 25,980,000€, si dhe të hyrat nga interesi i kredive për ndërmarrje publike 3,594,000€.

Trendi gjatë tri viteve të fundit tregon se të hyrat jo tatimore kanë shënuar rritje për 10,349,000€ apo rreth 4% krahasuar me vitin 2022, dhe për 30,765,000€ apo rreth 13% në raport me vitin 2021.

## Grantet dhe ndihmat

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes të Qeverisë dhe donatorëve. Këto fonde planifikohen me buxhet vjetor dhe janë pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme.

Shuma e granteve sipas Ligjit të Buxhetit fillestar Nr.08/L-193 për ndarjet buxhetore për vitin 2023, duke përfshirë grantet për mbështetje buxhetore, ishte planifikuar në vlerë prej 97,500,000€. Vlera e njëjtë ishte planifikuar edhe me buxhet përfundimtar, ndërsa realizimi ishte 81,323,000€ apo 83%.

Në fund të vitit 2023, fondet e pa shpenzuara nga donatorët, të akumuluar ndër vite, arrijnë shumën prej 16,177,000€. Mos efikasiteti i shfrytëzimit të fondeve nga donatorët sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, rritë rrezikun që grantet në të ardhmen të zvogëlohen.

## Financimi nga huamarrja

Si burim për financimin e pagesave buxhetore, me Ligjin e Buxhetit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023, Qeveria kishte planifikuar që një pjesë të pagesave ta financojë nga huamarrjet.

Pranimet nga huamarrja me Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023 ishin planifikuar në vlerë 554,880,000€.

Huamarrja e jashtme ishte planifikuar në vlerë prej 434,880,000€, ndërsa janë realizuar 104,961,000€ apo 24% e planit. Kjo situatë po përsëritet ndërvite, pasi për projekte të caktuara nuk është bërë ratifikimi i marrëveshjeve në Kuvend, dhe aranzhimi i huamarrjes është bërë para krijimit të kushteve të cilat sigurojnë implementimin e këtyre projekteve, siç janë studimet dhe analizat e duhura, zgjidhja e problemeve me shpronësim në mënyrë që fondet të shfrytëzohen në mënyrë sa më efektive.

Huamarrja e brendshme ishte planifikuar në vlerë prej 120,000,000€, ndërsa janë realizuar 141,805,000€ apo 118% e planit. Kjo për arsye të bilancit bankar pozitiv, ku si rezultat i ekzistencës së likuiditetit, nuk është bërë emetimi i letrave me vlerë.



## Pranimet tjera

Pranimet tjera përbëhen nga financimi i njehershëm AKP-së, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike, të hyrat e dedikuara dhe pranimet nga depozitat.

Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-193, pranimet tjera ishin planifikuar në vlerë prej 42,377,000€, gjatë vitit nuk ka pasur lëvizje të buxhetit në këtë kategori. Kjo vlerë përbëhej nga: kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike në vlerë 37,877,000€ dhe të hyrat e dedikuara në vlerë prej 4,500,000€.

Realizimi i pranimeve tjera ishte në vlerë 48,382,000€, prej të cilave: kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 37,877,000€ apo 100% e planit, të hyrat e dedikuara në vlerë 5,958,000€ apo 132% e planit, dhe pranimet nga depozitat në vlerë 4,547,000€.

## 5.2. Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Buxheti final për shpenzimet e përgjithshme ishte në vlerë 3,518,467,000€, ndërsa realizimi ishte 2,925,998,000€ apo 83% e buxhetit. Krahasuar me vitin 2022, pagesat janë rritur për 300,990,000€, ndërsa me vitin 2021 janë rritur për 547,258,000€.

Tabela 11 - Pasqyra e pagesave krahasuar me dy vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2023	Realizimi 2022	Realizimi 2021
Pagat dhe Shtesat	745,528	768,935	767,305	653,436	667,312
Mallrat dhe Shërbimet	459,410	463,799	397,978	337,414	306,410
Shërbimet Komunale	34,136	34,168	28,779	25,952	25,287
Subvencionet dhe Transferet	1,100,284	1,157,938	1,079,450	1,065,195	842,570
Investime kapitale	819,948	857,004	560,868	422,579	423,941
Shpenzimet e interesit	46,855	46,855	42,215	35,039	30,881
Rezervat	5,442	357	-		
Të tjera	173,255	189,411	49,403	85,394	90,473
<b>Total</b>	<b>3,384,858</b>	<b>3,518,467</b>	<b>2,925,998</b>	<b>2,625,009</b>	<b>2,378,740</b>

Në vijim janë paraqitur realizimi i shpenzimeve sipas kategorive si dhe krahasimet me vitet e kaluara.

## Pagat dhe shtesat

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore prezantohen si një ndër kategoritë me përqindje të lartë të shpenzimeve me rreth 26%. Buxheti për vitin 2023 ishte 768,935,000€, ndërsa shpenzimet 767,305,000€ apo mbi 99% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 113,869,000€ që ka ndodhur për shkak të rritjes të numrit të përgjithshëm të të punësuarve për 1456 punonjës.

Pagesa për punonjësit e cila ishte bërë në mungesë të vijueshmërisë së plotë në punë. Numri i të punësuarve për këtë kategori të punonjësve ishte 107<sup>8</sup>, vlera e këtyre pagesave për vitin 2023 ishte 640,599€.

## Mallrat dhe shërbimet

Në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve buxhetore marrin pjesë me rreth 13%. Buxheti final për vitin 2023 ishte 463,799,000€, ndërsa shpenzimet 397,978,000€ apo rreth 85% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 60,564,000€. Në këtë rritje të shpenzimeve ka ndikuar rritja e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, blerja e librave dhe veprave artistike, blerjet për rezervën shtetërore, shpenzimet e qirasë, karburanteve për vetura etj. Në kuadër të kësaj kategorie të shpenzimeve, janë të përfshira edhe pagesat përmes vendimeve gjyqësore, të cilat në krahasim me vitin e kaluar, kanë shënuar një rritje prej 5,600,000€.

Zërat kryesor në këtë kategori të cilat përfshijnë pjesën më të madhe të shpenzimeve janë: shërbimet kontraktuese tjera me 70,927,000€, furnizimet mjekësore 61,714,000€, shpenzimet e karburantit dhe ngrohjes 27,910,000€, blerja e librave 514,000€, shpenzimet e qirasë 11,495,000€ etj.

## Shërbimet komunale

Buxheti për vitin 2023 ishte 34,168,000€, ndërsa shpenzimet 28,779,000€ apo rreth 84% e buxhetit. Zërat të cilat e përfshijnë këtë kategori janë: shpenzimet e rrymës, ujit, mbeturinave, ngrohja qendrore dhe shpenzimet e telefonisë fikse.

## Subvencionet dhe Transferet

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 33% që njëherit prezanton kategorinë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Buxheti për vitin 2023 ishte 1,157,938,000€,

8 Punëtorë nga ministritë: MI, MKK dhe MINT

kurse shpenzimet ishin 1,079,450,000€ apo 93% e buxhetit. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori në krahasim me vitin e kaluar ishte për 14,255,000€. Kjo rritje ka reflektuar në këto kode ekonomike: subvencione për entitetet publike dhe jo publike, pensionet bazë, pagesat për përfituesit individual etj.

Zërat kryesor në këtë kategori të cilat përfshijnë pjesën më të madhe të shpenzimeve janë: subvencionet për entitetet publike me 185,393,000€, subvencionet për entitetet jopublike 96,416,000€, pensionet bazë me 200,228,000€, pensionet bazë kontributdhënëse me 143,388,000€, pensionet për veteranet e luftës 77,341,000€ etj.

Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19, nga kjo kategori në total ishin 324,435,243€. Prej tyre, nga Pakoja e ringjalljes ekonomike dhe kontigjencat e BE-së 184,597,541€, ndërsa nga Pakoja e Ringjalljes 139,837,702€. Këto shpenzime janë trajtuar në nënkapitujt më poshtë të këtij raporti.

## Investimet kapitale

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme investimet kapitale marrin pjesë me rreth 19%. Buxheti final për këtë kategori ishte 857,004,000€, kurse shpenzimet ishin 560,868,000€ apo 65% e buxhetit për investime kapitale. Krahasuar me vitin 2022 ka një rritje të shpenzimeve për 138,289,000€.

Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, si dhe shërbimeve tjera publike.

Menaxhimi i projekteve kapitale bëhet përmes Programit për Investime Publike (PIP). Planifikimi i projekteve në PIP duhet të bëhet në mënyrë të deajuar dhe të aprovohet nga krerët e organizatave, bazuar në analizat dhe arsyeshmërinë e tyre. Në anën tjetër, MFPT aprovon këto kërkesa të OB-ve duke u bazuar në dokumentet e paraqitura në PIP në lidhje me arsyeshmërinë dhe duke siguruar se janë në përgjegjësi dhe kompetencë të tyre.

Në këtë nivel të ulët të realizimit kanë ndikuar mos iniciimi me kohë i kërkesave nga njësitë kërkuese të organizatave, apo tejzgjatja e procedurave të prokurimit për shkak të ankesave nga operatorët në OSHP. Po ashtu, një pjesë e kontratave për punë janë ndërprerë për shkak të mos realizimit të punimeve nga operatorët ekonomik, menaxhimi jo i duhur i zbatimit të kontratave dhe mos zgjidhja e problemeve shpronësore mbetet një sfidë nga viti në vit, si shkak i të cilës tejzgjatjen punimet e kontraktuara.

Realizimi më i ulët i projekteve kapitale vërehet te këto organizata buxhetore: Ministria e Ekonomisë 11%, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë 44%, Ministria e Shëndetësisë 49%, MMPHI 63%, Komuna e Fushë Kosovës 41% dhe Komuna e Prishtinës 42%, etj.

Realizimi i ulët i projekteve kapitale te niveli qendror, ka rezultuar si pasojë e vonesave në kryerjen e punëve dhe shërbimeve sipas planit dinamik të tyre.

Në anën tjetër, ka raste të obligimeve të pa paguara që janë përcjellur në vitin vijues, si pasojë e mungesës së mjeteve buxhetore. Pagesat përmes vendimeve gjyqësore ka shënuar një rritje, çka paraqet një tregues se organizatat buxhetore ballafaqohen me mungesën e fondeve në kryerjen e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik dhe debitorëve tjerë.

Mos kryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbartimore) dhe shpenzimeve të interesit. Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbejnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ri destinuar për t'u paguar këto detyrime.

Për më tepër, në tetë komuna për 35 projekte në vlerë të përbashkët 4,732,277€, kanë përdorur fondet nga projektet për qëllime të tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër, duke mos marrë aprovimin nga kuvendi komunal.

Kishte raste ku komunat kishin hyrë në obligime kontraktuale duke nënshkruar kontrata për punë për projekte të ndryshme pa pasur zotim të mjaftueshëm të mjeteve:

- **Komuna e Prizrenit**, ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, me të theksuar te projekti “Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt” me vlerë 3,470,000€, ndërsa zotimi ishte vetëm 50,000€, dhe projekti “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatëseve në fshatin Zhur” me vlerë të kontratës 2,497,919€, ndërsa zotimi i mjeteve ishte vetëm 50,000€;
- **Komuna e Ferizajit**, ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si te projekti “Rikonstruimi i rrugëve në fshatrat Tërn-Lubovc, Nerodime, Rakaç” me vlerë të kontratës 1,000,000€, ndërsa zotimi ishte 550,000€. Po ashtu, te projekti “Ndërtimi i infrastrukturës së zonave turistike në fshatin Jezerc” me vlerë të kontratës 791,927€, për të cilin komuna nuk kishte ndarë mjete buxhetore;
- **Komuna e Malishevës** ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si te projekti “Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimin dhe parkingun nëntokësor në qytet” me vlerë 8,277,887€, ndërsa fondet e buxhetuara ishin vetëm 1,950,000€. Një tjetër rast është projekti “Ndërtimi i rrugëve, kanalizimit fekal, atmosferik dhe ndriçimi i qytetit” me vlerë të kontratës 1,099,942€, ndërsa buxheti i ndarë ishte 590,000€;
- **Komuna e Pejës**, ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si te projektet “Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Lugut të Baranit” me vlerë të kontratës 1,377,859€, ndërsa zotimi ishte vetëm 200,000€, dhe “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Varri i Sykut-Bellopaq” me vlerë të kontratës 918,214€, ndërsa zotimi ishte vetëm 50,000€; dhe
- **Komuna e Podujevës** ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si rasti me “Furnizimin me material për mirëmbajtjen e objekteve” me vlerë të kontratës 119,131€, ndërsa zotimi ishte vetëm 20,000€, dhe “Hartimi i projekteve” me vlerë të kontratës 140,000€, ndërsa zotimi ishte vetëm 3,000€.

## Shpenzimet e interesit dhe pagesat tjera

Për këto kategori janë buxhetuar gjithsej 236,266,000€ ndërsa janë realizuar shpenzime në vlerë 103,074,000€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet e interesit, pagesat për kthimin e borxhit dhe nën huazimeve, dhe kthimi i depozitave.

### Rekomandim për Qeverinë

- Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe të montiroj nëse fondet e alokuara janë të mjaftueshme dhe janë shpenzuar për projektet për të cilat janë aprovuar me buxhet;
- Të vendos mekanizma të kontrollit me qëllim që të parandalojë hyrjen në obligime kontraktuale pa buxhet të mjaftueshëm, duke analizuar mundësinë e ndërlikohjes së sistemit të SIMFK-së me e-prokurimin; dhe
- Përmes ministrive përkatëse të ndërmerr veprimet të mëtejshme për punonjësit që nuk kanë vijueshmëri në punë, të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

### 5.2.1. Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Sipas Rregullës financiare Nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2023, në 36 organizata buxhetore janë identifikuar klasifikime jo adekuate të shpenzimeve në vlerë prej 25,139,272€. Prej tyre 11,129,100€ apo 44% të nivelit qendror (11 OB) dhe 14,010,172€ apo 56% të nivelit lokal (25 komuna).

Në raport me vitin paraprak, vlera e shpenzimeve të klasifikuara në kategori jo adekuate është rritur për 14,742,480€ apo mbi 140% (në vitin 2022 vlera e tyre ishte 10,396,792€). Rritja më e theksuar është te pagesat e bëra me vendime gjyqësore, të ndikuara nga OB-të dhe buxhetimi jo adekuat i shpenzimeve.

Tabela në vijim tregon klasifikimet jo adekuate të shpenzimeve të bëra në kategori të ndryshme ekonomike.

Tabela 12 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategori ekonomike

Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB	E planifikuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	0	0	23,078	23,078
Gjithsej Pagat dhe mëditjet		0	0	23,078	23,078
	Pagat dhe mëditjet	0	38,930	1,662,311	1,701,241
Mallrat dhe shërbimet	Subvencionet dhe transferet	1,639,774	244,015	27,046	1,910,835
	Investimet kapitale	1,485,072	425,017	962,874	2,872,963
Gjithsej Mallrat dhe shërbimet		3,124,846	707,962	2,652,231	6,485,039
	Pagat dhe mëditjet	0	0	343,184	343,184
Subvencionet dhe transferet	Mallrat dhe shërbimet	0	61,375	0	61,375
	Investimet kapitale	7,855	0	0	7,855
Gjithsej Subvencionet dhe transferet		7,855	61,375	343,184	412,414
	Pagat dhe mëditjet	0	0	5,732,736	5,732,736
Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet	1,603,359	7,851,177	1,650,898	11,105,434
	Subvencionet dhe transferet	537,004	227,857	615,710	1,380,571
Gjithsej Investimet kapitale		2,140,363	8,079,034	7,999,344	18,218,741
Gjithsej keqklasifikimi për vitin 2023		5,273,064	8,848,371	11,017,837	25,139,272

Si në tabelën e mësipërme, më e ndikuar nga klasifikimi jo adekuat është kategoria e Investimeve Kapitale me 18,218,841€ apo 72%, pastaj kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve me 6,485,038€ apo 26% dhe kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve me 412,414€ apo 2%.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte ndikuar kryesisht nga buxhetimi jo i duhur me 8,848,371€ apo 35%, pastaj nga pagesat e realizuara nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore me 11,017,837€ apo 44% si dhe nga shpenzimet e bëra nga vetë organizatat buxhetore në kategori ekonomike të gabuara me 5,273,064€ apo 21%.

Në vijim janë paraqitur OB-të të cilat kanë vlerën më të lartë të klasifikimeve jo adekuate të buxhetuara, me vendime gjyqësore dhe nga shpenzimet e bëra nga vetë organizatat buxhetore nga kjo kategori në kategori ekonomike të gabuara.

Tabela 13 - Niveli qendror

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare <sup>9</sup>	Natyra e shpenzimit
MMPHI	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	7,300,565€	Realizimi i pagesave për shpenzimet e interesit të aplikuar për vonesat në kryerjen e kompensimeve të vlerës së tokës së shpronësuar bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore; pagesat që kishin të bënin me kompensimin e demit dhe fitimin e humbur të shkaktuar nga procesi i shpronësimeve; kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga ministria ndaj operatorit ekonomik si dhe pagesën e shpenzimeve të kamatës dhe shpenzimeve tjera procedurale.
MASHTI	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	1,312,353€	Furnizim me pajisje për sallat e sportit në shkollat e arsimit para universitar; blerjen e pajisjeve për mbrojtjen e objekteve arsimore për qëndrueshmëri dhe blerja e pakove; furnizim me inventar shkollor.
MINT	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	600,424€	Subvencionimi i produkteve të qumështit.
KGJK	Investimet kapitale	Subvencione dhe Transfere	270,224€	Kompensimi i demit për persona të arrestuar apo dënuar pa arsye.
MKK	Investimet kapitale	Subvencione dhe Transfere	214,750€	Furnizimi me material ndërtimor për përfitues individual

9 Për bazë janë marrë vlerat mbi 200,000€

Tabela 14 - Niveli lokal

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
Komuna e Vushtrrisë	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	2,178,523€	Pagesa për vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë.
Komuna e Prishtinës	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	1,217,757€	Shërbime urgjente të mirëmbajtjes dhe riparimeve në hapësira publike; implementimi i planit të mobilitetit-shenjzimi i shtigjeve të biçikletës; furnizim me inventar për institucionet shkollore; furnizimi me libra për bibliotekat shkollore; pastrimi I lumenjve etj
Komuna e Pejës	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	937,769€	Pagesë me vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë.
Komuna e Gjakovës	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	790,206€	Pagesë me vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë.
Komuna e Gjilanit	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	379,467€	Pagesë me vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë.
Komuna e Fushë Kosovës	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	367,718€	Pagesë me vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë.
Komuna e Deçanit	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	308,550€	Furnizime me inventar dhe shërbime të ndryshme.
Komuna e Rahovecit	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	284,095€	Pagesë me vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë.
Komuna e Vitisë	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	253,717€	Pagesë me vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë.

### Rekomandim për Qeverinë

Përmes MFPT-së të siguroj kontrolle efektive në proceset e buxhetimit me qëllim që shpenzimet të jenë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të LMFP-së dhe SNKSP-ve.



### 5.3. Analiza e shpenzimeve sipas funksionit

Shpenzimet sipas funksionit përfshijnë shërbimet publike, mbrojtjen, rendin dhe sigurinë publike, çështjet ekonomike, mbrojtjen e mjedisit, komoditetet e banimit dhe të bashkësisë, shëndetësinë, rekreacionin, kulturën dhe religjionin, arsimin, si dhe mbrojtjen sociale.

Tabela 15 - Pasqyra e pagesave sipas funksionit në tri vite (‘000 në €)

KF	Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
01	Shërbimet e përgjithshme publike	429,725	472,062	277,401
02	Mbrojta	98,135	48,822	91,802
03	Rendi dhe siguria publike	266,377	213,931	210,480
04	Çështjet ekonomike	499,052	409,194	358,492
05	Mbrojtja e mjedisit	7,883	7,880	9,491
06	Komoditetet e banimit dhe të bashkësisë	50,554	46,952	39,303
07	Shëndetësia	298,441	238,150	275,780
08	Rekreacioni, kultura dhe religjioni	80,416	54,068	60,712
09	Arsimi	395,099	346,711	340,335
10	Mbrojtja sociale	708,698	666,960	602,693
	Total <sup>10</sup>	2,834,380	2,504,730	2,266,488

Totali i shpenzimeve sipas funksionit ishin në vlerë prej 2,834,380,000€ e që në raport me vitin paraprak kanë shënuar një rritje prej 329,650,000€.

Te shumica e shpenzimeve sipas funksionit vërehet trendi në rritje i shpenzimeve nga viti paraprak e që rritja më të lartë ishte te çështjet ekonomike me 89,858,000€, te shëndetësia me 60,291,000€, te rendi dhe siguria me 52,446,000€ dhe arsimi me 48,388,000€.

Shpenzimet sipas funksionit janë prezantuar bazuar në shënimet e SIMFK-së. Nga analiza e shpenzimeve vërehet se ka shpenzime të cilat nuk janë klasifikuar drejt sipas funksionit. Rasti më i theksuar dhe i përsëritur është regjistrimi i shpenzimeve prej 80,036,714€ të cilat i takojnë mbrojtjes përderisa ishin të regjistruara gabimisht te shërbimet e përgjithshme publike.

10 Në total nuk përfshihen pagesat tjera: pagesa e borxhit, kredi dhënia për ndërmarrjet publike dhe kthimet nga fondet e depozitave

## Rekomandim për Qeverinë

Përmes MFPT-së të siguroj se planifikimi dhe realizimi i buxhetit bëhet sipas kodeve funksionale përkatëse në mënyrë që shpenzimet të paraqesin gjendjen e saktë të tyre sipas planit kontabël.

### 5.4. Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike

Shpenzimet për menaxhimin e pandemisë janë ndarë përmes Programit të Rimëkëmbjes/Ringjalljes Ekonomike dhe janë alokuar me kodet e dedikuara në planin Kontabël (00098 dhe 00099). Këto mjete janë ndarë me vendime të Qeverisë, sipas autorizimeve të ligjit të buxhetit për vitin 2023 me qëllim të zbatimit të masave të parapara nga ky program.

Për këtë qëllim në vitin 2023 ishin buxhetuar gjithsej mjete në vlerë 147,562,821€ ndërsa ishin shpenzuar 141,351,434€ apo rreth 96% e mjeteve të buxhetuara.

Tabela 16 – Totali i pagesave nga kodi 00098 dhe 00099

Përshkrimi	Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi 2022	Progresi 2023
Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (kodi 00098)	141,181,102	140,724,960	254,170,426	99%
Pakoja Emergjente (kodi 00099)	6,381,719	626,474	4,262,506	10%
Gjithsej	147,562,821	141,351,434	258,432,932	96%

Në raport me vitin paraprak ka zvogëlim të buxhetit për “Pakon e Ringjalljes Ekonomike” (00098) për 118,681,144€. Shkalla e realizimit të buxhetit për këtë pako për vitin 2023 ishte mbi 99%. Sa i përket buxhetit për “Pakon Emergjente” (00099), në raport me vitin paraprak ka zvogëlim të buxhetit për 4,006,157€, ndërsa realizimi i buxhetit për vitin 2023 ishte 10%.

Mbi 99% e mjeteve të shpenzuara në vitin 2023 në kuadër të “Pakos së Ringjalljes Ekonomike” (00098) janë shpenzuar nga niveli qendror ku pjesa më e madhe e shpenzimeve është realizuar për qëllimet si në vijim:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka shpenzuar 89,196,856€ apo rreth 63%, nga kategoria subvencione dhe transfere për mbështetjen e bizneseve, punësimit të grave, mbështetje të likuiditetit familjar etj;
- Ministria e Ekonomisë (ME) ka shpenzuar 32,598,748€ apo 23%, për subvencionim të energjisë elektrike për konsumatorët fundor me qëllim të uljes së ndikimit të rritjes së tarifave të energjisë;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka shpenzuar 6,684,218€ apo 5%, për zbatimin e masës 2.1 “Subvencionim i kredive investive”, në programin për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA);
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka shpenzuar 5,867,980€ apo 4%. për subvencionim e materialeve mësimore për nxënësit e klasës 1- 9;

- Ministria për Komunitete dhe Kthim ka shpenzuar 2,989,861€ apo 2%, për zbatimin e masës 1.9 për mbështetje të punësimit të personave nga komunitetet jo shumicë; dhe
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka shpenzuar 2,500,000€ apo 2%, për zbatimin e masës 4.3 “Mbështetje e Kulturës dhe Sportit”, përkatësisht për mbulimin e shumës së garancisë për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030.

Sa i përket nivelit lokal, shuma e mjeteve të shpenzuara nga “Pako e Ringjalljes Ekonomike” ishte 369,672€ apo rreth 0.26% e shpenzimeve të përgjithshme nga ky program. Qëllimi i shpenzimit të mjeteve në përgjithësi ka të bëjë me kompensimin e pagesave të stafit (në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale) sipas vendimeve të nivelit qendror.

Shpenzimet nga Pakoja emergjente (00099), për menaxhimin e pandemisë Covid-19 - kanë të bëjnë me mjete të ndara për nevoja të Ministrisë së Shëndetësisë dhe shkalla e realizimit të buxhetit ishte 10% nga kjo ministri.

Tabela 17 – Pagesat nga “Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (kodi 00098) sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi 2022	Progresi
Paga dhe shtesa	888,826	887,258	10,822,922	100%
Mallra dhe shërbime			9,887,961	
Subvencione dhe transfere	140,292,276	139,837,702	233,459,543	100%
Total	141,181,102	140,724,960	254,170,426	100%

Rreth 99% e buxhetit të shpenzuar për “Pakon e Ringjalljes Ekonomike” është realizuar nga kategoria “Subvencione dhe transfere” kurse pjesa tjetër e mjeteve të shpenzuara është realizuar nga kategoria “Paga dhe Mëditje”.

Tabela 18 – Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 - Pakoja Emergjente (00099) sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi 2022	Progresi
Paga dhe shtesa	206,810	204,777	188,727	99%
Mallra dhe shërbime	5,574,371	292,547	3,733,330	5%
Subvencione dhe transfere			44,542	
Investime kapitale	600,537	129,150	295,907	43%
Total	6,381,718	626,474	4,262,506	10%

Sa i përket pagesave nga kodi 00099 “Pakoja Emergjente”, rreth 47% e shpenzimeve janë realizuar nga kategoria “Mallra dhe shërbime”, 33% nga kategoria “Paga dhe shtesa”, si dhe 21% nga kategoria “Investime kapitale”.

## 5.5. Analiza e subvencionimit të Ndërmarrjeve Publike nga buxheti i shtetit

Subvencionimi i ndërmarrjeve publike për vitin 2023 ishte në vlerë 24,740,625€. Janë subvencionuar 17 ndërmarrje publike, prej tyre gjashtë (6) ndërmarrje të nivelit qendror, katër (4) janë rajonale si dhe shtatë (7) të nivelit lokal. Pjesa më e madhe e subvencionimit është realizuar nga granti qeveritar në vlerë 19,644,844€ apo 79.40%, nga Fondi zhvillimor për komunat veriore në vlerë 4,773,878€ apo 19.30%, dhe nga të hyrat vetanake të komunave në vlerë 321,904€ apo 1.30%.

Nga analiza e orientimit të subvencioneve vërehet se 97% e subvencioneve ishin për financimin e NP-ve qendrore kurse pjesa tjetër për NP rajonale (1%) dhe lokale (2%).

Në vijim kemi paraqitur qëllimin e subvencionimit për disa nga ndërmarrjet publike qendrore si pranueset e pjesës më të madhe të subvencioneve, përkatësisht:

- Subvencionimi i NP Trepça - ishte për financimin e shpenzimeve operative si: pagat e punëtorëve, energjia elektrike, naftë, furnizim me lëndë dhe pajisje për ecurinë e prodhimit, mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve/makinerve, blerjen e mjeteve të punës etj;
- Subvencionimi i Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) - ishte për të mbuluar koston e devijimeve të energjisë elektrike në komunat veriore sipas vendimi të qeverisë nr. 39/180;
- Subvencionimi i NP Trainkos – ishte për funksionalizimin e linjave të aprovuara për transportin e udhëtarëve gjatë periudhës fiskale pesë vjeçare 2023-2027 si dhe për financimin e shpenzimeve tjera operative të ndërmarrjes si: paga, qasja në binarë, për lëndë djegëse etj; dhe
- Subvencionimi i NP Infrakos – ishte për financimin e shpenzimeve operative të ndërmarrjes si: paga, energjinë elektrike, detyrimet ndaj ATK-se etj.

Po ashtu edhe qëllimi i subvencionimit të NP-ve tjera rajonale dhe lokale ishte kryesisht për mbulimin shpenzimeve operative të tyre. Organizatat me pjesëmarrjen më të madhe të subvencioneve të realizuara ishin MFPT (48%) dhe ME 46%.

Me poshtë janë paraqitur ndërmarrjet publike të subvencionuara sipas fondit burimor, nivelit dhe organizatës buxhetore financuese.

Tabela 19- Subvencionimi i Ndërmarrjeve Publike

Nr	Organizata Buxhetore Financuese	Ndërmarrja Publike Përfutuese	Fondi Burimor			Total
			Fondi zhvillimor për komunat veriore (FB-8)	Fondi Qeveritar (FB 10)	Të Hyrat vetanake të Komunave (FB 21&22)	
<b>Ndërmarrjet Publike Qendrore</b>						
1	MFPT	KOSTT SHA	4,773,878	7,106,368		11,880,246
2	Ministria e Ekonomisë	Trepça SHA		9,090,569		9,090,569
3	MMPHI&ME	Trainkos SHA		1,742,506		1,742,506
4	Ministria e Ekonomisë	Infrakos SHA		1,091,536		1,091,536
5	Ministria e Ekonomisë	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës		63,179		63,179
6	Komuna e Mitrovicës	Iber Lepenc SHA			47,790	47,790
Totali			4,773,878	19,094,158	47,790	23,915,826
<b>Ndërmarrjet Publike Rajonale</b>						
1	Ministria e Ekonomisë	KRU Hidroregjioni Jugor SHA		114,018		114,018
2	Ministria e Ekonomisë	Hidromorava SHA		73,629		73,629
3	Ministria e Ekonomisë	KRU Prishtina SHA		57,339		57,339
4	Komuna e Podujevës	KRM Pastrimi SHA			20,640	20,640
5	Komuna Mitrovicë	KRU Mitrovica SHA		5,700		5,700
Totali				250,686	20,640	271,326
<b>Ndërmarrjet Publike Lokale</b>						
1	Ministria e Ekonomisë	Ngrohtorja e qytetit		300,000		300,000
2	Komuna Gjilan	Tregu SHA			113,474	113,474
3	Komuna Istog	Stacioni i autobusëve Istog SHA			50,000	50,000
4	Komuna Mitrovicë	Stacioni i autobusëve Mitrovicë SHA			50,000	50,000
5	Komuna Obiliq	Kastrioti SHA			30,000	30,000
6	Komuna Drenas	Stacioni i autobusëve Drenas SHA			10,000	10,000
Totali				300,000	253,474	553,474
Totali i përgjithshëm			4,773,878	19,644,844	321,904	24,740,626
% e financimit sipas fondit			19%	79%	2%	100%

## 6. Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshinë shumat e pa shpenzuara të fondeve nga: paratë në llogarinë kryesore, fondi zhvillimor i mirëbesimit, paraja e gatshme transit, Kuota në Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF), llogaritë e Misioneve Diplommatike të Republikës së Kosovës, paratë e gatshme (arka) dhe avancet e hapura.

Fondet për qëllime specifike përbehen nga: Grantet e Përcaktuara të Donatorëve, të hyrat vetanake të bartura, fondi i mirëbesimit për zhvillim, të hyrat e dedikuara, të tjera (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave), grantet e BE-së për energji dhe Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja gjatë vitit 2023 dhe të bartura në vitin 2024.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh). Pjesa më madhe e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Shuma totale e parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2023 ishte 385,375,000€.

Tabela 20 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve ('000 në €)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Banka Qendrore e Kosovës	345,232	419,664	423,322
Kuotat në INF	8,395	8,210	3,734
Fondi zhvillimor i mirëbesimit	3,566	3,256	2,636
Paraja në transit	22,894	10,845	6,946
Para në llogaritë e Misioneve Diplommatike	3,899	2,527	2,068
Para të gatshme (arka)	1,389	1,233	3,484
<b>A. Gjithsej: pasuritë financiare në PG</b>	<b>385,375</b>	<b>445,734</b>	<b>442,189</b>
Bilanci i fondeve	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Garantët e përcaktuara të donatorëve	17,472	15,505	15,818
Të hyrat vetiake të bartura NQ	3,027	2,584	1,436
Të hyrat vetiake të bartura në NL	81,387	90,005	80,078
Fondi zhvillimor në mirëbesim	3,510	7,974	7,354
Të hyrat e dedikuara	3,431	2,285	467
Grantet (kontigjenca) e BE-së për energji	22,740	-	-
Të hyrat tjera	29,262	24,807	19,812
Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja	6,226	16,751	5,131
<b>B. Fonde qëllime specifike</b>	<b>167,056</b>	<b>159,911</b>	<b>130,095</b>
<b>C. Të pashpërndara</b>	<b>218,320</b>	<b>285,824</b>	<b>312,094</b>
<b>Gjithsej fondet (B+C)</b>	<b>385,375</b>	<b>445,734</b>	<b>442,189</b>

Bilanci i llogarive rrjedhëse të mbajtura në BQK është 345,232,000€ apo 90% e totalit të parasë së gatshme. Krahasuar me vitin paraprak, paraja e gatshme në fund të vitit 2023 është zbritur për 74,432,000€.

Bartja e të hyrave vetanake si të hyra të pa shpenzuara të nivelit lokal, krahasuar me vitet tjera që kishte rritje, në vitin 2023 ka shënuar rënie, e cila krahasuar me vitin e kaluar ishte në vlerë prej 8,618,000€. Gjithashtu fondet e pashpenzuara nga huamarrja krahasuar me vitin paraprak kishin një rënie të konsiderueshme në vlerë prej 10,525,000€.

## 7. Pasuritë jo financiare kapitale, jokapitale dhe stoqet

Rregullorja MF Nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jo financiare që vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit. Pasuritë jo financiare sipas klasifikimit kontabël ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, kanë vlerë financiare mbi 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja;
- Pasuritë jo kapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, kanë vlerë financiare më pak se 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja; dhe
- Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materiali për zyre.

Menaxhimi i pasurive bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrit kontabël i SIMFK-së si sistem i integruar në kuadër të MFPT-së, ku evidentohen, mirëmbahen, vlerësohen dhe raportohen pasuritë kapitale që kanë vlerë mbi 1,000€, si dhe sistemi/aplikacionit "E - pasuria" që është një sistem i integruar në kuadër të MPB-së, ku të gjitha organizatat buxhetore duhet të evidentojnë, menaxhojnë dhe raportojnë për pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet/pajisje rezervë dhe material zyre.

Rezultatet e auditimit tregojnë se shpalosjet mbi pasuritë jo financiare në vitin 2023 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive jo financiare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri, janë jo të plota. Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive janë duke vazhduar edhe me tutje si te institucionet e nivelit qendror dhe lokal ndonëse me një përmirësim krahas vitit paraprak, edhe pse vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e kontrolleve mbi pasuritë jo financiare.

Organizatat buxhetore, kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PFV-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në RVF. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Tabela 21 - Pasurit jofinanciare kapitale dhe jokapitale si dhe stoqet

Pasuritë	Institucionet	Vlera e pasurisë në RVF-BRK	Sipas Auditimit	Mbivlerësimi/ Nënvlerësimi
Pasurië kapitale mbi 1,000€	Niveli Qendror	3,168,410,661	3,130,685,225	37,725,436
	Niveli Lokal	6,627,512,643	6,684,015,095	(56,502,452)
Pasuritë kapitale nën 1,000€	Niveli Qendror	36,856,693	37,267,204	(410,511)
	Niveli Lokal	23,286,735	24,373,138	(1,086,403)
Stoqet	NQ+NL	39,708,579	40,236,227	(527,648)
<b>Total</b>		<b>9,895,775,311</b>	<b>9,916,576,889</b>	<b>(20,801,578)</b>

Pasuritë jo financiare në total ishin nënvlerësuar në një vlerë neto për 20,801,578€, nga kjo, pasuritë mbi 1,000€ janë nënvlerësuar për 18,777,016€, pasuritë nën 1,000€ janë nënvlerësuar për 1,496,914€, ndërsa nënvlerësimi i stoqeve ishte në vlerë 527,648€.

Në 2023 ka rënie të dukshme të vlerës neto të gabimit në nivel të pasurisë jofinanciare kapitale dhe jokapitale. Megjithatë, gjendja e pasurisë është përcjellë me pasaktësi, pasi që totali i nënvlerësimeve neto ishte 20,801,578€ (në vitin 2022 nënvlerësimet neto ishte 55,865,029€).

## Niveli qendror

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa organizata buxhetore kanë përfshirë në regjistra pasuri të cilat nuk i plotësojnë kriteret për tu regjistruar në regjistrat e tyre, dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në RVF-BRK është mbivlerësuar për 37,314,925€. Ndikimin më të madhë e kishte, Mbivlerësimi i pasurisë në MMPHI për 38,639,029€, dhe kryesisht nënvlerësimet e disa institucioneve tjera qendrore si (Ministria e Shëndetësisë për 530,060€, Ministria e Kulturës për 1,036,802€ dhe Ministria e Drejtësisë për 492,606€). Arsyeet e këtyre diferencave të larta vijnë kryesisht nga shkaqet si në vijim:

- Mosfunksionim i kontrolleve të brendshme;
- Mos kompetenca e duhur e zyrtarëve përgjegjës në regjistrimin e pasurive; dhe
- Aplikimin jo të duhur të normave të zhvlerësimit.

Gabimet e identifikuar apo mospërputhjet e gjendjes së pasurive kapitale dhe jo kapitale kanë rezultuar në mbivlerësimin ose nënvlerësimin e pasurisë në 13 organizata të nivelit qendror, ku përfshinë nëntë (9) ministri dhe katër (4) Agjenci të Pavarura.



Rezultatet e auditimit kanë treguar se kontrollet dhe menaxhimi i pasurive është përcjellur me disa mangësi, që kryesisht janë:

- Mos ndjekja e procedurave për shlyerjen e pasurisë (si investime në vijim) nga regjistrat dhe mosregjistrimi tek përfituesi;
- Në gjashtë (6) institucione<sup>11</sup> nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë, përderisa në pesë (5) institucione<sup>12</sup> procesi i inventarizimit nuk ishte kryer me kohë, ishte kryer pjesërisht apo nuk ishte kryer fare;
- Në katër (4) institucione<sup>13</sup> të pavarura nuk ishte përdorur sistemi e-pasuria;
- Në pesë (5) institucione kishte mangësi në regjistrimin e pasurive në klasat e duhura përfshi edhe si investime në vijim;
- Në tri (3) Ministri kishte klasifikim joadekuat dhe aplikim i gabuar i normave të zhvlerësimit; dhe
- Në një Ministri është mbajtur pasuria e tjetërsuar në regjistrat e pasurisë.

## Niveli Lokal

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa komuna nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë, dhe si rezultat i kësaj, vlera e pasurive e prezantuar në RVF-BRK është nënvlerësuar për 57,588,855€. Komunitat që kishin ndikim më të madh në këtë gabim ishin komuna e Deçanit me një nënvlerësim prej 49,010,000€, Komuna e Leposaviqit me nënvlerësim prej 2,783,678€, Podujeva me 1,541,210€ dhe Komuna e Vushtrrisë me 2,139,532€.

Nga gjithsej 38 komunat e audituara, 15 prej tyre kanë mbivlerësuar /nënvlerësuar pasuritë e prezantuara, ose 39.5% e komunave të audituara nuk i kanë prezantuar saktë pasuritë kapitale dhe jo kapitale.

Mangësitë në kontrolle dhe menaxhim të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek komunat janë:

- Në pesë (5) komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë, përderisa në gjashtë (6) komuna procesi i inventarizimit nuk ishte kryer me kohë, ishte kryer pjesërisht apo nuk ishte kryer fare; dhe
- Në shtatë (7) komuna kishte mangësi në regjistrimin e pasurive në klasat e duhura përfshi edhe investimet në vijim.

<sup>11</sup> MFPT, MKRS, MKK, ME, MPB dhe KQZ

<sup>12</sup> MINT, MMPHI, SHSKUK, FSSH dhe KGJK

<sup>13</sup> AAC, ZRRE, AKP dhe ASHNA

## Stoqet për Nivelin Qendror dhe Lokal

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre sipas RVF-BRK janë 39,708,579€, ndërsa sipas auditimeve individuale ishin 40,236,227€ me një nënvlerësim prej 527,648€. Nënvlerësimi neto i stokut, vjen kryesisht si rezultat i raportimit të gabuar nga Komuna e Shtimes me një nënvlerësim prej 499,330€ dhe nënvlerësimin nga Ministria e Financave në RVF/ BRK prej 81,121€, ndërsa mbivlerësime kishte Fondi i Sigurimeve Shëndetësore prej 18,320€ dhe Komuna e Obiliqit prej 34,000€ etj.

### Rekomandimet për Qeverinë

- Qeveria përmes MFPT duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të kontrolleve të brendshme dhe të rrisë kompetencën e stafit përgjegjës në regjistrimin e pasurive në mënyrë që regjistrat e pasurive të prezantohen në mënyrë të drejtë. Po ashtu, Qeveria përmes MFPT-së (Thesarit) me rastin e transferimit të pasurive nga një Organizatë tjetra, të aplikojë procedura të nevojshme që sigurojnë se pasuria është bartur dhe regjistruar tek përfituesi i saj; dhe
- Qeveria duhet të sigurojë përdorimin e aplikacionit e-pasuria nga të gjitha organizatat buxhetore.

## 8. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme (LLA) përfshijnë shumën e të drejtave të organizatave buxhetore kundër palëve për ofrimin e shërbimeve si rezultat i aktivitetit të tyre. Këto llogari burojnë nga shumat e faturuara e të pa arkëtuara. OB-të janë të detyruara të bëjnë inkasimin e LLA në kohë reale, për faktin se vjetërsia e këtyre llogarive vështirëson inkasimin dhe rrezikon me humbje financiare për OB-të.

Të arkëtueshmet paraqesin një zë të rëndësishëm për qëllime të menaxhimit financiar. OB-të që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të shumave të faturuara e të pa arkëtuara të cilët shërbejnë si bazë për raportimin financiar. Përderisa shënimet mbahen kryesisht në mënyrë manuale ato më pas konsolidohen si për nevoja të raportimit financiar të organizatave, edhe për pasqyrat e konsoliduara financiare.

Vlera e përgjithshme e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në pasqyra individuale financiare dhe RVF-BRK ishte 918,025,967€ (nga këto 669,401,679€ të nivelit qendror dhe 248,624,288€ të nivelit lokal). Ndërsa, sipas auditimit vlera e llogarive të arkëtueshme është 920,439,554€, me një nënvlerësim prej 2,413,587€ (nënvlerësimi ishte për 2,194,854€ te niveli lokal dhe 218,733€ te niveli qendror).

Bazuar në RVF 2023 vlera e llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak ishte rritur për 76,927,603€, ose rreth 9% në krahasim me vitin paraprak. Po ashtu, nga tabela vërehet një trend i rritjes të llogarive të arkëtueshme ndër vite. Kjo tregon se institucionet publike nuk kanë marrë masat e duhura për mbledhjen e borxheve të pa arkëtuara.

Tabela 22 - Përmbledhja e llogarive të arkëtueshme në tre vitet e fundit

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2023	Sipas RVF -BRK		
		2023	2022	2021
Niveli qendror	669,620,412	669,401,679	607,974,066	564,294,945
Niveli lokal	250,819,142	248,624,288	232,972,067	213,753,695
Total	920,439,554	918,025,967	840,946,133	778,048,640

## Llogaritë e arkëtueshme në nivelin qendror

Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në RVF të vitit 2023 nga niveli qendror ishte 669,401,679€, ndërsa sipas auditimit, kjo vlerë ishte 669,620,412€, pra me një nënvlerësim prej 218,733€. Edhe këtë vit, veprimet e ndërmarra për prezantimin e saktë të tyre nuk ishin mjaftueshëm efikase.

Vlerën e përgjithshme të llogarive të arkëtueshme për nivelin qendror rreth 87.4% e përbën Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) në vlerë prej 585,333,167€, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) në vlerë prej 39,799,219€ apo 6% dhe Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në vlerë prej 23,159,864€ apo 3.5%. Krahasuar me vitin paraprak llogaritë e arkëtueshme në nivelin qendror karakterizohen me një trend rritës prej rreth 10%, për dallim prej vitit të kaluar ku rritja ka qenë rreth 8%.

Në vijim janë të prezantuara ministrinë të cilat i kanë prezantuar në vlera jo të sakta llogaritë e arkëtueshme në pasqyra vjetore financiare (ndryshimet në mes të pasqyrave financiare të OB-së dhe vlerës sipas auditimit):

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve i kishte nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë prej 225,281€ si pasojë e mos prezantimit të tyre nga Njësia e Inteligjencës Financiare; dhe
- Ministria e Punëve të Brendshme kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme për 6,550€, pasi ishin prezantuar edhe gjobat e gjykatave.

## Llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal

Vlera e llogarive të arkëtueshme të prezantuara në RVF të vitit 2023 për 38 komuna ishte 248,624,288€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë ishte 250,819,142€, me një nënvlerësim për 2,194,854€.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit lokal përbëhen nga tatimi në pronë, taksat ndërtimi, lejet e urbanizimit, qiratë dhe të tjera. Në totalin e të arkëtueshmeve, për nivelin lokal, Komuna e Prishtinës merr pjesë me 30%, Komuna e Pejës me 9%, komuna e Prizrenit me 9%, Komuna e Ferizajit 7% etj. Krahasuar me vitin paraprak llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal karakterizohen me një trend rritës prej rreth 7%, për dallim prej vitit të kaluar ku rritja ka qenë 9%.

Në vijim janë të paraqitura komunat të cilat i kanë nënvlerësuar LLA në pasqyrat individuale financiare (ndryshimet në mes të pasqyrave vjetore financiare të OB-së dhe vlerës sipas auditimit):

- Komuna e Graçanicës për 1,418,635€, si rezultat i mos prezantimit të plotë të borxheve të pa arkëtuara nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë nga vitet e mëparshme;
- Komuna e Malishevës për 862,528€, si pasojë e mos nxjerrjes së shënimeve nga Protax për shumat e faturuara dhe të painkasuara për tatimin në pronë të tokave dhe parcelave për periudhën 2019-2023;
- Komuna e Ferizajit për 38,868€, si rezultat i mos shpalosjes së kësteve të papaguara për lejet ndërtimore dhe nënvlerësimit të llogarive prej 1,483€ për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Në vijim janë të paraqitura komunat të cilat i kanë mbivlerësuar LLA në pasqyrat individuale financiare (ndryshimet në mes të pasqyrave financiare të OB-së dhe vlerës sipas auditimit):

- Komuna e Ferizajit për 87,625€, për faktin se gjatë auditimit nuk janë ofruar dëshmi për vlerën e prezantuar të llogarive në pasqyra financiare;
- Komuna e Suharekës për 20,562€, dhe Komuna e Fushë Kosovës për 2,971€, për shkak të ngarkesës me tatim në pronë për prona të cilat ishin në pronësi komunale; dhe
- Komuna e Shtimes për 15,500€, pasi që gjatë auditimit nuk ka ofruar dëshmi adekuate që i japin të drejtë Komunës për arkëtimin e këtyre mjeteve, dhe mbivlerësimit të llogarive nga qiraja për shfrytëzimin e pronës.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të duhura në mbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme dhe raportimin e drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

### **Rekomandim për Qeverinë**

**Qeveria në koordinim me MFPT dhe MAPL duhet të sigurojnë një strategji të qëndrueshme dhe efektive të mbledhjes së llogarive të arkëtueshme përmes rivlerësimit të mekanizmave aktual për inkasimin e tyre. Po ashtu, duhet siguruar raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme si dhe analizuar strukturën e tyre, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe.**

## **9. Detyrimet e papaguara dhe kontingjente**

### **Detyrimet e papaguara**

Detyrimet e papaguara paraqesin faturat e pranuar për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre.

Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për shpenzimin e parasë publike, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit/punëve (urdhërblertjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Por një gjë e tillë nuk respektohet çdo herë.

Detyrimet e papaguara sipas RVF-BRK janë 158,650,800€, ndërsa sipas auditimit janë 158,323,150€, si rezultat i kësaj kemi një mbivlerësim prej 327,650€. Krahasuar me vitin paraprak sipas RVF-2023 detyrimet janë rritur për 8,954,176€ apo rreth 6%.

Tabela 23 - Detyrimet e papaguara në tri vitet e fundit

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2023	RVF-BRK 2023			Krahasimi 2023 - 2022/ në %
		2023	2022	2021	
Niveli qendror	131,822,101	131,979,380	129,409,700	160,214,465	2%
Niveli lokal	26,501,049	26,671,420	20,286,924	30,558,368	31%
Total	158,323,150	158,650,800	149,696,624	190,772,833	6%

## Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Sipas auditimit vlera e detyrimeve të papaguara në raport me RVF-BRK në nivelin qendror ishte mbivlerësuar për 157,279€.

Rritja më e theksuar e detyrimeve ka ndodhur tek Ministria e Mbrojtjes si rezultat i kthimit të pagesave nga Banka Qendrore e Kosovës, pasi që banka ndërmjetësuese nuk e kishte kryer transaksionin me kohë.

## Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Si rezultat i prezantimit të gabuar të detyrimeve në PVF individuale gabimet janë bartur edhe në totalin e detyrimeve të RVF-BRK-së. Sipas auditimit vlera e detyrimeve në raport me RVF-BRK në nivelin lokal ishte mbivlerësuar për 170,371€.

Komunat me detyrimet më të larta janë ajo e Ferizajit me 3,941,295€ apo 15% të borxheve të nivelit lokal si dhe Prishtina me 3,058,755€ apo 12.5%.

Shpalosjet e pasakta të detyrimeve paraqesin një pasqyrë jo të drejtë të pozitës financiare të OB-ve dhe Qeverisë ku mund të rezultojnë me vendime joadekuate gjatë procesit të buxhetimit. Kontrollat e dobëta me rastin e harmonizimit të të dhënave rrezikojnë identifikimin, raportimin e saktë dhe të plotë të detyrimeve duke vënë në pikëpyetje edhe kredibilitetin e pasqyrave.

**Rekomandim për Qeverinë**

**MFPT duhet të vendos kontrole përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe aty ku vëren devijime nga afatet ligjore të ndërmerren masa.**

**Detyrimet kontingjente**

Në pjesën e detyrimeve, shpalosen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të krijojnë detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe implikacioneve tjera financiare në lidhje me to.

Në RVF-BRK, detyrimet kontingjente për vitin 2023 janë gjithsej 331,978,298€, ndërsa sipas auditimit janë 351,769,374€. Bazuar në këto analiza rezulton se detyrimet kontingjente ishin të nënvlerësuar në total për 19,791,076€.

Në nënvlerësimin e kësaj kategorie kanë ndikuar gabimet në shpalosjen e tyre në PVF individuale si dhe mungesa e komunikimit të mirëfilltë në mes OB-ve dhe avokaturës së shtetit. Në raport me vitin paraprak sipas RVF-BRK kemi një zvoglim të lehtë të këtyre detyrimeve prej 6,687,918€ apo rreth 2%. Është treguar progres në zvogëlimin e detyrimeve kontingjente në nivel të përgjithshëm edhe pse trendi i rënjes ishte mjaft i vogël.

Tabela 24 - Përmbledhje e detyrimeve kontingjente

Detyrimet kontingjente	Sipas auditimit 2023	Sipas RVF-BRK-së 2023			Krahasimi 2023 - 2022/ në %
		2023	2022	2021	
Niveli qendror	208,901,336	191,724,368	200,726,803	179,428,461	-4%
Niveli lokal	142,868,038	140,253,930	137,939,413	57,420,871	2%
Gjithsej	351,769,374	331,978,298	338,666,216	236,849,332	-2%

**Detyrimet kontingjente të nivelit qendror**

Vlera e detyrimeve kontingjente të nivelit qendror sipas RVF-BRK-së ishte 191,724,368€, ndërsa sipas auditimit 208,901,336€ me një nënvlerësim për 17,176,969€. Në vijim janë prezantuar institucionet të cilat kanë nënvlerësuar/mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlera më të larta:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 16,534,867€;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 1,580,249€;

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 459,386€; dhe
- Fondi i Sigurimit Shëndetësor, ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 545,200€.

Komunikimi jo efektiv në mes zyrtarëve përgjegjës të Ministrive dhe Avokaturës Shtetërore, gabimet në trajtimin e detyrimeve kontingjente si dhe kontrollet e dobëta rreth monitorimit mbarëvajtjes së lëndëve në procese gjyqësore ishin arsytet më të shpeshta të mbi apo nënvlerësimit të detyrimeve kontingjente.

## Detyrimet kontingjente të nivelit lokal

Detyrimet kontingjente ndaj komunave janë të natyrës së ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilarë e deri tek paditë për shpronësime. Vlera e detyrimeve kontingjente të nivelit lokal sipas RVF-BRK-së ishte 140,253,930€ ndërsa sipas auditimit ishte 142,868,038€ me një nënvlerësim prej 2,614,108€ (prej tyre: nënvlerësimi ishte 10,019,231€ kurse mbivlerësimi ishte 7,405,123€).

Në vijim janë prezantuar komunat të cilat i kanë mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlera më të larta:

- Komuna e Prishtinës i kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 9,429,692€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve në menaxhimin e regjistrit të detyrimeve kontingjente; dhe
- Komuna e Deçanit i kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 2,009,250€ si pasojë e mungesës së komunikimit brenda departamenteve të komunës.

Komunikimi jo efektiv mes sektorit të financave dhe përfaqësuesve ligjor të komunave, gabimet në trajtimin e detyrimeve kontingjente si dhe kontrollet e dobëta ishin arsytet më të shpeshta të mbivlerësimit/nënvlerësimit të detyrimeve kontingjente të nivelit lokal.

Mbivlersimi dhe nënvlersimi i detyrimeve të papaguara dhe kontigjente krijojnë një pasqyrë jo të saktë të gjendjes financiare të institucioneve dhe mund të çojnë në vendime të gabuara buxhetore dhe strategjike, duke rrezikuar besueshmërinë e pasqyrave vjetore financiare. Po ashtu edhe pagesat shtesë për procedurat gjyqësore dhe përmbartimore rrisin kostot e përgjithshme të organizatave buxhetore, duke çuar në shpenzime të panevojshme dhe duke dëmtuar kapacitetin e tyre për të realizuar projekte të planifikuara.

### **Rekomandim për Qeverinë**

**Që përmes Ministrisë së Drejtësisë (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinim me zyret ligjore të organizatave buxhetore të verifikojë vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalsjet në RFV-të të jenë të sakta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsytet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korigjohen.**

## 10. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Mbështetur në LMFPP, Neni 40, Pika 1, kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi, dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë.

Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe vendimeve të përmbaruesve privat për vitin 2023 ishin në vlerë 51,936,244€. Në raport me të dhënat e vitit 2022, shuma e këtyre pagesave është rritur për 5,586,897€ apo 12%. Trendi i këtyre pagesave (si në tabelë) në raport me vitin e kaluar ka shënuar një rritje, çka paraqet një tregues se organizatat buxhetore ballafaqohen me mungesën e fondeve në kryerjen e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik dhe debitorëve tjerë.

Tabela 25 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore (në €uro)


Pagesat sipas kategorive	2023	2022	2021
Pagat dhe shtesa	18,150,858	16,075,491	19,998,545
Mallrat dhe shërbimet/komunalitë	8,919,733	5,142,784	10,697,725
Subvencione dhe transfere	1,207,926	1,274,649	1,237,288
Investimet kapitale	23,657,727	23,856,425	19,984,071
Total	51,936,244	46,349,349	51,917,629

Mos kryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbarimore) dhe shpenzimeve të interesit. Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbejnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ri destinuar për t'u paguar këto detyrime.

Në diagramin e mëposhtëm, janë pasqyruar tetë (8) prej OB-ve tek të cilat janë ekzekutuar pagesa në vlera më të mëdha se 2 milion€, e të cilat e përbejnë 62% të shumës së pagesave të kryera me vendime gjyqësore apo mbi 32 milion€. si:



Grafikoni 2 – Pagesat sipas vendimeve gjyqësore



Nga analiza e shpenzimeve të vendimeve gjyqësore në SIMFK dhe bazuar në auditimet individuale të OB-ve, është vërejtur se në shumicën e këtyre pagesave, Thesari nuk e ka bërë ndarjen e shpenzimeve të borxhit kryesor kundrejt shpenzimeve të procedurave përbarimore gjyqësore, siç është e paraparë me planin kontabël.

Sipas evidencave tjera të Thesarit në lidhje me ndarjen e këtyre shpenzimeve jashtë SIMFK-së dhe bazuar në këto informata, vërehet se nga totali i pagesave me vendime gjyqësore/përbarimore, shpenzimet shtesë përtej borgjit kryesor ishin 7,899,248€, apo 15%.

Tabela 26 - Pagesat e vendimeve gjyqësore dhe përbarimore sipas nivelit të qeverisjes (në €)

Pagesat sipas kategorive	2023	2022	2021
Niveli qendror	11,734,942	9,887,292	20,010,276
Niveli lokal	40,201,302	36,462,057	31,907,353
Total	51,936,244	46,349,349	51,917,629

## Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit qendror

Pagesat për organizata të nivelit qendrorë ishin 11,734,942€, apo rreth 23% e totalit të vendimeve gjyqësore. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me pagesa të shpronësimeve si rezultat i ankesave të pronarëve që kanë qenë pjesë e procesit të shpronësimit dhe pjesa tjetër për kompensimin e punëtorëve për paga jubilarë dhe përcjellëse të cilat ishin të parapara sipas kontratës kolektive por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave.

## Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit lokal

Pagesat në nivelin lokal ishin në vlerë prej 40,201,302€ apo mbi 77% e totalit të vendimeve gjyqësore. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me kompensimin e punëtorëve për paga jubilarë, përcjellëse dhe shujtat të cilat ishin të parapara sipas kontratës kolektive por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave, vonesa në pagesat e faturave nga ana e OB-ve për dhe mungesës së mjeteve buxhetore.

### Rekomandim për Qeverinë

Qeveria përmes institucioneve relevante të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive, shpronësimet, vonesat në pagesa dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime shtesë nga proceset eventuale gjyqësore.

### Rekomandim për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministri në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të siguroj që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbartimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.

## 11. Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2023, numri i planifikuar i të punësuarve për nivelin qendror dhe lokal ishte 88,738, përderisa numri i të punësuarve sipas RVF-BRK-së ishte prej 83,604, duke përfshirë këtu edhe numrin e asamblistëve të komunave të cilët paguhen përmes sistemit të pagave dhe nga kategoria paga dhe shtesat. Pra numri i të punësuarve aktual përfshinë të gjithë nëpunësit të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me organizatat buxhetore përkatëse dhe janë pjesë e sistemit të menaxhimit të pagave (Payroll).

### Të punësuarit jashtë listës së pagave

Sipas RVF-BRK-së për vitin 2023, numri i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 441 (niveli qendror 289 ndërsa niveli lokal 152). Numri më i lartë i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte në Universitetin e Prishtinës 140<sup>14</sup>, SHSKUK 65, Zyra e Kryeministrit 43, Komuna e Fushë Kosovës 42, Komuna e Ferizajt 31 etj.

Krahasuar me vitin paraprak numri i të punësuarve të kësaj kategorie ishte zvogëluar për 40.

<sup>14</sup> Referuar RVF të OB-së për vitin 2023, ky numër pasqyron angazhimin e profesorëve të jashtëm dhe studenteve praktikant të cilët kanë ligjëruar në Universitetin Veror si dhe në Fakultetin e Arteve.

## Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV)

Sipas RVF-BRK për vitin 2023, numri i të angazhuarve përmes MShV-ve ishte 1,422, që krahasuar me vitin paraprak numri i tyre ishte zvogëluar për 142.

Sipas raporteve individuale të auditimit për vitin 2023 angazhimi i stafit me MSHV ishte për detyra specifike, por kishte raste edhe për plotësimin e pozitave të rregullta. Po ashtu, kishte raste kur nuk ishin aplikuar procedurat përkatëse për angazhimin e tyre.

Numri më i lartë i të angazhuarve me MSHV në nivelin qendror ishte në ZKM me 367 persona, prej tyre 364 zyrtarë të angazhuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës për regjistrimin e popullsisë. Përveç, ZKM-së Ministria e kulturës vazhdon të ketë numër të lartë të punësuarve me MSHV 158 të punësuar.

Përderisa në nivelin lokal komunat të cilat kanë numrin më të madhe të angazhuarve me MSHV janë: Komuna e Prishtinës kishte angazhuar 204 punonjës dhe Komuna e Gjilanit kishte angazhuar 73 punonjës.



# *Kapitulli - II*

---

## *AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË*



## Përmbledhje e opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve

ZKA për vitin 2023, ka publikuar 86 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë OB-të për nivelin qendror dhe atë lokal, tre (3) auditime me informata të klasifikuara dhe dy (2) auditime të veçanta për pajtueshmëri. Auditimi i këtyre raporteve është kryer në bazë të metodologjisë së auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë në përputhje me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Në bazë të kësaj kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore, si dhe konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën Organizatë Buxhetore (OB).

Nga auditimi i 86<sup>15</sup> PFV individuale, prej tyre 51 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 35 me opinion të modifikuar/kualifikuar. Krahasuar me vitin 2022 është po thuajse gjendja e njëjtë (53 raporte kishin opinion të pamodifikuar dhe 33 opinion të modifikuar). Ndërsa, nga auditimi i 12 Ndërmarrjeve Publike, ka rezultuar se tre (3) janë me opinion pamodifikuar dhe nëntë (9) me opinion të modifikuar.

Vlen të theksohet se në nivelin qendror ka një përmirësim në lidhje me raportimin financiar, ku në vitin 2023 ka 12 opinione të modifikuara ndërsa në vitin 2022 kishte 17 opinione të modifikuara, ndërsa tek niveli lokal në vitin 2023 ka 23 opinione të modifikuara që krahasuar me vitin 2022 kishte 16 opinione të modifikuar, që tregon një gjendje jo të mirë sa i përket raportimit financiar.

Në lidhje me konkluzionet për pajtueshmëri për OB-të, 37 raporte të auditimit kanë rezultuar me konkluzion se organizatat buxhetore kanë punuar në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi, ndërsa 49 të tjera nuk kanë vepruar në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Krahasuar me vitin 2022 vërehet një ulje e numrit të OB-ve të cilat menaxhimin e shpenzimeve dhe të hyrave e kanë në pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi për faktin se në vitin 2022 janë dhënë 41 konkluzione të pamodifikuara dhe 45 të modifikuara. Ndërsa te NP-të ka rezultuar se dy (2) raporte janë me konkluzion të pamodifikuar dhe 10 me konkluzion të modifikuar.

Konkluzioni i përgjithshëm është se organizatat buxhetore në nivelin qendror kanë bërë përmirësime si në aspektin e raportimit financiar e ashtu edhe në aspektin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore, përderisa organizatat e nivelit lokal nuk kanë ndonjë progres pozitiv. Sa i përket NP-ve, konkluzioni i auditimit është se shumica e ndërmarrjeve publike përkundër progresit gjatë vitit 2023 edhe më tutje janë përcjellë me parregullsi ligjore kryesisht të shpenzimeve të pagave, shpenzimeve operative, menaxhimi i të hyrave dhe pasqyrat vjetore financiare.

15 Në vitin 2023, Auditimi i Doganës dhe Administratës tatimore janë të inkompletuar në MFPT, ndërsa Agjencia për Ndhimë Juridike Falas në kuadër të MD dhe Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në kuadër të MKRS-së.

Tabela 27 - Numri i rekomandimeve sipas kategorive për OB-të dhe NP-të për vitin 2023

Nr.	Kategorit ekonomike	Niveli qendror	Niveli lokal	Ndërmarrjet Publike	Totali
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	6	6	14	26
2	Pagat dhe mëditjet	15	11	15	41
3	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalit	42	57	0	99
4	Çështjet e përbashkëta (MSh dhe IK)	5	21	21	47
5	Investimet kapitale	25	88	0	113
6	Subvencionet dhe transferet	7	22	0	29
7	Të hyrat	3	37	10	50
8	Obligimet e papaguara	10	21	16	47
9	Detyrimet Kontigjente	8	9	0	17
10	Llogaritë e arkëtueshme	6	38	19	63
11	Pasuritë	48	42	33	123
12	Auditimi i Brendshëm	4	17	3	24
13	Sistemet Informative	/	/	2	2
	Total	179	369	133	681

Në raportet individuale të auditimit të OB-ve për vitin 2023 kemi dhënë 548 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Nga 548 rekomandime 229 janë rekomandime të reja, 272 të përsëritura dhe 47 pjesërisht të përsëritura. Kategoritë me nivelin më të lartë të rekomandimeve janë ajo e investimeve kapitale, mallrave e shërbimeve dhe pasurive. Sa u përket Ndërmarrjeve Publike, kemi dhënë 133 rekomandime, të cilat janë kryesisht në kategoritë e pasurive, obligimet e papaguara, llogaritë e arkëtueshme etj. Derisa sa i përket auditimeve të pajtueshmërisë dhe performancës, temat e auditimit janë specifike dhe nuk kanë të bëjnë me ndarje të statusit të rekomandimeve si në tabelë.



Tabela 28 Rekomandimet e dhëna sipas llojeve e auditimit për vitin 2023

Subjektet e Audituar	Rekomandime të reja	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura	Total rekomandime
Niveli Qendror	80	70	29	179
Niveli Lokal	149	202	18	369
Ndërmarrjet Publike	75	48	10	133
Auditimet e Pajtueshmërisë <sup>16</sup>	12	/	/	12
Auditimet e Performancës <sup>17</sup>	124	/	/	124
<b>Totali i Rekomandimeve</b>	<b>440</b>	<b>320</b>	<b>57</b>	<b>817</b>

## 1. Niveli Qendror

### 1.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

ZKA-ja për vitin 2023, ka finalizuar 48 raporte të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë për nivelin qendror, ku përfshihen auditimet për ministrinë dhe institucionet e pavarura.

Auditimet janë kryer bazuar në metodologjinë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Prandaj, mbështetur në këtë bazë, ne kemi dhënë opinionet e auditimit për pasqyrat financiare në përputhje me SNISA-t, si dhe kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën OB. Opinionet e auditimit në lidhje me pasqyrat financiare vjetore të OB-ve, të nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 29 - Lloji dhe numri i opinionëve për nivelin qendror për vitin 2023

Subjektet e audituar	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror <sup>18</sup>	12	9	21
Institucionet e pavarura	24	3	27
<b>Total</b>	<b>36</b>	<b>12</b>	<b>48</b>

16 Temat e auditimit: Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave në MSH dhe Dhënia në shfrytëzim e pronave komunale dhe monitorimi i tyre në Komunën e Ferizajit.

17 Temat e audituar për auditimet e performances janë të reja, prandaj nuk ka ndarje tjera të tyre në tabelë.

18 Në institucionet e nivelit qendror janë: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosoves, Fondi i Sigurimeve Shendetesore, SHSKUK dhe RTK. Derisa këtë vit, Dogana dhe ATK janë në kuadër të MFPT-së.

Nga 48 raportet e auditimit të organizatave të nivelit qendror (përfshirë edhe institucionet e pavarura) 36 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 12 me opinion të kualifikuar.

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar në kualifikim të opinionit janë si në vijim:

- Mbivlerësimi i pasurive si pasojë e gabimeve në regjistrimin e pasurive kapitale, mos aplikimit të drejtë të zhvlerësimit, si dhe mos bartjes së pasurive të përfunduara të financuara nga ana e ministrive për komunat që tashmë kishin pronësinë dhe kontrollin e këtyre pasurive. Në anën tjetër, ka raste të nënvlerësimit të pasurive si rezultat i mos regjistrimit në regjistrat kontabël të pronave dhe pasurive të tjera.
- Klasifikimi dhe raportimi jo i duhur i shpenzimeve, i ndikuar kryesisht nga ndarjet e mjeteve me ligj të buxhetit në kategoritë jo adekuate dhe pagesat në bazë të vendimeve gjyqësore përmbartimore;
- Pagesa për punonjësit e cila ishte bërë në mungesë të vijueshmërisë së plotë në punë. Numri i të punësuarve për këtë kategori të punonjësve ishte 107 (MMPHI 62 punonjës, MINT 25 punonjës dhe MKK 20 punonjës). Vlera totale e këtyre pagesave për vitin 2023 ishte 640,599€. Vlen të përmendet se krahasuar me vitin e kaluar, ka përmirësime sa i përket kësaj çështje, duke qenë se, MKRS dhe MASHT e kishin adresuar këtë çështje. MASHT u kishte siguruar kushte pune këtyre punonjësve dhe kishte siguruar vijueshmërinë e rregullt të tyre, përderisa MKRS kishte pezulluar pagesat deri në gjetjen e një alternative.
- Informata të pasakta për detyrime kontingjente që kishin rezultuar nga nënvlerësimi i tyre për shkak të mos evidentimit të plotë të tyre në regjistrat përkatës. Në anën tjetër ka raste të mbivlerësimit të këtij regjistri, si pasojë e përfshirjes në regjister të lëndëve të cilat kanë përfunduar.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e mos funksionimit të plotë të kontrolleve të brendshme të organizatave buxhetore për t'i parandaluar këto gabime. Raportimi financiar ka një përmirësim të theksuar në krahasim me vitin paraprak, kjo pasi që, krahasuar me vitin e kaluar ku ishin dhënë 17 opinione të kualifikuara për OB-të e nivelit qendror, këtë vit janë dhënë 12 opinione të kualifikuara.

## 1.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me OB-të e nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 30 - Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin qendror për vitin 2023

Subjektet e audituara	Konkluzion i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror <sup>19</sup>	10	11	21
Institucionet e pavarura	24	3	27
Total	34	14	48

<sup>19</sup> Në institucionet e nivelit qendror janë: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës, Fondi i Sigurimeve Shendetesore, SHSKUK dhe RTK

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar në kualifikim të konkluzioneve janë si në vijim:

- Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave ku si pasojë ishin shpërblyer me kontratë operatorë të pa përgjegjshëm apo ata që kishin ofertuar me çmime jo normalisht të ulët, si dhe mangësi të tjera që lidhen me procedurat e prokurimit si mosrespektim i afateve ligjore, mangësi në aplikimin e kërkesave të prokurimi etj
- Dobësi në menaxhimin e kontratave që kishin rezultuar me tejkalime të vlerës së kontratave, ndryshime të sasive të kontraktuara në mungesë të aprovimeve, ndryshime të kushteve kontraktuale duke mos zbatuar dispozitat ligjore etj;
- Vonesa në pagesën e obligimeve, me ç' rast faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Këto mangësi vinin si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pagesës së faturave;
- Mos arsyetimi i shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve siç përcaktohet me marrëveshje; dhe
- Angazhimi i punonjësve për shërbime të veçanta për shërbime intelektuale këshillëdhënëse për t'i plotësuar pozitat e rregullta të punës dhe angazhimi i tyre në mungesë të procedura të prokurimit duke anashkaluar konkurrencën e hapur.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e mos funksionimit të plotë të kontrolleve të brendshme të organizatave buxhetore për t'i parandaluar këto gabime. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret në fuqi ka një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin paraprak, pasi që krahasuar me vitin e kaluar ku ishin dhënë 15 konkluzione të kualifikuara për OB-të e nivelit qendror, këtë vit janë dhënë 14 konkluzione të kualifikuara.

### 1.3. Çështje tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Çështjet më të shpeshta dhe të përsëritura nga viti në vit në institucionet e nivelit qendror, në bazë të kategorive ekonomike, duke i përjashtuar çështjet të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit financiare dhe konkluzionin për pajtueshmëri janë paraqitur si më poshtë:

#### Paga dhe shtesa

Mbajtja e pozitave të rregullta udhëheqëse me zëvendësues përtej afatit ligjor, e ndikuar kryesisht nga mungesa e veprimeve konkrete të ministrive/agjencive përkatëse për hartimin e rregulloreve të reja për ri-organizim të stafit.

#### Mallra dhe shërbime

Mangësi në procedimin e pagesave pasi që zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve ishte bërë pas pranimit të faturës, kjo si shkak i moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike nga ana e organizatave.

## Investime kapitale

Për vitin 2023, për kategorinë e Investimeve kapitale, buxheti i planifikuar Ministritë dhe Institucionet e Pavarura ishte në vlerë 570,676,209€, i cili është është shpenzuar prej 350,000,876€ apo 61%.

Mangësitë që janë përcjellur lidhur menaxhimin e projekteve kapitale, janë identifikuar që nga planifikimi deri në ekzekutimin e tyre. Janë identifikuar projekte të ndryshme kapitale të cilat nuk janë realizuar. Rjedhimisht nuk ka pasur inicim për procedura të prokurimit nga njësitë kërkuese, zgjatje të proceseve të prokurimit për shkaqe të ndryshme, anulime të procedurave dhe ndërprerje të kontratave.

Në fazën e ekzekutimit të projekteve, kishte vonesa në realizimin e punimeve të projekteve kapitale në raport me afatet kohore të kontraktuara. Kjo gjendje ishte ndikuar nga planifikimi jo i mirë që vinte nga mungesa e një analize të mirëfilltë para inicimit të projekteve kapitale apo probleme tjera procedurale dhe pronësore.

Mangësi në pranimin e furnizimeve apo pajisjeve që kishin të bënin me mospranimin e pajisjeve për të cilat ishte bërë pagesa. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve nga komisionet e pranimin dhe nga mungesa e monitorimit të duhur nga menaxheri i kontratës.

## Subvencione dhe transfere

Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes, si dhe përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, dukuri që vazhdon të paraqitet si e gjetur vit pas viti. Këto mangësi vazhdojnë të ndodhin si shkak i mungesës së interpretimit përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale. Kjo çështje është trajtuar ndër vite në raportet e auditimit, megjithatë krahasuar me vitin paraprak ka një progres në zvogëlimin e këtyre pagesave të parregullta.

Parregullsi sa i përket procesit të subvencionimit që lidhet me procesin e përzgjedhjes së përfituesve sipas thirrjeve publike dhe mos-monitorimit të vazhdueshëm të përmbushjes së kriterit të granteve. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos zbatimit të aktiviteteve të duhura të kontrollit lidhur me dhënien dhe monitorimin nga ana e komisioneve për ndarjen e subvencioneve/granteve.

## Pasuritë

Mangësi në procesin e inventarizimit të pasurisë nga mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë me raportin e inventarizimit, në disa raste mos kryerja e procesit të inventarizimit.

Në raste të veçantë, është identifikuar që investimi kapital që ka përfunduar si projekt ende nuk është vendosur në funksion për qëllimin që është realizuar si projekt.

Në anën tjetër janë rastet të pasurive të cilat nuk janë zhvilluar procedurat për bartjen e pasurive tek përfituesit. Ndonëse ka një progres nga vitet paraprake, megjithatë, kjo çështje ende nuk ka arritur të adresohet në mënyrën e duhur.

Mos përdorimi i sistemit e-pasuria, me ç' rast disa organizata buxhetore vazhdonin që evidencat e pasurive jokapitale t'i mbajnë në regjistra të brendshëm. Kjo vjen si shkak i mos angazhimit të mjaftueshëm të organizatave buxhetore në funksionalizimin dhe përdorimin e sistemit e-pasuria.

Këto mangësi kryesisht ishin rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve në fushën e menaxhimit të pasurive.

## Të hyrat

Në auditimin e Fondeve në Mirëbesim, ka rezultuar që në tre (3) raste në vlerë 193,925€, AKP nuk kishte arritur të arkëtoj të hyrat nga shitja e asetëve me negociim direkt në afatet kohore të përcaktuara me rregullore. Kjo për shkak të mos respektimit të afateve nga palët dhe mos marrja e ndonjë veprimi nga AKP lidhur me zgjatjen e afatit apo pezullimin e procedurës.

Në ATK, bazuar në testimet dhe analiza e bazës së kthimeve/rimbursimeve, ka rezultuar që në 85 raste, nuk i kishte shqyrtuar kërkesat e tatim paguesve për kthim/rimbursim tatimor brenda afatit ligjor. Për këto vonesa, ATK nuk kishte aplikuar pagesën e interesit ndaj tatim paguesve.

Në RTK janë identifikuar dobësi tek të hyrat nga marketingu në lidhje me kontratën për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese me kompensim duke ndryshuar kushtet e kontratës bazë me aneks kontratë duke rrezikuar kështu që vlera e shërbimeve të ofruara të ri kalkulohet nën vlerën e hapësirave reklamuese me kompensim. Kjo kishte ndodhur pasi që ka pasur lëshime teknike procedurale me rastin e nënshkrimit të kontratës.

Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet se edhe këtë vit çështjet e njëjta janë përsëritur në raportet individuale të organizatave buxhetore të nivelit qendror. Këto mbesin sfida të vazhdueshme të organizatave që kërkojnë veprime nga ana e përgjegjësve në vendosjen e kontrolleve në menaxhimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritete sa i përket këtyre çështjeve.

## 1.4. Rekomandimet e dhëna

Në 48 raportet individuale të nivelit qendror, për vitin 2023 janë dhënë 179 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Në tabelën më poshtë janë paraqitur rekomandimet e dhëna për tri vitet e fundit.

Tabela 31 - Numri i rekomandimeve për nivelin qendror për tri vite

Subjektet e audituara	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Niveli Qendror	127	165	185
Institucionet e pavarura	52	54	55
Total	179	219	240

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë trendin e zvogëlimit të numrit të rekomandimeve ndër vite. Krahasuar me vitin paraprak ku numri i rekomandimeve ishte 219, në vitin 2023 kanë rezultuar 179 rekomandime (80 rekomandime të reja, 70 të përsëritura dhe 29 pjesërisht të përsëritura) që tregojnë një rënie të theksuar të numrit të rekomandimeve për organizatat e nivelit qendror. Rënia e nivelit të rekomandimeve është tregues i përmirësimit të procesit të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë nga ana e organizatave të nivelit qendror.

Institucionet të cilat kanë zvogëlim të rekomandimeve krahasuar me vitin e kaluar janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Fondet në Mirëbesim, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Radio Televizioni i Kosovës etj.

## 2. Niveli Lokal

### 2.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

Në vitin 2023, janë publikuar 38 raporte të auditimit financiare dhe të pajtueshmërisë për nivelin lokal. Auditimet janë kryer bazuar në metodologjinë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Prandaj, mbështetur në këtë bazë, ne kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat financiare, në përputhje me SNISA-t, dhe kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën OB. Opinionet e auditimit në lidhje me PFV-të e OB-ve, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 32 - Lloji dhe numri i opinionëve për nivelin lokal për vitin 2023

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Gjithsejt
Komunat	15	23	38

Siç shihet nga tabela e mësipërme në 15 raporte të auditimit është dhënë opinion i pamodifikuar ndërsa në 23 raporte opinion të modifikuar. Për komunat e audituara, shprehur në përqindje, 60%

e opinioneve të auditimit janë të modifikuara, që krahasuar me vitin 2022 (opinionet të modifikuara ishin 47%), atëherë mund të konkludojmë se kemi një trend negativ të opinionet e auditimit për 13%. Kjo do të thotë se, edhe më tutje një numër i konsiderueshëm i OB-ve kanë probleme me prezantimin, raportimin dhe shpalljen e informatave të kërkuara në PFV-të e tyre.

Arsyet kryesore për modifikimin e opinioneve të auditimit ishin kryesisht:

- Klasifikimi dhe raportimi jo i duhur i shpenzimeve (i realizuar nga OB), i ndikuar kryesisht nga pagesat përmes vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve kryesisht për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtat por edhe nga planifikimi jo i duhur i buxhetit lidhur për kategori të caktuara ekonomike që kanë të bëjnë me riparime, mirëmbajtje apo subvencionet;
- Regjistrimet e pasakta për pasuritë kapitale dhe jokapitale, që kishin ndikuar në nënvlerësimin/mbivlerësimin e tyre;
- Llogarit e arkëtueshme nuk ishin raportuar saktë; dhe
- Obligimet e papaguara dhe Detyrimet kontigjente nuk ishin prezantuar drejtë dhe saktë.

Në disa raste, modifikimi i opinionit ka rezultuar si pasojë e ndikimeve jashtë komunave për të cilat nuk kanë pasur mundësinë e korigjimeve të duhura. Këto raste janë reflektuar nga keqklasifikimet e evidentuara në disa komuna lidhur me pagesën e pagave jubilarë, bazuar në kontratën kolektive, kanë të bëjnë me pagesat që janë realizuar nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore, për të cilat komunat nuk kishin mundësitë buxhetore për pagesë për shkak të mos ndarjeve buxhetore për këtë qëllim. Ndërsa, çështjet tjera që kanë ndikuar opinionet janë si pasojë e kontrolleve jo të duhura në komuna lidhur me menaxhimin e projekteve apo tëj zyrtarëve që kanë përgjegjësitë në identifikimin apo regjistrimet e nevojshme për llogari të caktuara për raportim të cilat janë reflektuar në PFV.

## 2.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Për çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, ZKA-ja për vitin 2023, për nivelin lokal (Komunat) ka dhënë 38 konkluzione të pajtueshmërisë. Konkluzionet e pajtueshmërisë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 33 – Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin lokal për vitin 2023

Subjektet e audituara	Konkluzioni i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Konkluzion i kundërt	Gjithsejt
Komunat	3	33	2	38

Shprehur në përqindje, 87% e konkluzioneve të auditimit janë të kualifikuara, që nënkupton se pjesa më e madhe e organizatave buxhetore kanë probleme me pajtueshmërinë me autoritetet, apo transkasionet e tyre nuk janë në pajtim me kërkesat ligjore.

Ndërsa për komunën e Prishtinës dhe Vushtrrisë për herë të parë ZKA-ja ka dhënë konkluzion të kundërt, meqë këto dy komuna nuk kanë kryer aktivitetet e tyre në pajtueshmëri me ligjin. Mangësitë e identifikuar ishin materiale dhe të përhapura në secilën kategori ekonomike të shpenzimeve.

Arsyet kryesore për konkluzion të kualifikuar ishin:

- Mos verifikimi i 20% të pronave të tatueshme siç kërkohet me Ligj. Komuna kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi Protax për objekte dhe prona, mirëpo, komunat në vitin 2023 kishin arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) objekteve sipas % së kërkuar;
- Në disa raste komunat kanë përdor fondet nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër;
- Dobësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit, këtu përmendim specififikimet teknike jo të qarta në dosjet e tenderit, lidhja e kontratave pa u respektuar kriteret e vendosura në dosjen e tenderit si dhe mungesa e monitorimit të menaxhimit të kontratave përmes këtij sistemi;
- Dobësi në menaxhimin e kontratave, përfshirë: mos nënshkrimi i planeve të menaxhimit të kontratave, vonesat në dinamikën e projekteve, mos konfiskimi i sigurimit të tenderit, pagesat për punë të papërfunduara si dhe tejkallim në furnizim nga sasi të kontraktuara dhe përdorimi i kontratave jo adekuate që ka shkaktuar tejkallim të vlerës së tyre në raport me vlerën e parashikuar;
- Angazhimin e zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa udhëhequr procedurat e prokurimit;
- Kosto shtesë përmbarimore janë paguar për mos kryerjen e obligimeve me kohë nga ana e Komunave. Kjo situatë ka rezultuar nga paditë që kanë bërë OE ndaj Komunës për shkak të mos pagesave për punët apo shërbimet e kryera;
- Dhënia e subvencioneve jo në përputhje me thirrjen publike, pastaj subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike, mangësi në përzgjedhje, monitorim dhe raportim nga përfituesit e subvencioneve;
- Menaxhim jo i duhur i regjistrimit të pasurive duke nënvlerësuar apo mbivlerësuar regjistrat e pasurive;
- Mangësi në trajtimin e kërkesave për leje ndërtimore, leje mjedisore dhe legalizim;
- Vonesat në pagesën e faturave (detyrimeve); dhe
- Kontraktimi i projekteve të paparapara me buxhet, në mungesë të mjeteve financiare dhe zgjatja e afatit të realizimit të projekteve më të gjatë sesa ofertimi, si dhe zotimi i mjeteve financiare pas pranimit të faturave.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunave dhe papërgjegjësia në punë nga zyrtarët përkatës si dhe mos marrja e veprimeve konkrete nga ana e komunave për evitimin e çështjeve të identifikuara.

### 2.3. Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Përveç çështjeve që e kanë ndikuar opinionin financiar dhe konkluzionin e pajtueshmërisë, ZKA për vitin 2023 në raportet individuale për 38 Komuna ka ngritur edhe çështjet rreth menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë.

Çështjet që janë identifikuar kanë të bëjnë me kategori të ndryshme ekonomike të cilat kryesisht janë identifikuar në raportet individuale të Komunave. Përveç çështjeve të specifikuar më poshtë, me rëndësi është të përmendim edhe trendin e rritjes së llogarive të arkëtushme prej vitit në vit, mos



përdorimi i sistemit e-pasuria dhe mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurive para përgatitjes së PFV-ve.

## Paga dhe shtesat

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e pagave dhe shtesave janë:

- Mangësitë rreth menaxhimit për punën shtesë jashtë orarit të rregullt të punës pa marrë autorizim përkatës;
- Mangësitë në proceset e rekrutimit; dhe
- Zyrtarë jashtë listës së pagave, për pozita të rregullta të arsimit, si dhe për zëvendësimin e punonjësve të arsimit.

## Mallra dhe shërbime

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve janë:

- Inicimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve, në disa raste komunat kishin hyrë në obligime kontraktuale pa mjete të mjaftueshme të zotuara;
- Mos respektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare, ku fillimisht është sjellë situacioni për punët/mallin dhe shërbimet e pranuar dhe fatura, e pastaj është lëshuar urdhërblerja;
- Tejkallim i sasive të kontraktuara mbi 30%, e lejuar për kontratat publike kornizë. Tejkallimi i sasive të kontraktuara ishte bërë me aprovimin e Kryetarit të Komunës me arsyetimin e mundësimin të kompletimit të projekteve sipas specifikave dhe nevojave të hasura në teren gjatë realizimit të tyre;
- Mungesa e dokumenteve që ndërlidhen me kërkesat e përshtatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik.

## Investime Kapitale

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e investimeve kapitale janë:

- Në disa raste janë identifikuar se në dosjen e tenderit komunat kane vendosur specifikime jo të qarta/matshme duke mos përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara;
- Kishte raste kur ishin bërë pagesa për punë të papërfunduara sipas kontratës dhe dëmtimi i punimeve ende pa u përfunduar kontrata;

- Ndryshime mbi 10% të vlerës së kontratave pa aplikuar procedurat e prokurimit. Këto ndryshime kanë të bëjnë me sasi të realizuara në pozicione të caktuara të cilat kryesisht ishin aprovuar nga zyra e prokurimit dhe Kryetari pa aplikimin e procedurave të prokurimit;
- Komunitat kishin filluar procedura të prokurimit dhe kishin lidhur kontrata për punë, pa hartuar paraprakisht projektet ekzekutive të ndërtimit;
- Në disa raste menaxhimi i kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve, nuk është bërë përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi);
- Kishte raste të vonësive në kryerjen e punimeve ku punët nuk ishin kryer sipas planit dinamik të paraparë me kontratë;
- Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm, ka raste ku OE-të fitues, nuk i kanë plotësuar kriteret e vendosura me dosjen e tenderit gjatë procesit të tenderimit.

Për më tepër, në tetë komuna për 35 projekte në vlerë të përbashkët 4,732,277€, kanë përdorur fondet nga projektet për qëllime të tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër, duke mos marrë aprovimin nga kuvendi komunal (Prishtina 2,209,581€, Peja 1,374,052€, Ferizaj 547,842€, Podujeva 200,000€, Fushë Kosova 183,105€, Gjilani 107,689€, Malisheva 59,999€, si dhe Vitia 50,000€).

Rastet e tilla të ndryshimeve në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimet e marra rreth shfrytëzimit të fondeve publike. Këto po ashtu mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese duke pamundësuar financimin e mjaftueshëm për to.

Kishte raste ku komunitat kishin hyrë në obligime kontraktuale duke nënshkruar kontrata për punë për projekte të ndryshme pa pasur zotim të mjaftueshëm të mjeteve:

- Komuna e Prizrenit, në 13 raste ka hyrë në obligime kontraktuale për projekte të ndryshme pa pasur fonde të mjaftueshme, siç është projekti “Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt” me vlerë 3,470,000€, ndërsa zotimi ishte vetëm 50,000€, dhe projekti “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësive në fshatin Zhur” me vlerë të kontratës 2,497,919€, ndërsa zotimi i mjeteve ishte vetëm 50,000€;
- Komuna e Ferizajit, në shtatë (7) raste ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si te projekti “Rikonstruimi i rrugëve në fshatrat Tërn-Lubovc, Nerodime, Rakaj” me vlerë të kontratës 1,000,000€, ndërsa zotimi ishte 550,000€. Po ashtu, te projekti “Ndërtimi i infrastrukturës së zonave turistike në fshatin Jezerc” me vlerë të kontratës 791,927€, për të cilin komuna nuk kishte ndarë mjete buxhetore;
- Komuna e Malishevës, në pesë (5) raste ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si te projekti “Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimin dhe parkingun nëntokësor në qytet” me vlerë 8,277,887€, ndërsa fondet e buxhetuara ishin vetëm 1,950,000€. Një tjetër rast është projekti “Ndërtimi i rrugëve, kanalizimit fekal, atmosferik dhe ndriçimi i qytetit” me vlerë të kontratës 1,099,942€, ndërsa buxheti i ndarë ishte 590,000€;
- Komuna e Pejës, në shtatë (7) raste ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si te projektet “Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Lugut të Baranit” me vlerë të kontratës 1,377,859€, ndërsa zotimi ishte vetëm 200,000€, dhe “Ndërtimi dhe asfaltimi

i rrugës Varri i Sykut-Bellopaq” me vlerë të kontratës 918,214€, ndërsa zotimi ishte vetëm 50,000€; dhe

- Komuna e Podujevës, në katër (4) raste ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme, si rasti me “Furnizimin me material për mirëmbajtjen e objekteve” me vlerë të kontratës 119,131€, ndërsa zotimi ishte vetëm 20,000€, dhe “Hartimi i projekteve” me vlerë të kontratës 140,000€, ndërsa zotimi ishte vetëm 3,000€.

## Subvencionet dhe transfereve

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuar dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve janë:

- Kishte raste që ofruesit e mbështetjes financiare nuk kanë caktuar zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Po ashtu, ka raste që OJQ-të nuk kanë dorëzuar raporte financiare dhe narrative;
- Komunat nuk e kishin përgatitur planin vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve për vitin 2023 ashtu siç parashihet me kërkesa ligjore;
- Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike, disa OJQ fituese të subvencioneve, janë përzgjedhur në bazë të vendimeve të Kuvendit Komunal, pa shpallje paraprake të thirrjes publike; dhe
- Subvencionimi jo në pajtim me Rregulloren komunale dhe pa thirrje publike.

## Të hyrat

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuar dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e të hyrave janë:

- Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduar. Komuna kishte bërë verifikimin e pronave komunale në “Zonën Industriale”, ku në këtë zonë shfrytëzohen 15 parcela të Komunës me rreth 9 ha, nga 37 shfrytëzues pa asnjë kompensim ndaj Komunës, duke shkaktuar humbje financiare për buxhetin e Komunës;
- Mos përditësimi i informacionit të tatimpaguesve në sistem ProTax;
- Komuna nuk kishte respektuar afatet ligjore për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Po ashtu, Komuna kishte lëshuar leje të ndërtimit pa u përfunduar fillimisht procedurat e ndërtimit të destinimit të tokës, dhe pa u kryer pagesa e taksës që sipas tarifës është dashur të paguhet; dhe
- Aplikimi i zbritjes për tarifën e shfrytëzimit të pronës komunale afariste në mungesë të dëshmive të kërkuara sipas rregullores përkatëse.

## 2.4. Rekomandimet e dhëna

Në raportet individuale të Komunave, për vitin 2023 janë dhënë 369 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime.

Tabela 34 - Numri i rekomandimeve për nivelin lokal për tri vite

Subjektet e audituara	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021
Komunat	369	352	438

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se këtë vit, numri i rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak është për 17 më shumë. Marrë në konsideratë se këtë vit janë audituar katër komunat veriore të cilat nuk janë audituar vitin e kaluar, dhe për të cilat janë dhënë 21 rekomandime, gjendja është po thuajse e njëjtë sikur vitin e kaluar rreth përmirësimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

## 3. Ndërmarrjet Publike

Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar pasqyrat financiare vjetore për vitin 2023 të 12 ndërmarrjeve publike (NP). Prej tyre, tetë (8) ishin ndërmarrje publike qendrore, dhe katër (4) ndërmarrje publike lokale.

Në vitin 2023, janë audituar për herë të parë nga ZKA Pasqyrat Financiare Vjetore të ndërmarrjeve publike si Trepça sh.a, Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit Hidrodri sh.a dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.). Ndërsa nëntë (9) ndërmarrjet e tjera janë audituar edhe gjatë viteve paraprake. Kriteret për përzgjedhjen e këtyre ndërmarrjeve kanë qenë madhësia e buxhetit apo të hyrave, numri i punëtorëve, kompleksiteti i shërbimeve, gjendja financiare dhe interesi publik. Për dallim nga viti i kaluar, në planin e auditimit për 2023 nuk janë përfshirë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh.a dhe Posta e Kosovës sh.a.

Edhe pse ka përmirësime në disa ndërmarrje publike, menaxhimi financiar dhe kontrolli në ndërmarrjet publike duhet të përmirësohet edhe më tej. Auditimi tregoi se nëntë (9) ndërmarrje kishin opinione të modifikuara dhe 10 kishin konkluzione të modifikuara për pajtueshmërinë e pasqyrave financiare vjetore. Opinione dhe konkluzione të modifikuara, reflektojnë cilësinë e dobët të informatave, mospërputhjen me ligjet dhe mangësitë në fushën e raportimit. Kjo tregon nevojën për përmirësime të vazhdueshme në secilën fushë ku janë identifikuar ato në pasqyrat financiare vjetore.

Për të ndihmuar në përmirësimin e pasqyrave financiare dhe menaxhimit të NP-të, ZKA ka dhënë një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve, të cilat janë prezantuar në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat e ngarkuar me qeverisje të NP-ve, si dhe tek aksionarët e tyre. Gjithashtu, Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike monitoron aktivitetet operative dhe raportimin financiar të këtyre ndërmarrjeve dhe informon rregullisht Qeverinë për situatën e tyre.

Një analizë më e detajuar mbi performancën e këtyre ndërmarrjeve dhe cilësinë e raportimit financiar gjendet në kapitujt e mëposhtëm të raportit.

### 3.1. Opinionet e auditimit dhe çështjet në modifikimin e tyre

Opinionet e auditimit në lidhje me Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të NP-ve, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 35 - Opinionet e dhëna për pasqyra financiare për Ndërmarrjet Publike

Nr	Subjektet e audituara	NP e Nivelit	Opinionet e auditimit		
			2023	2022	2021
1	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	Qendror	I kualifikuar	I kualifikuar	I Pamodifikuar
2	Trepça sh.a	Qendror	I Kundërt	Mohim	I Kualifikuar
3	Kostt sh.a	Qendror	I Kualifikuar	I Pamodifikuar	I Pamodifikuar
4	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	Qendror	I kualifikuar	I kualifikuar	I Kundërt
5	Hekurudhat e Kosovës - Infrakos", sh.a	Qendror	I kualifikuar	I Kundërt	I Kundërt
6	Telekomi i Kosovës, sh.a	Qendror	I Pamodifikuar	I Kualifikuar	I Kundërt
7	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	Qendror	I Kualifikuar	I Kualifikuar	I Kundërt
8	KRU. "Hidrodrini" SH.A.	Qendror	I Kundërt	I Kualifikuar	I Kualifikuar
9	KRM "Pastrimi", sh.a - Prishtinë	Lokale	I Pamodifikuar	I Kualifikuar	I Kundërt
10	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	Lokale	I Kundërt	I Kundërt	I Kundërt
11	Ndërmarrja Publike Banesore sh.a-	Lokale	I Pamodifikuar	I Kualifikuar	I Kualifikuar
12	Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a	Lokale	I Kundërt	I Kundërt	I Kundërt

Prej 12 NP-të të audituara në vitin 2023, PFV individuale të tyre kanë rezultuar: tri (3) me opinione të pamodifikuara dhe nëntë (9) opinione të modifikuara (5 opinione të kualifikuara dhe 4 opinione të kundërta).

Krahasuar me vitin 2022, ku opinionet e këtyre NP-ve ishin, shtatë (7) opinione të kualifikuara, tri (3) opinione të kundërt, një (1) mohim të opinionit dhe një (1) opinion i pamodifikuar, vërejmë që PFV e vitit 2023 janë të një cilësie më të mirë, për më tepër këtë vit janë tri (3) opinione të pamodifikuara krahasuar me vitin e kaluar që ishte vetëm një (1).

Përkundër përmirësimeve, NP-të kanë pasur gabime në raportimin dhe shpalesjen e informatave të kërkuara në PFV.

## Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikim të opinionit të NP-të qendrore janë:

### Pasqyrat Financiare Vjetore

Prezantimi jo i plotë i informacioneve shpjeguese për shkak të mungesës së kontrolleve gjatë procesit të përgatitjes së PFV-ve.

### Pasuritë

Mos rivlerësimi i pasurive, dobësitë në regjistrim dhe trajtimin e tyre si dhe mos përditësim të regjistrave të pasurive. Këto kishin ndodhur për shkak të dështimit të procedurave tenderuese dhe mos veprimeve të menaxhmentit të NP-ve, duke i konsideruar në raste të caktuara si vështirë të zbatueshme apo si shkak i mungesës së mjeteve financiare. Po ashtu, dobësitë në regjistrim dhe mos përditësim të pasurive ishin për shkak të mungesës së kontrolleve, mungesës së dokumenteve burimore, qarkullimit të informacioneve në mes të departamenteve brenda NP-ve si dhe mungesës së veprimeve të mjaftueshme ndër vite për trajtimin e çështjeve pronësore të ndërmarrjeve.

### Llogaritë e arkëtueshme

Mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme tregtare dhe mos harmonizimi në mes të shënimeve kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe letër konfirmimeve. Këto kishin ndodhur për shkak të mos marrjes së veprimeve sipas kërkesave të standardeve, mos dhënies së rëndësisë në raportim të drejtë të llogarive të arkëtueshme, dhe mos kryerjes së procesit të inventarizimit dhe verifikimit të ekzistencës së tyre dhe harmonizimit me shënimet kontabël në baza periodike.

### Obligimet pagueshme tatimore dhe të papaguara:

Mos përputhja e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël me gjendjen e obligimeve në ATK dhe mos prezantim i saktë i obligimeve. Arsyet për këto probleme janë mos harmonizimi ndër vite i obligimeve tatimore të kompanisë me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve në ATK si dhe mos harmonizimi i gjendjeve të obligimeve me klientë në baza periodike.

## Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikim të opinionit të NP-të lokale janë:

### Pasuritë

Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes, mungesa e dëshmive mbështetëse për pasuritë afatgjata, prezantimi jo i saktë i Rezervës së rivlerësimit, dhe njohja e investimeve në vijim si pasuri në përdorim. Dobësitë në menaxhimin e pasurive kanë ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve, mos aplikimit të drejtë të standardeve të kontabilitetit, dhe për shkak të vështirësive të implementimit të tyre në programin e kontabilitetit.

### Llogaritë e arkëtueshme

Mos provizionim i llogarive të arkëtueshme tregtare dhe mos harmonizimi në mes të shënimeve kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe letër konfirmimeve. Këto çështje kanë ndodhur për shkak të mos marrjes së veprimeve sipas kërkesave të standardeve dhe si rezultat i mos vërtetimit të ekzistencës dhe vlerësimit në baza të rregullta të llogarive të arkëtueshme.

### 3.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Përveç aspektit financiar, ne kemi audituar edhe aspektin e pajtueshmërisë nëse proceset dhe transaksionet janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit dhe kemi dhënë edhe konkluzione të pajtueshmërisë për të gjitha NP-të e audituara.

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me NP-të, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 36 - Konkluzionet e dhëna të pajtueshmërisë për Ndërmarrjet Publike

Nr	Subjektet e audituara	NP e Nivelit	Konkluzioni i pajtueshmërisë		
			2023	2022	2021
1	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Nuk aplikohet
2	Trepça sh.a	Qendror	Kundërt	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
3	Kostt sh.a	Qendror	Kualifikuar	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
4	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	Qendror	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
5	Hekurudhat e Kosovës - Infrakos sh.a	Qendror	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
6	Telekomi i Kosovës, sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Kundërt
7	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Kundërt
8	KRU "Hidrodrini" sh.a - Pejë	Qendror	Kualifikuar	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
9	KRM "Pastrimi", sh.a - Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Kundërt
10	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
11	Ndërmarrja Publike Banësore sh.a - Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
12	Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a - Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Kundërt

Nga 12 NP-të e audituara dy (2) konkluzione janë të pamodifikuara (Hekurudhat e Kosovës - Infrakos sh.a dhe NPH "Ibër - Lepenc" sh.a) ndërsa 10 konkluzione të modifikuara. Sipas tabelës vërehet se rreth 83% të NP-ve kanë konkluzion të modifikuar që tregon se kanë mangësi në pajtueshmërinë me autoritetet, apo transaksionet financiare nuk janë në pajtim me kërkesat ligjore.

Është e rëndësishme të theksohet se, nga krahasimi i të dhënave në tabelën më sipër, shihet se Hekurudhat e Kosovës - Infrakos sh.a ka bërë një progres pozitiv në përmirësimin e parregullsive ligjore, duke marrë konkluzion të pamodifikuar. Po ashtu, duhet theksuar se Trepça sh.a, Kostt sh.a si dhe KRU «Hidrodrini» sh.a janë audituar për herë të parë nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe se për vitet paraprake nuk është aplikuar dhënia e konkluzioneve nga kompanitë private të auditimit.



Konkluzioni i auditimit është se shumica e ndërmarrjeve publike përkundër progresit gjatë vitit 2023 edhe më tutje janë përcjellë me parregullsi ligjore kryesisht të shpenzimet e pagave, shpenzimet operative, menaxhimi i të hyrave dhe pasqyrat vjetore financiare.

## Çështjet kryesore që kanë ndikuar modifikimin e konkluzionit të pajtueshmërisë të NP qendrore janë:

### Shpenzimet e pagave

Mangësitë në procese të rekrutimit, mangësi në kompensimin e pagave, si dhe mos pagesa e kontributeve pensionale dhe obligimeve tatimore. Këto kishin ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme, mos aplikimit në UA Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe për shkak të gjendjes së vështirë financiare të ndërmarrjes.

### Shpenzimet operative

Mangësitë në procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, dobësi në vlerësimin e tenderëve dhe nënshkrimi i kontratës për auditimin e pasqyrave financiare vjetore. Këto dobësi kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti i NP-ve nuk kishte trajtuar mirë kërkesat ligjore.

### Të hyrat

Mungesa e rregulloreve të brendshme, mungesa e kontratave me konsumatorë, mungesa e instalimit të ujëmatësve si dhe regjistri i konsumatorëve jo në përputhje me rregullat e ARRU-së etj. Këto kishin ndodhur për shkak të veprime jo të mjaftueshme të menaxhmentit të NP-ve, për të hartuar rregulloret e brendshme, në identifikimin e konsumatorëve dhe instalimin e ujëmatësve për të gjithë konsumatorët.

### Pasqyrave Financiare Vjetore

Vonesa në aprovimin e pasqyrave financiare, mos funksionim të njësive të Trepça Sh. A. jo sipas kërkesave ligjore, mangësi në menaxhimin e pasurive dhe mangësi në raportimin e shënimeve shpjeguese. Këto kishin ndodhur për shkak të ndryshimeve në menaxhment gjatë kohës së përpilimit të PFV-ve dhe situatës së krijuar ndër vite të angazhimit të pamjaftueshëm të menaxhmentit dhe bordeve mbikëqyrëse.

## Çështjet që kanë ndikuar në modifikimin e konkluzionit të pajtueshmërisë të NP-të lokale janë:

### Shpenzimet operative

Shkurtimi i afateve kohore pa ndonjë arsytim të qëndrueshëm dhe shpërblimi me kontratë i operatorit ekonomik i cili nuk i ka plotësuar specifikimet teknike. Këto mangësi kanë ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk ka vlerësuar drejt kriteret e kërkuara në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), mungesës së vëmendjes së duhur nga komisioni i vlerësimit të tenderit dhe monitorimit të pa mjaftueshëm të zyrës së prokurimit.

### Shpenzimet e pagave

Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre, tejkalim i afateve ligjore të kontratave për kryerjen e shërbimeve, dhe mangësi në angazhimin e konsulentëve për punë dhe detyra specifike. Arsyet e këtyre çështjeve ishin veprimet e pamjaftueshme nga ndërmarrja për të mbuluar të gjitha vendet e punës me pozitave të rregullta si dhe për shkak se kontrolli i brendshëm në ndërmarrje nuk ishte efektive në procesin e kontraktimit të të angazhuarve.

### 3.3. Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar

Për vitin 2023, kemi evidentuar vetëm 1 (një) nga 12 ndërmarrjet publike të audituara, që nuk i kanë përgatitur me kohë Pasqyrat Vjetore Financiare, respektivisht nuk i kanë pasur pasqyrat e aprovuara nga Bordet e tyre drejtuese brenda afatit ligjor 15 mars. Ndërmarrja Trepça sh.a. kishte përpiluar pasqyrat financiare vjetore 2023 me vonesë prej 46 ditë, përtej afateve ligjore. Si rrjedhojë e kësaj, ndërmarrja kishte finalizuar pasqyrat financiare për vitin 2023 me datën 30 prill 2024.

Kjo kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk kishte arritur të finalizonte me kohë dhe ta dërgonte për aprovim tek bordi drejtorëve, si dhe për shkak të ndryshimeve në menaxhment gjatë kohës së përpilimit të PFV-ve.

Këtë çështje e kemi raportuar në raportin individual dhe pritjet janë se, viteve në vijim raportimi do të bëhet sipas kuadrit të përcaktuar ligjor.

### Analiza e Gjendjes Financiare e Ndërmarrjeve Publike

Ndonëse gjendja financiare e ndërmarrjeve publike më hollësisht mund të kuptohet nga pasqyrat e bashkëngjitura në raportet individuale, në këtë kapitull në mënyrë përmbledhëse janë paraqitur treguesit kryesor të performancës financiare dhe gjendjes së tyre të fund vitit 2023. Për qëllime

analize, janë marrë në shqyrtim të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatshkurtëra dhe detyrimet afatgjata.

Tabela 37 - Treguesit kryesor financiar të ndërmarrjeve publike të audituara për vitin 2023

Nr.	Subjektet e audituara	Të hyrat	Shpenzimet	Fitimi/ Humbja	Detyrimet afatshkurtra	Detyrimet afatgjata
1	KEK "Korporata Energjetike e Kosovës" sh. a.	195,613,000	182,423,000	13,190,000	49,564,000	175,443,000
2	Trepça sh. a.	28,046,837	33,417,551	(5,370,713)	34,874,114	3,648,671
3	Telekomi i Kosovës, sh. a.	56,814,000	49,785,000	7,029,000	44,099,000	31,238,000
4	Ndërmarrja Publike "KOSTT"	67,299,000	84,404,000	(17,105,000)	72,463,000	64,539,000
5	Hekurudhat e Kosovës - Infrakos sh. a.	3,171,149	3,855,948	(684,800)	41,398,619	50,555,832
6	KRU "Hidrodrini"	5,290,138	5,247,379	42,759	2,020,261	31,757,032
7	NPH "Ibër - Lepenc" sh. a. - Prishtinë	10,313,254	9,682,157	631,097	2,836,043	7,124,169
8	KRU "Prishtina" sh. a. - Prishtinë	17,272,339	15,282,670	1,989,668	5,914,027	32,848,782
9	KRM "Uniteti" sh. a. - Mitrovicë	3,525,202	2,748,782	776,420	2,247,637	1,155,886
10	KRM "Pastrimi", sh. a. - Prishtinë	9,518,620	9,517,425	1,195	3,072,146	0.00
11	Ndërmarrja Publike Banesore, sh. a. - Prishtinë	4,458,389	5,987,925	(1,529,537)	298,912	831,618
12	NP "Termokos", sh. a. - Prishtinë	12,225,120	9,880,031	2,345,090	40,152,839	36,755,578

Rezultati financiar (fitimi/humbja) - Nga tabela më sipër shihet se nga 12 ndërmarrje publike të audituara, tetë (8) NP kanë operuar me një total të fitimeve prej 26 mil.€, prej tyre, pesë (5) NP të nivelit qendror dhe tre (3) te niveli lokal, ndërsa katër (4) tjerat kanë treguar një total të humbjeve prej 24.7 mil.€, prej tyre tre (3) te niveli qendror dhe një (1) te niveli lokal.

Pjesën më të madhe të fitimit e kishte NP te niveli qendror Korporata Energjetike e Kosovës në shumën prej 13.1 mil.€ apo 50% të totalit të fitimeve, kurse humbjen më të madh e kishte realizuar KOST në shumën prej 17.1 mil.€ apo rreth 65% nga totali i humbjeve. Vlen të theksohet se në raport me vitin paraprak KEK kishte fitim dukshëm më të ulët për shkak se të hyrat nga eksporti gjatë vitit 2023 kishin shënuar rënie të theksuar.

Detyrimet afatshkurtër - janë obligime financiare që duhet të paguhen brenda një viti dhe klasifikohen si detyrime qarkulluese. Detyrimet afatshkurtër janë: llogaritë e pagueshme, tatimet e pagueshme, kreditë afatshkurtër, dhe detyrimet tjera me afat pagese brenda një viti.

Për 12 ndërmarrjet e audituara, detyrimet afatshkurtër kapin shumën prej 298.8 mil.€, shumicën e këtyre detyrimeve (rreth 81%) e përbëjnë ndërmarrjet publike te niveli qendror: KOST me 72.4 mil.€ apo 24 %; Korporata Energjetike e Kosovës me 49.5 mil.€ apo 16.5%; Telekom i Kosovës me 44 mil.€ apo 14.7%; Infracos me 41 mil.€ ose 13.8%; dhe Trepça me 34.8 mil.€ apo 11.6%. Ndërsa pjesën e mbetur prej 56.5 mil.€ apo 19% e përbëjnë detyrimet afatshkurtra të 7 subjekteve tjera.

Detyrimet afatgjata - janë obligime financiare ose detyrime jo qarkulluese të cilat listohen në bilancin e gjendjes si obligime që afatin e pagesës e kanë më të gjatë se një vit. Këtu bëjnë pjesë kreditë për mjete themelore, detyrimet ndaj letrave me vlerë, detyrimet ndaj pengjeve apo hipotekave dhe detyrimet tjera që duhet të paguhen në afat më të gjatë se një vit.

Detyrimet afatgjata për 12 subjektet e audituara në fund vitin 2023 ishin afër 435.8 mil.€, apo rreth 45% më të larta se detyrimet afatshkurtra. Meqenëse pasqyra e shpalosjeve përmban shumë mangësi të informatave, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë të dhëna analitike se brenda sa vitesh duhet të kthehen këto detyrime.

Në bazë të rezultateve nga auditimet individuale dhe nga sa u tha më lart, del se problemet te ndërmarrjet publike janë evidente dhe gjendja e tyre financiare është e vështirë. Çështjet kryesore për vëmendje dhe që kërkojnë trajtim janë:

- **Rezultatet e pavoritshme financiare** - katër (4) ndërmarrje publike kanë pasur rezultat negativ financiar, respektivisht humbje në shumën prej 24.7 mil.€, kurse tetë (8) kanë arritur rezultat pozitiv financiar me një fitim prej 26 mil.€.
- **Shumat e larta të detyrimeve të pa paguara** - Gjithsej detyrimet të pa paguara të këtyre ndërmarrjeve kapin shumën prej mbi 734 mil.€, prej të cilave detyrime afatshkurtra që duhet të paguhen brenda një viti janë rreth 299 mil.€.

Marrë parasysh faktin se të hyrat totale ishin rreth 413 mil.€, pagesa eventuale e këtyre detyrimeve afatshkurtra duket mjaft e vështirë. Kur kësaj i shtohen edhe kështet e kredive afatgjata dhe detyrimet tjera që krijohen gjatë vitit 2024, gjendja mund të bëhet edhe më e komplikuar.

### 3.4. Çështjet tjera të Menaxhimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë

Bazuar në raportet e auditimit gjatë këtij sezoni janë identifikuar disa dobësi në fushën e menaxhimit financiar të ndërmarrjet publike. Këto dobësi i shpalosim në vijim:

#### Çështjet tjera që kanë ndikuar në menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë te ndërmarrjet publike niveli qendror janë:

- Në fushën e pasurive janë çështjet si: mungesa e rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurive te KOSTT. Shkaku i kësaj mangësie ishte se menaxhmenti e konsideron si të mjaftueshme hartimin e manualit financiar ku përshkruhen normat e zhvlerësimit.
- Në fushën e llogarive të arkëtueshme janë çështjet si: mos harmonizimi i regjistrit të llogarive të arkëtueshme të provizionuara sipas kërkesave ligjore, nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme, mungesa e emërimit të konsumatorëve, akumulimi i llogarive të arkëtueshme, prezantimi i llogarive të arkëtueshme të paidentifikuara, prezantimi i llogarive të arkëtueshme të paidentifikuara. Këto mangësi kanë ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk kishte kryer procesin e harmonizimit të gjendjeve të klientëve dhe mungesës se trajtimit të këtyre çështjeve ndër vite.
- Në fushën shpenzimet e pagave janë çështjet si: mos pagesa e punonjësve me gradë të njëjtë për pozitën e njëjtë, mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre. Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të procesi i ristrukturimit për të gjitha pozitat ende i pa përfunduar.
- Në fushën shpenzimet e prokurimit janë çështjet si: mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve, planifikimi dhe realizimi jo i duhur i planit të prokurimit, dhe aplikimi i kriterëve të përzgjedhjes jo në harmoni me LPP.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të mbikëqyrjes së pa mjaftueshme të menaxherëve të kontratave nga menaxhmenti i ndërmarrjes, dhe sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, kjo ka ndodhur për shkak të vendosjes se kriterëve minimale në mënyrë që të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë.

#### Çështjet që kanë ndikuar në menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë te ndërmarrjet publike niveli lokal janë:

- Në fushën shpenzimet e pagave janë çështjet si: mangësi në proceset e rekrutimit për staf të rregullt, ndryshimet në paga jo në përputhje me vendimin dhe akontacionet e dhëna punëtorëve pa ndonjë bazë të qartë ligjore. Këto mangësi kanë ndodhur për shkak te, kontrollit jo të mirë gjatë procesit të rekrutimit, mos azhrunimit të kontratave dhe kompania e kishte konsideruar të arsyeshme që punëtorëve në raste të caktuara t'u japë mjete financiare në formë avanci me qëllim të kthimit apo zbatimit në pagat e ardhshme të punonjësve.
- Në fushën shpenzimet e prokurimit janë çështjet si: mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve, ndarja e tenderëve dhe mos planifikimi i procedurës së hapur, dhe prokurimi i mallrave të përdorura. Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të mbikëqyrjes së pa mjaftueshme të menaxherëve të kontratave nga

menaxhmenti i ndërmarrjes dhe për pasojë menaxhimi i kontratave nuk ishte bërë përmes platformës së e-prokurimit.

### 3.5. Rekomandimet e vitit 2023 dhe niveli i zbatimit për vitin 2022

Në raportet individuale të 12 NP-ve për vitin 2023, kemi dhënë 133 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime.

Tabela 38 - Numri i rekomandimeve të dhëna të NP-ve në 2023

Ndërmarrjet publike të audituara	Rekomandime të reja	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura	Total rekomandime
Niveli Qendror	66	20	3	89
Niveli Lokal	9	28	7	44
Total	75	48	10	133

Kjo tregon që 56% e rekomandimeve janë të reja, 36 % të përsëritura nga viti i kaluar dhe 8% pjesërisht të përsëritura.

Në tabelën e mëposhtme i kemi paraqitur rekomandimet e dhëna në vitin 2022 dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Tabela 39 - Numri i rekomandimeve të dhëna të NP-ve në 2022

Ndërmarrjet publike të audituara	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura	Rekomandime të mbyllura	Viti 2022
Niveli Qendror	48	20	3	15	86
Niveli Lokal	31	28	2	-	66
Total	79	48	10	15	152 <sup>20</sup>

Të dhënat e paraqitura në tabelë, tregojnë që ndërmarrjet publike po e kuptojnë rëndësinë e auditimit dhe po përmirësojnë shkallën e zbatimit të rekomandimeve. Nga 152 rekomandime sa janë dhënë vitin e kaluar, 58% janë zbatuar (përfshirë rekomandimet e mbyllura), 32% janë të përsëritura dhe 6% janë pjesërisht të përsëritura.

<sup>20</sup> Numri i rekomandimeve dallon nga raporti i vitit paraprak, për faktin që këtë vit nuk është Posta e Kosovës (2 rekomandime), Hekurudhat e Kosovës – Trainkos (9 rekomandime) ndërsa janë mbledhur rekomandimet shtesë të cilat janë dhënë nga kompanitë private të auditimit për KEK (17 rekomandime), Kostt (10 rekomandime) si dhe KRU Hidrodriini (2 rekomandime). Gjithsej janë raportuar 134 rekomandime vitin e kaluar.

### **Rekomandimi për Qeverinë dhe Komisionet përkatëse të Aksionareve:**

Përmes RVA-së rekomandojmë Qeverinë dhe Komisionet përkatëse të Aksionareve që ti forcojnë masat llogaridhënëse ndaj Bordeve Drejtuese dhe menaxhmentit që të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet dhe të ndërmerren veprime për t'i adresuar ato në mënyrë sistematike dhe pragmatike me qëllim të eliminimit të gabimeve që kanë ndikuar në opinionet dhe konkluzionet e modifikuar; dhe

Po ashtu duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2024 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Të gjitha çështjet dhe rekomandimet që duhet të adresohen në mënyrë specifike janë të prezantuara në raportet individuale.

## **4. Sistemi i auditimit të brendshëm**

Auditimi i Brendshëm (AB) është një funksion thelbësor që siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Ai ndihmon organizatën në përmbushjen e objektivave të saj duke ofruar një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Përderisa, Komiteti i Auditimit (KA) vepron si një organ këshillëdhënës i menaxhmentit të lartë të Subjekteve të Sektorit Publik (SSP), duke mbështetur auditorët e brendshëm, siguruar pavarësinë e tyre, vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve dhe duke siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në kuadër të objektivave të Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, është planifikuar avancimi i AB-së përmes zbatimit të programit për zhvillimin profesional, sigurimin e cilësisë për pajtueshmëri dhe azhurnimin e kornizës ligjore.

Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NjQHAB), koordinon të gjithë procesin për auditimin e brendshëm dhe monitoron subjektet e sektorit publik për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, përcakton kriteret që duhet të plotësojnë Organizatat Buxhetore (OB), për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB), si dhe numrin minimal të auditorëve që duhet të kenë OB-të, bazuar në buxhetin e tyre. Nga gjithsej 86 organizata buxhetore, 64 prej tyre plotësojnë kriteret për themelimin e NjAB-së. Megjithatë, katër prej tyre (Komuna e Leposaviqit, e Zveçanit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës Veriore) nuk e kanë themeluar NjAB-në, edhe pse plotësojnë kriteret. Ndërsa, nga 60 institucionet në të cilat është themeluar NjAB, në 31 prej tyre numri i auditorëve ishte më i ulët sesa që parashihet në kërkesat e rregullores.

Bazuar në auditimet tona, menaxhmenti i OB-ve nuk ka marrë veprime të mjaftueshme për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm duke i zbatuar vetëm 40% të rekomandimeve të dhëna. Në nivel lokal, 44% e rekomandimeve janë zbatuar, rekomandimet tjera janë në proces ose të pazbatuara,

përderisa në nivel qendror zbatimi i rekomandimeve ishte edhe më i ulët me vetëm 39%. Ndërsa niveli i auditimeve të realizuara në raport me ato të planifikuara ishte 98%.

Nga 60 OB, të cilat kanë të themeluar NjAB-në, katër prej tyre nuk kanë themeluar KA sikurse: MINT, MMPHI, komuna e Graçanicës dhe ajo e Novobërdës. Në gjashtë OB sikurse në: KPMM, Komuna e Obiliqit, Rahovecit, Deçanit, Kamenicës dhe Shtërpçës, KA megjithëse i themeluar, nuk ka funksionuar gjatë vitit.

Në shtatë (7) OB<sup>21</sup>, KA ka mbajtur më pak se katër takime siç kërkohet në UA 01/2019, ndërsa në pesë (5) OB<sup>22</sup>, KA nuk kanë dorëzuar raportin vjetor sipas nenit 10 të UA 01/2019.

Auditimet kanë nxjerrë në pah se mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme është një problem i përhapur në disa OB. Kjo vjen si rezultat që shpeshherë, mungon dokumentimi i duhur për procedurat e kontrollit, gjë që ndikon në moszbatimin e vazhdueshëm dhe efektiv të kontrolleve. Mungesa e resurseve të nevojshme është një tjetër shkak që ndikon në mosfunksionimin e kontrolleve. Procedurat për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve shpesh herë nëpër OB, nuk janë të dokumentuara mirë, duke shpie në mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe menaxhim të dobët të rreziqeve.

Sistemi i kontrollit të brendshëm ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, për të përmbushur objektivat në tërësi për të siguruar menaxhmentin se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive dhe në parandalimin e gabimeve dhe parregullsive.

### **Rekomandimet për Qeverinë**

- Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta përmbushin përmes mënyrave tjera të parapara me rregullore; dhe
- Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së. Këto komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së. Po ashtu, të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA.

21 MASHT, UP, Komunitat: Obiliq, Fushë Kosovë, Istog, Malishevë.

22 Avokati i Popullit, Këshilli Prokurial, Komunitat: Obiliq, F.Kosovë dhe Istog.



## *Kapitulli - III*

---

# *AUDITIMET E PERFORMANCËS, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PAJTUESHMËRISË*



# 1. Auditimet e Performances, teknologjisë së informacionit dhe pajtueshmërisë

Zyra Kombëtare e Auditimit, vazhdon me fokus të veçantë ndaj auditimeve të performancës, si faktor i rëndësishëm në ndryshimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Auditimet e performancës vlerësojnë se sa fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe në dobi të mirëqenies së qytetarëve. Përmes rezultateve të auditimit, Kuvendi dhe qytetarët do të jenë në gjendje që t'i mbajnë llogaridhënës administruesit e fondeve publike.

Për sezonin auditues 2023-2024 janë mbuluar fusha me të rëndësishme për qytetarët duke marrë parasysh edhe qëllimet e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për zhvillim të vazhdueshëm 2030.

Gjatë sezonit raportues, janë kryer 14 raporte të auditimit të performancës përfshirë prokurimin, teknologjinë e informacionit si dhe raportet për auditimin paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) të Shqipërisë dhe auditimin e përbashkët rajonal për Barazinë gjinore. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 124 rekomandime. Në vijim, janë paraqitur raportet, temat dhe përmbajtja e tyre.

Shërbimet publike në Kosovë përballen me sfida si në efikasitet ashtu edhe në efektivitet. Auditimet kanë nxjerrë në pah joefikasitet në shërbimet shëndetësore, ku koha e pritjes së pacientëve në klinika, veçanërisht në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), me raste është mbi katër vite. Përveç kësaj, programet për integrimin e grave rurale në tregun e punës nuk kanë arritur rezultate të kënaqshme.

Shqetësimet e mëtejshme përfshijnë llogaridhënien dhe transparencën. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dështoi të mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe ato që përfitojnë fonde sponsorizimi nga bizneset private. Në mënyrë të ngjashme, Administrata Tatimore nuk ka arritur t'i identifikoj dhe të ndërmarrë masa ligjore ndaj kompanive të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim por të cilat nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim. Auditimet evidentuan mangësi edhe në licencimin e mediave, ku disa media operojnë pa përmbushur detyrimet e tarifës vjetore. Për më tepër, menaxhimi i parkingjeve publike është karakterizuar me mungesë të planifikimit dhe lëshim të lejeve të parkingut pa dokumentacionin e duhur. Këta shembuj ngrisin shqetësime në lidhje me efektivitetin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe të zbatimit brenda organizatave apo institucioneve publike. Gjatë përmbjlljes së shitjeve direkte të aseteve, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk ishte efikase, pasi kërkesat për blerje nuk u trajtuan në kohë optimale. Po ashtu auditimi ynë tregon se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Instituti nuk kanë arritur t'i menaxhojnë si duhet tokat bujqësore. Janë mbi 309 hektar tokë bujqësore të Institutit që nuk menaxhohen në mënyrën e duhur, prej tyre mbi 52ha shfrytëzohen në mënyrë të pa autorizuar dhe rreth 31ha të tjera janë tjetërsuar pa njohurinë/pëlqimin e institutit dhe në rrethana të pa qarta.

Fusha e prokurimit publik ka qenë në fokus të auditimeve tona për shkak se, përmes procedurave të prokurimit publik, gjatë vitit 2023, janë lidhur gjithsej 10,183 kontrata në vlerë 810,438,403€ që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rritje prej 251,420,490€ apo rreth 45%. Rritje të vlerës së kontratave të nënshkruara për mbi 62% krahasuar me vitin paraprak kishin Ndërmarrjet Publike, ndërsa për Autoritetet Qeveritare kishin një rritje prej mbi 42% krahasuar me vitin paraprak.

Këto aktivitete janë zhvilluar nga 165 Autoritete Kontraktuese, ndërsa për 18 institucione të pavarura aktivitetet e prokurimit i ka zhvilluar Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Sipas llojit të prokurimit pjesëmarrjen më të lartë rreth 58% e vlerës së përgjithshme të kontratave për vitin 2023 është lloji i prokurimit për punë, në vlerë prej 473,442,602€, furnizimet në vlerë 228,085,606€ apo rreth 28%, shërbimet në vlerë 105,611,002€ apo rreth 13% dhe konkurset e projektimit me 3,299,192€ apo rreth 0.4%.

Ndërsa sipas procedurave, vlera më e madhe prej 665,768,975€ apo rreth 82%, i takon procedurës së hapur, e pasuar me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës në vlerë prej 117,258,922€ apo rreth 14%, mandej, procedura e kufizuar (e hapur në dy faza) në vlerë prej 13,176,422€ apo 1.63%, kuotimet e çmimit të cilat kishin vlerë 7,799,039 apo 0.96%. Ndërsa, në vlera më të vogla ishin konkursi i projektimit me vlerë 3,037,845€ apo 0.37%, procedura me vlerë minimale në shumë 2,269,659€ apo 0.28% dhe procedura konkurruese me negociata (e hapur në dy faza) e që kap vlerën 1,127,541€ apo 0.14%.

Fusha e prokurimit publik është mbuluar në auditimet tona të rregullta financiare dhe pajtueshmërisë në të gjitha institucionet publike të audituara. Ndërsa, në aspektin e performancës kemi audituar tema specifike, të cilat janë të prezantuara në këtë kapitull.

Në fushën e TI-së institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë veprime të mjaftueshme për të siguruar menaxhim të mirë të projekteve dhe ka mangësi në shtrirjen dhe përdorimin e sistemeve dhe sigurinë e të dhënave:

- Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, ka dështuar për të menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës, në vlerë totale prej 5.6 milion euro;
- Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur të zbatoj Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik, i cili nuk përdoret nga të gjitha barnatoret e niveleve të ndryshme shëndetësore deri në shpërndarjen e barnave tek pacientët si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të duhura rreth sigurisë së informacionit për këtë sistem;
- Ndërsa auditimi paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë i kryer në Ujësjesit Rajonal të Prishtinës dhe Tiranës, nxjerrë në pah mangësi të theksuara në qeverisjen e TI-së, sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve në të dy kompanitë e ujësjesit.

## 1.1. Auditimet e performancës

Përmes auditimeve të performancës, Zyra Kombëtare e Auditimit synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike. Në këtë fushë janë kryer 11 auditime që përfshinë tema të ndryshme. Në kuadër të këtyre auditimeve janë dhënë 94 rekomandime për organizatat e audituara. Në vijim është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

## Tema: Efektiviteti dhe efikasiteti i kontraktimit të shërbimeve shëndetësore dhe sociale nga Institucionet e Republikës së Kosovës

Institucionet e Republikës së Kosovës përveç shërbimeve shëndetësore që ofrojnë përmes institucioneve publike përgjegjëse, ato kanë nënshkruar përgjatë viteve edhe kontrata me organizata jo qeveritare për shërbime shëndetësore dhe sociale për të plotësuar nevojat e qytetarëve dhe për të iu ofruar atyre shërbime shëndetësore shtëpiake (vizitat paliative dhe shtëpiake). Dy nga organizatat jo qeveritare me të cilat bashkëpunohet për këtë qëllim qoftë në nivelin qendror apo edhe atë lokal janë 'Caritas Kosova' dhe 'Islamic Relief'.

Audimi ka përfshirë marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontratat e nënshkruara nga disa Institucione Publike (komuna dhe Minsitri) me Caritas Kosova për periudhën 2018 – 2022, pasi që i njëjti ishte ofruesi kryesor i këtyre shërbimeve dhe nga paratë publike janë shpenzuar mbi 14.5 milion euro për këtë periudhë.

**Mesazhi i auditimit:** Shërbimet shëndetësore dhe sociale shtesë ishin të nevojshme për t'u kontraktuar, për arsye të mos aprovimit të stafit shtesë si dhe rritjes së popullsisë në komunat e audituara, mirëpo mangësitë që kanë përcjellë këto procese, qoftë mos vlerësimi real i nevojave për shërbime shtesë, përdorimi i procedurave të ndryshme pa një bazë të qëndrueshme se cila është procedura e duhur për këto shërbime, nënshkrimi i marrëveshjeve të drejtpërdrejta pa siguruar transparencë dhe mos menaxhimi i kontratave, kanë rezultuar që këto shërbime mos të arrijnë efikasitetin dhe efektivitetin maksimal të mundshëm.

Kontraktimi i shërbimeve nga organizatat jo qeveritare është përcjellë me sfida legislative dhe procedurale. Vlen të theksohet që pjesa e menaxhimit dhe monitorimit të shërbimeve, ishte mangësi tek të gjitha llojet e procedurave, pra është e pamundur matja e saktë e ndikimit të tyre.

Menaxhim jo i mirë dhe joefikas i shërbimeve të kontraktuara. Sasitë e kontraktuara nuk ishin në përputhje me nevojat reale. Mos dokumentimi i nevojave reale, ka ndikuar që raporti i shërbimeve të ofruara përmes stafit të rregullt të QKMF-ve krahasuar me ato të pranuar dhe paguara për një staf të angazhuar përmes Caritas Kosova të jetë 264% në rastin më të mirë dhe 969% në rastin më të keq. Pra, stafi i rregullt i QKMF-ve ka ofruar shumë më shumë shërbime brenda vitit. Ky disproporcion në ofrimin shërbimeve nxjerrë në pah joefikasitetin dhe praktikat e dobëta të kontraktimit të këtyre shërbimeve.

Mos koordinimi i kontraktimit të shërbimeve shëndetësore ndërmjet niveleve qendrore dhe lokale, ka rezultuar me financimin e dyfishtë të shërbimeve nga burime të ndryshme, duke rezultuar në joefikasitet të mundshëm buxhetor.

Po ashtu, çështjet si mos verifikimi i licencave të stafit shëndetësor, vlera të gabuara të parashikuara dhe kontraktimi me vlera të dyfishuara tregojnë dobësi në menaxhim dhe transparencë.

Mungojnë raportet e pavarura nga menaxherët e kontratave të caktuar nga komunat, janë vetëm raportet e përgatitura nga ofruesi i shërbimeve, në bazë të të cilave bëhen edhe pagesat. Po ashtu nuk ka raporte monitorimi nga Komunat për zbatimin e kontratave.

Ndërsa, qytetarët ishin përgjithësisht të kënaqur me shërbimet shëndetësore të marra dhe me kohëzgjatjen e pritjes për trajtim.

Megjithatë, rezultatet e këtij auditimi tregojnë se për të qenë kontraktimi i shërbimeve shëndetësore shtesë edhe më efikas dhe efektiv, shumica e proceseve për kontraktimin e tyre kanë vend për përmirësim dhe vëmendje në të ardhmen.

## Tema: Lista e pritjes së pacientëve në institucionet publike shëndetësore

Ngritja e cilësisë si dhe mbajtja e një standardi të lartë të shërbimeve mjekësore ka lidhje të drejtpërdrejtë me cilësinë e jetës së qytetarëve të vendit. Mangësitë në sistemin shëndetësor të një vendi ndikojnë në shfaqjen e pakënaqësive dhe rritjen e pasigurisë për shëndetin dhe mirëqenien e individëve dhe shoqërisë si tërësi.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës për të vlerësuar se çfarë masash kishin zbatuar Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar për të siguruar trajtim efikas të pacientëve në listat e pritjes si dhe të vlerësojë shpërndarjen e burimeve (njerëzore dhe materiale), mënyrën e regjistrimit dhe monitorimin e listave të pritjes.

**Mesazhi Auditimit:** *Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar nuk janë efikase në trajtimin e kërkesave të qytetarëve për trajtim mjekësor. Kërkesat për trajtim janë të mëdha ndërsa kapacitetet e sistemit shëndetësorë për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave janë të kufizuara, sidomos sa i përket infrastrukturës dhe pajisjeve, e me raste edhe sa i përket materialit mjekësor. Në anën tjetër numri i mjekëve specialistë është në mospërputhje në raport me këtë infrastrukturë dhe këto pajisje. Si rrjedhojë, ka pacientë që kanë pritur më shumë se katër vite për të marrë shërbim në klinikat e QKUK-së.*

Auditimi ka identifikuar se nuk është bërë shpërndarje e harmonizuar mes burimeve njerëzore dhe materiale sepse numri i mjekëve specialistë është në mospërputhje në raport me infrastrukturën dhe pajisjet që janë në dispozicion në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. Si shembull, numri i ortopedëve në raport me sallat operative është 9 me 1, në klinikën e kardiologjisë (kardiologjia invazive) është 8 me 1, ndërsa në spitale rajonale këto shërbime nuk ofrohen fare. Po ashtu performanca e mjekëve nuk është e njëjtë sepse disa mjekë janë më aktiv me operacione krahasuar me kolegët e tyre mjekë. Si shembull në njërin nga klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka mjekë që kryejnë rreth 500 operacione në vit ndërsa ka mjek në po të njëjtën klinikë kryejnë vetëm një operacion në vit. Gjendje të ngjashme kemi gjetur në së paku katër klinika.

Auditimi po ashtu ka identifikuar mungesë të anesteziologëve në veçanti, që u japin shërbime të gjitha klinikave kirurgjike e kjo mungesë për pasojë i redukton kapacitetet operative të klinikave. Ka raste kur pajisjet janë të vjetruara gjë që ndikon në efikasitetin e trajtimit të pacientëve nga listat e pritjes. Po ashtu menaxhimi jo i duhur i furnizimit me material mjekësor dhe pamjaftueshmëria e materialit pengojnë trajtimin me kohë të pacientëve.

Shembull është furnizimi me proteza totale të gjurit dhe të kërdhokullës, të cilat janë të disponueshme vetëm në klinikën e ortopedisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ndërsa spitalet rajonale nuk furnizohen me to. Situatë e ngjashme është edhe sa i përket furnizimit me thjerrëza të syrit, ku vetëm klinika e oftalmologjisë është e furnizuar, ndërsa spitalet rajonale furnizohen vetëm me sasi simbolike.

Në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës nuk ka një sistem të centralizuar e as formal për të regjistruar pacientët në lista të pritjes, gjë që e cenon saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave në lista. Për shkak të mënyrës aktuale të regjistrimit, nuk ka të dhëna të qarta për numrin e pacientëve që presin e në veçanti për kohën që duhet të presin për të marrë shërbime shëndetësore. Disa institucione shëndetësore (reparte të caktuara në spitale rajonale) nuk lënë gjurmë të listave të pritjes. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë të regjistrimit krijon hapësirë për keqpërdorim të burimeve publike, sepse bën të mundur manipulimin e listave të pritjes dhe dhënie jo të drejtë të shërbimeve shëndetësore.

Andaj klinikat dhe spitalet rajonale nuk janë në gjendje t'i përgjigjen në mënyrë efikase kërkesave të qytetarëve për trajtim mjekësor.

## Tema: Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës

Për më shumë se dy dekada Kosova është përballur me papunësinë e madhe në zonat rurale, ku veçanërisht preken gratë. Për të arritur uljen e papunësisë në këto zona dhe përmirësimin e jetës së grave, janë paraparë grante qeveritare të cilat shpërndahen përmes programit të zhvillimit të bujqësisë.

Auditimi ynë në këtë fushë ka përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë si dhe Agjencinë e Punësimit.

Qëllimi është që të vlerësojmë efektivitetin dhe ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, me fokus në rritjen e pjesëmarrjes së tyre dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.

**Mesazhi i auditimit:** *Institucionet përgjegjëse publike kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për fuqizimin e pozitës së gruas në shoqëri, mirëpo ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Programet e Zhvillimit Rural dhe masat afirmative nuk kanë arritur të sigurojnë një përkrahje të barabartë për të dy gjinitë dhe nuk ka një vlerësim rreth arritjes së qëllimeve të programit nga perspektiva gjinore. Masat afirmative kushtëzojnë gratë me tre deri në pesë vite si pronare e tokës apo e biznesit, duke e bërë të pa efektshëm qëllimin e tyre, për shkak se kufizon pjesëmarrjen apo përkrahjen e grave dhe vajzave të cilat kanë filluar aktivitetin e tyre rishtazi.*

Mungon një aktivizim më i madh në informimin e duhur të grave për shfrytëzimin e të drejtës së tyre të garantuar me ligj. Përderisa, mungesa e funksionalizimit të Komitetit Monitorues, ka shkaktuar probleme në procesin e monitorimit të programeve për Zhvillim Rural dhe si rrjedhojë nuk kanë të

dhëna për të pasqyruar rezultatet e arritura apo ndikimin e tyre në përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Agjencia e Punësimit nuk posedon të dhëna të ndara sipas gjinisë për zonat urbane dhe rurale në lidhje me regjistrimin, shërbimet e punësimit, pjesëmarrjen në masat aktive të tregut të punës dhe aftësimin profesional të të papunëve të regjistruar. Në veçanti, mungesa e shërbimeve për aftësimin profesional të grave fermere bën që kjo kategori të ketë vështirësi në përfshirjen e tyre në tregun e punës.

## Tema: Raport i përbashkët - Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës

Institucionet Supreme të Auditimit të Republikës së Kosovës, Maqedonisë së Veriut, dhe Republikës së Shqipërisë në mars të vitit 2023 nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi trepalësh për të kryer një auditim të përbashkët të performancës me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës”. Përmes këtij auditimi vlerësohet nëse masat dhe projektet e zbatuara nga institucionet kompetente janë efektive për të siguruar përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, me fokus në rritjen e pjesëmarrjes së tyre dhe identifikimin e mundësive për përmirësim. Ky auditim i përbashkët u krye me mbështetjen e Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave “UN Women” dhe rrjedhë nga Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Bazuar në konkluzionet e auditimeve kombëtare, mesazhi kryesor është:

**Mesazhi i auditimit:** Masat dhe aktivitetet për promovimin e barazisë gjinore të grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës, të ndërmarra nga institucionet publike kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Kosovës, nuk janë mjaft efikase dhe efektive për të përfshirë gratë nga zonat rurale në tregun e punës dhe t’i mbajë ato në zonat rurale. Institucionet publike kompetente në të tre vendet kanë ndërmarrë një sërë aktivitetesh për të forcuar pozitën e gruas në shoqëri, por ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Përmes këtij raporti të përbashkët tregojmë se është koha për të njohur kontributin e rëndësishëm të grave për familjen, komunitetin dhe vendin, si dhe për të siguruar që ato mbështeten dhe mbrohen si anëtarë të barabartë të shoqërisë. Fuqizimi i tyre social dhe ekonomik do të krijojë mirëqenie sociale, zhvillim ekonomik, cilësi më të mirë të jetës në zonat rurale dhe komunitete të qëndrueshme. Në raportet individuale janë dhënë rekomandimet për organizatat përkatëse, Raporti i ynë përmban 10 rekomandime.

## Tema: Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media

Mediat, si burim kryesor i informacionit, kanë një rol shumë të rëndësishëm në shoqërinë tonë duke ndikuar në opinionin publik dhe në zhvillimin e kulturës dhe identitetit. Institucioni përgjegjës në vendin tonë për licencimin e mediave është Komisioni i Pavarur i Mediave.



Procesi i menaxhimit të licencave të Ofruesve të Shërbimeve nga Komisioni i Pavarur për Media është një proces i rëndësishëm për rregullimin e aktiviteteve të mediave në Kosovë.

Auditimin e kemi fokusuar te Komisioni i Pavarur për Media dhe Departamentet përkatëse, si ai për Licencim, Monitorim dhe Analizë të Mediave. Përmes auditimit synohet përmirësimi i procesit të menaxhimit të licencave.

**Mesazhi i auditimit:** Komisioni i Pavarur për Media ka bërë përpjekje për të menaxhuar procesin e licencimit të mediave, megjithatë ky proces karakterizohet me mangësi dhe dobësi duke ndikuar që kriteret për aktivitetet mediatike të mos zbatohen. Mediat veprojnë pa përmbushur obligimet financiare të tarifave vjetore përgjatë viteve dhe pezullimet e licencave të mediave nuk realizohen nga Komisioni i Pavarur i Mediave ku për pasojë kemi grumbullim të borxheve. Në grumbullimin e borxheve ka ndikuar edhe mungesa e monitorimit të mediave me kohë dhe në mënyrën e duhur dhe mos ndërmarrja e hapave konkret ndaj atyre mediave të cilat nuk zbatojnë kriteret dhe anashkalojnë pagesat e tarifave vjetore. Po ashtu, ka vonesa të theksuara në mbledhjen e borxheve dhe probleme në kontrollet e brendshme të Autoritetit të mediave.

Komisioni i Pavarur i Mediave me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të parashtruara për licencat e transmetimit nuk ka marrë parasysh të gjitha kriteret sipas rregullores së përcaktuar. Nuk janë përmbushur kriteret me rregulloret përkatëse duke mos përmbushur kriterin sikurse është vërtetimi tatimor dhe në një rast mungon diploma universitare. Nuk janë përmbushur të gjitha kriteret ashtu siç ishte paraparë me rregulloret përkatëse, ku mungojnë marrëveshjet valide për të drejtën e transmetimit për disa kanale të caktuara si të obligueshme për transmetim.

Mediat nuk kanë respektuar në mënyrë të vazhdueshme afatin 60-ditor të aplikimit për ripërtëritjen e licencave dhe pavarësisht shkeljeve financiare, autoritetet rregullatore nuk kanë marrë masa ndëshkuese. Ka mungesë konsistente në rekomandimet për zgjatjen ose heqjen e licencës, duke çuar në interpretime subjektive. Në procesin e vendimmarrjes për ripërtëritje të licencave kishte vonesa të mëdha, kryesisht për shkak të mungesës së kuorumit në Komisionin e Pavarur të Mediave duke ndikuar negativisht tek operatorët dhe shërbimet e transmetimit.

Autoriteti rregullativ kishte hasur sfida në pezullimin e licencave të ofruesve të shërbimeve mediatike pasi që proceset e pezullimit të licencave nuk janë ndjekur me kujdes. Po ashtu mungesa e monitorimit më proaktiv nga autoriteti rregullativ në zbatimin e detyrimeve financiare të ofruesve të shërbimeve mediatike dhe statusin e transmetimeve të tyre kanë shkaktuar akumulimin e borxheve. Autoriteti rregullativ nuk kishte ndërtuar një mekanizëm të qartë për pezullimin e përkohshëm të licencave, duke kontribuar në sfida financiare për autoritetin rregullativ dhe ofruesit e shërbimeve mediatike.

## Tema: Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit

Sporti në Kosovë ka një traditë të gjatë dhe ka një rol të rëndësishëm në shoqëri. Sporti paraqet një pasqyrë se si vendet tjera e shohin Kosovën. Me anë të sportit ne jo vetëm që mund të kemi një shoqëri të shëndetshme por edhe të kemi një imazh të lartë në botë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit çdo vit mbështet dhe ndihmon zhvillimin e aktiviteteve sportive, përmes të cilave synon të kontribuoj në organizimin përmbajtjesor, zhvillimin e kuadrove, anëtarësimin dhe licencimin e sportit

në Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare. Si formë tjetër e financimit të sportit është edhe ajo përmes bizneseve private ku atyre u mundësohet zbritje deri në 30% të tatimit në fitim me qëllim që ato mjete të përdoren për financimin e organizatave sportive. Megjithatë kjo mbështetje përcjellët me mangësi të shumta.

Auditimi ka përfshirë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e cila bën përgatitjen, vlerësimin dhe aprovimin e politikave programore të sportit, të cilat kanë të bëjnë me masivizimin e sportit dhe zhvillimin kualitativ të tij, si dhe Administratën Tatimore të Kosovës për mbulimin e bizneseve që sponsorizojnë sportin.

**Mesazhi i auditimit:** *Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka arritur t'i mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe atyre që përfitojnë vërtetim për sponsorizimin nga bizneset private. Një pjesë e madhe e organizatave sportive nuk kanë raportuar se si i kanë shpenzuar fondet e subvencionimit dhe kanë përfituar në vazhdimësi. Ndërsa Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka arritur t'i identifikoj dhe të ndërmarrë masat ligjore ndaj kompanive të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim por të cilat nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim.*

Aktivitetet e subvencionuara dhe sponsorizuara nga kompanitë private nuk i arrijnë qëllimet e tyre dhe nuk realizohen siç duhet, si pasojë fondet e sponsorizimit nuk kanë arritur qëllimet për ngritje të cilësisë së sportit në vend. Organizatat sportive gjatë viteve 2020-2022, nuk kanë raportuar për shpenzimet e subvencioneve në vlerë prej 3.5 mil.€ të financuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Sponsorizimi dhe lirimi i tatimit për kompanitë private ka rezultuar me shmangie tatimore. Në mostrat tona kemi gjetur se mbi 490,000€ nuk janë transferuar tek klubet sportive si sponsorizim nga kompanitë private edhe pse në Administratën Tatimore të Kosovës kompanitë kishin raportuar se i kishin dhënë këto mjete për sponsorizim. Përveç kësaj, një nga Organizatat Joqeveritare përfituese e projektit “databaza sportive në Kosovë” nuk ka dorëzuar produktin/raportin final me kohë për të cilin Ministria kishte paguar 121,430€.

Andaj, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nuk ka arritur t'i mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe ato që përfitojnë vërtetim për sponsorizim nga kompanitë private. Mungesa e koordinimit ndërmjet MKRS dhe Administratës Tatimore të Kosovës ka lejuar parregullsi të konsiderueshme financiare, duke rrezikuar transparencën, integritetin dhe efektivitetin e financimit të sportit dhe si rezultat buxheti i shteti është dëmtuar.

## **Tema: Menaxhimi i parkingjeve publike në qytetin e Prishtinës nga Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking**

Menaxhimi i parkingjeve është një komponent kritik i infrastrukturës urbane, i cili luan një rol kyç në jetën e përditshme të banorëve dhe vizitorëve në Qytetin e Prishtinës. Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking është autoriteti kryesor për organizimin dhe menaxhimin e parkingjeve publike e cila ka për qëllim që të ofroj shërbime të parkingjeve për qytetarët në Kryeqytet.

Auditimi ynë është fokusuar në Ndërmarrjen Publike Lokale Prishtina Parking me departamentet përgjegjëse dhe Komunën e Prishtinës me Drejtorinë e Inspektoratit.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara për qytetarët nga Ndërmarrja Prishtina Parking. Po ashtu, të vlerësojmë masat dhe veprimet në menaxhimin e parkingjeve dhe bashkëpunimin me Inspektoratin e Komunës së Prishtinës.

**Mesazhi auditimit:** Menaxhimi i parkingjeve publike dhe lejeve të parkimit është karakterizuar me mangësi të theksuara. Ndërmarrja Prishtina Parking dhe Inspektorati i Komunës së Prishtinës nuk janë treguar efikas dhe efektiv në menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të rregullorës për një organizim të mirëfilltë të parkingjeve publike. Ndërmarrja Prishtina Parking është ende në konsolidim, përcjellët me ndryshime rregullative, kontrollet janë të dobëta dhe ka raste që nuk janë në gjendje të dëshmojnë aktivitetet e tyre. Po ashtu Ndërmarrja nuk ka arritur të funksionalojë digjitalizimin e sistemit të parkingjeve me laura dhe shenjëzimin e parkingjeve.

Një numër i konsiderueshëm i lejeve të parkimit janë lëshuar pa dokumentacionin e nevojshëm. Ndërmarrja nuk kishte arritur të bëjë një planifikim të duhur të parkingjeve duke mos priorizuar mjaftueshëm parkimin për banorët rezidentë kundrejt përdoruesve biznesor.

Dështimi në zbatimin rigoroz të rregullores dhe aplikimi i standardeve të ndryshme për lëshimin e lejeve për shkak të neglizhencës kanë krijuar hapësirë për keqpërdorime dhe përfitime të paligjshme.

Disa përdorues të sistemit, kanë mundësinë për të bërë anulime dhe ndryshime në gjopa pa mbetur gjurmë dhe pa një vendim të formalizuar nga Ndërmarrja. Zyrtarët përdorin forma joformale për të kërkuar dhe kryer anulime të gjobave, duke rritur mundësinë për përfitime dhe mungesë dokumentacioni të duhur.

Mungesa e një plani të detajuar dhe afateve kohore konkrete ka bërë që të mos funksionalizohet sistemi digjital i menaxhimit të parkingjeve me laura. Funksionimi manual i laurave dhe monitorët jashtë funksionit kanë shkaktuar konfuzion dhe kanë ulur efikasitetin operacional, duke ndikuar negativisht në të ardhurat dhe besimin e qytetarëve. Ndërmarrja Prishtina Parking operon pa një plan të strukturuar për shenjëzimin e parkingjeve në qytet, duke vepruar në mënyrë ad-hoc.

Kontrollet e brendshme janë joefikase, duke ndikuar negativisht në menaxhimin e parkingjeve. Dhe mungojnë formularë zyrtarë për pranimit-dorëzim të parasë së gatshme.

Me rastin e hartimit të Rregulloreve për organizmin dhe menaxhimin e parkingjeve Prishtina Parking nuk ka bërë analiza të duhura të të dhënave, por kryesisht është bazuar në ankesat e qytetarëve.

Inspektoratit të Komunës së Prishtinës i mungon një plan i strukturuar për inspektimet dhe mbikëqyrjen e parkingjeve publike, duke u mbështetur kryesisht në ankesat e qytetarëve.

Andaj, Ndërmarrja Prishtina Parking dhe Inspektorati i Komunës së Prishtinës nuk janë treguar efikase dhe efektive në menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të rregullorës për një organizim të mirëfilltë të parkingjeve publike.

## Tema: Menaxhimi i tokave/pronës bujqësore nga Instituti Bujqësor i Kosovës

Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm, ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore, por mund të shfrytëzohet edhe për qëllime jo bujqësore në raste të veçanta, në bazë të kritereve të caktuara. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural bënë përgatitjen e politikave publike, përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e bujqësisë, blegtorisë, prodhimit dhe mbrojtjes së bimëve, pylltarisë, mbrojtjen e tokës nga ndërtimet e pa planifikuara urbane dhe rregullimin e tokës bujqësore, si dhe zhvillimit rural.<sup>23</sup> Instituti Bujqësor është Institut publik kërkimor i Kosovës dhe ka pasur objektivë të luaj rol aktiv në zhvillimin e reformave agrare dhe në hulumtime shkencore në Bujqësi.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën “Menaxhimi i tokave/pronës nga Instituti Bujqësor i Kosovës”. Objektivi i auditimit është të vlerësojmë nëse Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Instituti kanë vendosur sistemin e duhur për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokave bujqësore të Institutit dhe nëse procesi i dhënies me qira të këtyre tokave është në pajtueshmëri me kornizën ligjore

**Mesazhi auditimit:** *Auditimi ynë tregon se Ministria dhe Instituti nuk kanë arritur t'i menaxhojnë si duhet tokat bujqësore të Institutit. Ka mungesë të qartë të bazës ligjore për Institutin, Bordi Menaxhues nuk ka funksionuar duke ndikuar që Institutit të mos ketë menaxhim të duhur dhe politika drejtuese për zhvillimin e aktivitetit të institutit. Janë mbi 309 hektar tokë bujqësore të Institutit që nuk menaxhohen në mënyrën e duhur, prej tyre mbi 52ha shfrytëzohen në mënyrë të pa autorizuar dhe rreth 31ha të tjera janë tjetërsuar pa njohurinë/pëlqimin e institutit dhe në rrethana të pa qarta. Instituti për nevojat hulumtuese shfrytëzon rreth 5ha. Ndërsa rreth 260ha që janë ofruar me qira nga Ministria nuk janë në kontrollë të plotë nga ana e saj pasi që një pjesë shfrytëzohen në mënyrë të pa autorizuar nga persona të ndryshëm.*

Mungesa e bazës së qartë ligjore për Institutin ka dëmtuar rëndë funksionimin e duhur të tij. Kjo mangësi ka sjellë keqmenaxhimin e konsiderueshëm të tokave bujqësore të Institutit. Po ashtu mungesa e programeve kërkimore shkencore ka rezultuar që shumica e këtyre tokave të mbeten djerrë, duke kontribuar në menaxhimin e dobët, tjetërsimin dhe shfrytëzim të pa autorizuar. Aktualisht, vetëm një pjesë e vogël e tokës përdoret për kërkime, ndërsa pjesa më e madhe e saj është dhënë me qira.

Gjatë viteve të ndryshme, Institutit i janë tjetërsuar rreth 31ha në zonat kadastrale të Prishtinës dhe Pejës. Në të gjitha rastet e tjetërsimit, nuk është marr pëlqim nga Instituti si titullar i këtyre pronave. Për tjetërsimet e ndodhura para vitit 1999, prej rreth 16ha, 49ari, 37m<sup>2</sup> mungon dokumentacioni përkatës. Ndërsa pas vitit 1999 janë tjetërsuar rreth 14ha, 41ari, 73m<sup>2</sup>, ku shumica prej tyre janë bazuar në aktvendimet para vitit 1999, duke vënë në dyshim vërtetësinë e tyre. Po ashtu Komuna e Pejës për disa raste në mënyrë të njëanshme ka vendosur që ti tjetërsoj pronat e Institutit pa ndonjë pëlqim të institutit për veprimet të tilla.

Institutit i janë uzurpuar mbi 52ha tokë bujqësore si dhe një sipërfaqe tjetër toke është uzurpuar në të cilën janë ndërtuar 26 objekte/villa. Tokat e Institutit nuk monitorohen dhe inspektohen nga Ministria

<sup>23</sup> Rregullore (qrk) - nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive.

dhe as nga Instituti. Kjo mungesë ka çuar në menaxhim të dobët, përdorim të pa autorizuar të tokës bujqësore dhe shfrytëzim të saj për aktivitete jo bujqësore si dhe ndotje e tokave nga materiale të dëmshme etj.

Mungon transparenca dhe menaxhim është joadekuat në procesin e dhënies me qira të pronave nga Instituti Nga 11 kontratat e qirasë të lidhura nga viti 2016, vetëm tri (3) janë të bazuara në shpallje publike, shfrytëzimi i kontratave për qiradhënie që nuk i përkasin natyrës bujqësore, mos përcaktimi i menaxhereve të kontratave, mos përshkrimi i gjendjes fillestare të tokës, mos paraqitja e projektit të rikultivimit.

Mungesa e menaxherëve për monitorimin e kontratave ka rezultuar në probleme të shumta në përdorimin e pronave bujqësore me qira. Si rezultat, Ministria dhe Instituti nuk kanë informacion mbi mënyrën e shfrytëzimit të këtyre tokave dhe nëse ato përdoren në përputhje me vetitë e tyre.

Andaj, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhillimit Rural nuk ka vendosur sistemin e duhur për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokave bujqësore të Institutit. Po ashtu Ministria dhe Instituti nuk kanë qenë efektive në menaxhimin dhe monitorimin e pronave të Institutit.

## Tema: Vlerësimi i Procedurave të Shitjes Direkte të Aseteve nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit është e autorizuar për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe asetëve të tyre, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e tyre.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar procedurat e Shitjeve Direkte të Aseteve nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2019-2021, ndërsa për qëllime të vlerësimit se a kanë ndryshuar praktikatat apo a është rritur efikasiteti, kemi audituar edhe shitjeve të përfunduara gjatë viteve 2022-2023.

**Mesazhi auditimit:** Gjatë përmbylljes së shitjeve direkte të asetëve, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk ishte efikase, pasi kërkesat për blerje nuk u trajtuan në kohë optimale. Procesi i kategorizimit të asetëve kishte dobësi dhe parcelimi i tokave për shitje nuk ishte bërë si duhet. Viteve të fundit, vetëm kërkesat për blerje nga ekonomitë familjare ishin subjekt i shqyrtimit. Sa i përket përzgjedhjes së vlerësuesve, përveç mungesës së një metodologjie të përcaktuar nuk kemi vërejtur ndonjë dobësi.

Trajtimi i kërkesave për shitje direkte kishte vonesa të konsiderueshme, deri në 86 muaj për periudhën 2019-2021, dhe 68 muaj për periudhën 2022-2023. Ky mos efikasitet ka rezultuar me numër të madh kërkesash të pashqyrtuara, ku ende presin 1,675 kërkesa, ose 75% e totalit të kërkesave të dorëzuara.

Dështimi për të parandaluar ndërtimet pa leje ka rezultuar me shitje direkte të asetëve, duke eliminuar konkurrencën. AKP dhe NSH-të nuk kanë marrë veprime të mjaftueshme për të parandaluar ndërtimet pa leje, duke bërë që këto asete të shiten pa iu nënshtruar konkurrencës.

Shitja e asetëve shpesh zhvillohej duke eliminuar konkurrencën e mundshme. Raportet referuese/rekomanduese nuk përputheshin me gjendjen faktike, duke çuar në kategorizim të gabuar të asetëve për shitje direkte dhe humbjen e mundësive për çmime më të mira.

## Tema: Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020

Vlerësimi i performancës komunale është një proces i cili nënkupton matjen sa më të drejtë të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e një komune. Ky proces në Republikën e Kosovës rregullohet dhe monitorohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa deklarues të informatave lidhur me performancën komunale janë vetë komunat.

Qëllimi i auditimit është të vlerësoj funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale. Pra, është vlerësuar se si ka funksionuar procesi i raportimit dhe dokumentimit të treguesve nga komunat: Skenderaj, Obiliq, Gjilan dhe Graçanicë. Po ashtu kemi vlerësuar se si është bërë verifikimi dhe vlerësimi i këtij dokumentimi nga ana e MAPL.

**Mesazhi kryesor:** Në përgjithësi, komunat e audituara nuk kanë dokumentuar treguesit e performancës komunale me dokumente mbështetëse. MAPL ka kryer vlerësimin, megjithatë, nuk ka respektuar të gjitha rregullat e vlerësimit, sidomos kërkesën lidhur me verifikimin fizik në terren. Një vlerësim ad hoc i treguesve në terren nga Ministria është kryer pas vlerësimit të performancës komunale, mirëpo, për shkak të mangësive të identifikuar, ky vlerësim nuk ka ndikuar në renditjen finale të komunave përfituese.

Rezultatet e auditimit tregojnë se komunat e audituara nuk kanë mbështetur treguesit e raportuar me dëshmi relevante. Praktikën e ndjekur në bashkëngjithjen e dëshmive ishin të ndryshme dhe jo gjithmonë në përputhje me kërkesat e Dokumentit Kryesor për dëshmi relevante. Komunat kishin vendosur dokumente të ndryshme për të mbështetur treguesit, por këto nuk ishin gjithmonë relevante dhe nuk përputheshin me kërkesat e treguesve.

MAPL ka poentuar komunat bazuar në rezultatet e raportuara nga vetë komunat në performancën komunale, por nuk ka kryer monitorim ose vlerësim të pavarur. Në katër komunat e audituara, u vu re se MAPL-ja ka poentuar disa fusha dhe tregues me numër të njëjtë pikësh, pavarësisht nga dokumentet e ndryshme të bashkëngjitura për të njëjtin tregues. Ky vlerësim jo i drejtë ka ndikuar në rezultatin e Grantit të Performancës Komunale në radhitjen e komunave.

## Tema: Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021

Zyra Kombëtare e Auditimit nga viti 2018 ka filluar bashkëpunimin me Helvetas/DEMOS. Katër auditimet e publikuara si rrjedhojë i këtij bashkëpunimi kishin për qëllim vlerësimin e komunave lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit, menaxhimin e projekteve dhe përmirësimin e shërbimeve

ndaj qytetarëve. Përveç këtyre, në auditimin e fundit është vlerësuar edhe ndikimi apo menaxhimi i këtyre granteve si tërësi dhe dallimet mes pjesës së financimit nga Helvetas/DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ky raport i auditimit ka mbuluar procesin e mekanizmave për kontrollin e cilësisë së të dhënave të raportuara për performancën e vitit 2021, ku vlerësimi është kryer në vitin 2022, ndërsa mjetet janë ndarë gjatë vitit 2023. Auditimi është kryer në komunat: Gjakovë, Klinë dhe Viti si përfituese të Grantit të Performancës Komunale për vitin 2021 dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si monitoruese dhe vlerësuese e këtij procesi.

**Mesazhi i auditimit:** *Auditimi ka konkluduar se, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka arritur të sigurojë kontrolle efektive, të cilat ndikojnë edhe në renditjen përfundimtare të performancës komunale. Mungesa e vlerësimeve paraprake, pranimi i dokumenteve të pa protokolluara dhe mospërputhjet në pikët e dhëna kanë komprometuar efektivitetin e mekanizmave që synojnë të sigurojnë cilësi në raportimin e performancës komunale. Këto të meta kanë ndikuar në renditje jo të drejtë të komunave të audituara.*

Cilësia e raportimit të performancës komunale nga ana e komunave nuk është në nivelin e duhur. Përkundër përpjekjeve të komunave për organizimin e brendshëm dhe raportimin e performancës së tyre, mangësitë në komunikim, proceset e miratimit dhe shpërndarja e detyrave i kanë bërë mekanizmat e kontrollit për sigurimin e cilësisë të paefektshme. Mungesa e dëshmimeve të komunikimit dhe miratimit nga zyrtarët përgjegjës rrezikon besueshmërinë e të dhënave të raportuara.

Ministria nuk ka arritur që të sigurojë qasje për personat e autorizuar në sistem. Ajo gjithashtu nuk ka arritur të zbatojë kontrollet e duhura të qasjes për të harmonizuar funksionalitetet e sistemit me rregulloret dhe për të zbatuar masat e konfidencialitetit në sistem. Mangësitë në praktikën e menaxhimit të llogarive, duke përfshirë llogaritë e pa personalizuara dhe mungesën e respektimit të standardeve të menaxhimit të fjalëkalimeve, komprometojnë më tej integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave të komunave.

## 1.2. Auditimet e teknologjisë së informacionit

Zyra Kombëtare e Auditimit po i kushton rëndësi të veçantë edhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Këtë sezonë janë përfshirë projekte dhe sisteme të informacionit me ndikim në institucionet publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Janë kryer dy auditime në këtë fushë dhe Raporti për auditimin paralel ZKA-KLSH i kryer vitin e kaluar është finalizuar gjatë kësaj sezoni. Në këtë raporte janë dhënë 30 rekomandime për organizatat e audituara. Në vijim është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

### Tema: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik

Ministria e Shëndetësisë (MSh) zhvillon dhe zbaton politika të kujdesit shëndetësor, duke siguruar një sistem të qasshëm dhe jo diskriminues që i përmbahet standardeve të larta.

MSh nga viti 2013 ka investuar në digjitalizimin e menaxhimit të stokut farmaceutik në institucionet shëndetësore, për furnizim me barna dhe material shpenzues të listës esenciale dhe jo esenciale për pacientë. Megjithatë, ka mangësi në shtrirjen dhe përdorimin e sistemit, si dhe në menaxhimin e qeverisjen e TI-së dhe sigurinë e të dhënave.

Auditimi ynë ka vlerësuar menaxhimin e Sistemit të Stokut Farmaceutik dhe sigurinë e informacionit lidhur me këtë sistem në Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe përdorimi i sistemit nga institucionet publike shëndetësore të Kosovës.

**Mesazhi i auditimit:** *Ministria e Shëndetësisë ka dështuar në zbatimin e plotë të këtij sistemi nga të gjitha njësitë shëndetësore, barnatoret e reparteve të spitaleve dhe klinikave si dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare. Kjo rezulton me menaxhim jo të mirë të stokut farmaceutik, planifikimin jo të mirë dhe shfrytëzimin jo efikas/racional të barnave dhe materialit medicinal. Dobësi ka edhe në sigurinë e informacionit dhe kontrollet e aplikacionit në këtë sistem.*

Ministrisë i mungojnë mekanizmat adekuat të qeverisjes së TI-së përkundër investimeve të konsiderueshme në shtrirjen e sistemeve. Për shtrirjen dhe përmirësimin e infrastrukturës harduerike në tërë territorin e Kosovës janë investuar mbi 6.1 milion euro për sistemet shëndetësore përfshirë edhe për Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik. Megjithatë, zbatimi i plotë i sistemit nuk është arritur ende nga të gjitha barnatoret e niveleve të ndryshme shëndetësore deri në shpërndarjen e barnave tek pacientët. Ka mungesë të përgjegjësive të qarta për administrimin e sistemit si dhe politikave e procedurave të teknologjisë së informacionit. Këto mangësi jo vetëm që rrezikojnë keqshpërndarjen e burimeve në investime, por edhe komprometojnë sigurinë e të dhënave me rëndësi strategjike për Ministrinë e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndërmarrë veprime të duhura rreth sigurisë së informacionit për Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik duke rritur rrezikun për mbrojtjen e privatësisë së pacientit dhe integritetin e të dhënave në përgjithësi. Sistemi për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik ka mangësi edhe në regjistrimin e të dhënave dhe gjenerimin e raporteve. Mungesa e ndërlidhjes me sistemet qendrore rrit rrezikun e vendosjes së të dhënave të pasakta, ndërsa mos përcaktimi i kufizimit të datës së skadencës për artikujt rrezikonë efikasitetin e përdorimit të barnave.



Andaj, Sistemi Informativ për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në lidhje me shpërndarjen e barnave dhe materialit shpenzues të listës esenciale dhe jo esenciale për pacientë. Megjithatë, ka mangësi në shtrirjen dhe përdorimin e sistemit, si dhe në menaxhimin e qeverisjen e TI-së dhe sigurinë e të dhënave.

## Tema: Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka rol dhe përgjegjësi të krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin parauniversitar, arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë. Gjithashtu, me rritjen e trendit të zhvillimit në fushën e teknologjisë së informacionit Qeveria ka investuar në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit edhe në arsim, duke investuar në projekte që kanë të bëjnë me digjitalizimin e arsimit.

Gjatë viteve 2013-2017, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka zhvilluar projektin për digjitalizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, në vlerë prej 4,931,000€ sipas marrëveshjes për kredi të butë, e cila do të paguhet deri në vitin 2032 në një vlerë totale 5,637,519€ (përfshirë kryegjënë, interesin, tarifën).

Auditimi është bërë për të vlerësuar nëse MAShTI ka menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit” në mënyrë efektive për të përmbushur objektivat e këtij projekti dhe qëllimin e Ministrisë për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës.

**Mesazhi i auditimit:** MAShTI ka dështuar për të menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit” për të përmbushur objektivat e këtij projekti dhe qëllimin e ministrisë për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës. Ndërsa Qeveria e Kosovës për këtë projekt të pa funksionalizuar/shfrytëzuar ka obligime ndaj huamarrësit deri në vitin 2032, që do të paguhet nga Buxheti i Kosovës në formë të kësteve të kredisë. Dështimi i projektit për digjitalizim të arsimit parauniversitar në shkollë, në kosto totale prej 5,637,519€, ka rezultuar në dëmtim të buxhetit për këtë shumë.

Ministria ka dështuar në projektin për digjitalizimin e arsimit para-universitar. Ky projekt i financiar plotësisht nga huamarrja është realizuar pa planifikim paraprak i cili është përcjell me mangësi gjatë zhvillimit që kanë ndikuar në mos arritjen e qëllimit dhe përmbushjes së misionit të organizatës. Ministria nuk ka arritur të menaxhoj siç duhet me projektin duke dështuar të caktoj menaxher të projektit dhe personel përgjegjës. Pagesat për punën e realizuar nga Operatori Ekonomik janë kryer pa e bërë ende pranimin e punëve komisioni i pranimit, duke mos arritur të siguroj se produkti i pranuar është në pajtim me kontratën. Nuk është siguruar monitorim i zbatimit të marrëveshjes, prandaj nuk kishte raporte se ky sistem i zhvilluar është mirëmbajtur dy vite pas pranimit, siç është paraparë në marrëveshje. Për më tepër, Ministria nuk ka arritur të ofrojë dokumentacionin e nevojshëm/mjaftueshëm dhe qasjen në sistemet e informacionit, të kërkuara gjatë auditimit. Kjo ka kufizuar dukshëm fushëveprimin e auditimit.

Si rrjedhojë, MASHTI ka dështuar për të përmbushur objektivat e këtij projekti dhe qëllimin e Ministrisë për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës.

## Tema: Raporti i Përbashkët në Auditimin Paralel - Sistemet e Informacionit në Ujësjellësin e Tiranës dhe Prishtinës

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë kanë zhvilluar auditim paralel në Ujësjellësin e Tiranës dhe Prishtinës me fokus në sistemet e informacionit.

Auditimi është fokusuar në kompanitë për furnizim me ujë të pijshëm përkatësisht sistemet e tyre të informacionit. Në ujësjellësin e Tiranës fokusi ishte shtrirë edhe në kontratat dhe pajtueshmërinë e tyre.

**Kosova:** Në Kosovë, furnizimi me ujë të pijshëm bëhet përmes shtatë Kompanive Rajonale të Ujit të cilat sigurojnë shërbime të ujësjellësit për rreth 79% të popullatës në Kosovë. KRU Prishtina ofron shërbimet e ujit dhe kanalizimit për komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Shtimes, Lipjanit, Podujevës, Drenasit dhe Graçanicës. Kjo kompani është ofruesi më i madh i shërbimit të ujit në Kosovë dhe ka të regjistruar 153,509 konsumatorë apo 37% nga totali i konsumatorëve në të gjithë Kosovën. Krahas kësaj, KRU Prishtina ka numrin më të madh të ankesave komerciale/financiare nga ana e qytetarëve.

**Shqipëria:** Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A është institucioni përgjegjës për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Bashkinë e Tiranës. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në zonën e shërbimit, për të cilin është licencuar nga Enti Rregullator i Ujit është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre; Kryerja e aktiviteteve laboratorike.

**Mesazhi i auditimit:** Rezultatet nga auditimi paralel nxjerrin në pah mangësi të theksuara në qeverisjen e TI-së, sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve. Përderisa, në KRU Prishtina janë identifikuar mangësi edhe në kualitetin e të dhënave në Ujësjellësin e Tiranës nuk ka pasur problematika të mëdha në të dhënat elektronike, megjithatë mundësia për humbjen e tyre, ndërprerjen apo tjetërsimin është e lartë.

KRU Prishtina nuk ka siguruar një mjedis efektiv të kontrollit për të ruajtur integritetin dhe vazhdimësinë e sistemeve të TI-së, duke ndikuar negativisht në arritjen e plotë të qëllimeve të ndërmarrjes dhe duke zbehur besueshmërinë e sistemeve të ndërmarrjes.

Në shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A mungojnë strategjia, politikat dhe aktet rregullative që përcaktojnë drejtimin, përgjegjësitë dhe detyrimet mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit.

Në UKT Sh.A, ka munguar një planifikim dhe zhvillim në shërbime të reja informatike, që do të ndihmonin shoqërinë për arritjen e objektivave institucionale. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit janë të pamjaftueshëm, për të hyrë në procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje. Megjithëse nuk ka pasur problematika të mëdha në të dhënat elektronike, mundësia për humbjen e tyre, ndërprerjen apo tjetërsimin është e lartë. Në raportet individuale janë dhënë rekomandimet përkatëse, për Kompaninë Rajonale të Ujësjetës Prishtina janë 18 rekomandime.

Në 14 raportet e auditimit të performancës, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 124 rekomandime për përmirësimin e aspekteve të ndryshme në administratën publike.

### 1.3. Auditimet e pajtueshmërisë

Zyra Kombëtare e auditimit ka në fokus shtrirjen e auditimeve të pajtueshmërisë, përmes të cilave, ofron siguri të arsyeshme se proceset raportuese të kontabilitetit/financiar dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me autoritetet<sup>24</sup>. Gjatë kryerjes së auditimit të tillë, lëndët në fokus janë proceset dhe transaksionet e lidhura me marrjen dhe shpenzimin e fondeve publike. Ato duhen të jenë në pajtueshmëri me autoritetet përkatëse dhe këto autoritete janë kriteret për auditim të tillë.

Për vitin 2023, ZKA ka kryer dy (2) auditime të pajtueshmërisë, në të cilat ka dhënë 12 rekomandime.

### Tema: Prokurimi dhe Menaxhimi i Kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë

Auditimi është fokusuar nëse proceset e prokurimit nga planifikimi e deri te lidhja e kontratave. Auditimi përfshinë proceset e prokurimit në vitin 2023, duke përfshirë planifikimin, procedurat e prokurimit, menaxhimin e kontratës dhe masat që janë ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë, për t'u siguruar që ato kanë qenë efikase deri në arritjen e qëllimit të tyre.

Proceset e blerjeve me prokurim kryesisht ishin të fokusuar në kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe në Investime Kapitale. Buxheti i vitit 2023 për MSH-në për këto dy kategori ishte 60,965,938€ përderisa ishin shpenzuar 27,262,221€ apo 44%. Nga aspekti i fondeve një pjesë e mjeteve ( rreth 9 mil€) kanë qenë nga klauzola e investimeve për projektet për covid 19 të cilat nuk kanë mundur të shpenzohen.

Rezultatet e auditimit tregojnë se Ministria nuk ka arritur që një numër të rëndësishëm të proceseve të prokurimit që ishin planifikuar dhe inicuar t'i përfundojë me kontrata të nënshkruara. Realizimi i ulët i planit të prokurimit kishte një ndikim të theksuar edhe në nivelin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe furnizimeve me paisje mjekësore e barna (niveli ishte nën 50% të buxhetit të Ministrisë).

<sup>24</sup> "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë përputhshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutores, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituar. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira.

Mungesa e analizave me kohë, para procesit të tenderimit dhe kontrollet e dobëta gjatë procesit duke mos vepruar në fazat e hershme të tenderimit, ka rezultuar në mos nënshkrim të kontratave nga menaxhmenti. Kjo situatë ka ndikuar që proceset të ritenderohen dhe ministria të mos i arrijë objektivat e saj në vitin aktual. Pasojat e mos realizimit të këtyre aktiviteteve kishin efekt në funksionimin e shërbimeve shëndetësore. Proceset e vlerësimit në raste të caktuara nuk kishin arritur të identifikojnë gabimet në përlllogaritje të vlerës së ofertës dhe gjatë zbatimit të tyre ishte paraqitur nevoja për amandamentimin e tyre.

Monitorimi i kontratave ka shfaqur sfidat në lidhje me vonesat në përmbushjen e kontratave / aneks kontratave, dhe mos aplikim të platformës të e-Prokurimi për menaxhim të kontratave. Si rezultat i vonesave në hartimin e projektit të Klinikës Emergjente në QKUK ishte shtyrë afati për tenderin e ndërtimit, një projekt i rëndësishëm dhe rrjedhimisht një pjesë e fondeve kishin mbetur të pashpenzuara në vitin 2023.

Me qëllim të përmirësimeve të mundshme që proceset e planifikuara të aktiviteteve të prokurimit të jenë të analizuar mirë dhe me informata të nevojshme për të parandaluar mundësinë që aktivitetet të jenë të pasuksesshme, në këtë raport janë dhënë pesë (5) rekomandime të nevojshme.

## **Tema: Dhënia në shfrytëzim e pronave komunale dhe monitorimi i tyre në Komunën Ferizaj**

Auditimi është fokusuar në zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronave së paluajtshme dhe menaxhimin e pronave me qira në periudhën janar 2022 - shtator 2023.

Rezultate e auditimit tregojnë se Komuna nuk ka arritur të ruajë dhe të rrisë vlerën e pronave të dhëna me qira.

Përmes auditimit është identifikuar se shfrytëzuesit e pronave nuk kanë realizuar investimet e parapara sipas kontratave, shfrytëzuesit e pronave komunale, kanë bartur të drejtën e shfrytëzimit tek palët e treta pa miratim paraprak nga Komuna.

Gjithashtu, Komuna nuk ka mbajtur kartela financiare të sakta për çdo kontratë dhe nuk i ka kryer aktivitetet për arkëtimin e qirasë sipas afateve të kontratuara.

Përmes këtij raporti, janë dhënë shtatë (7) rekomandime për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e veprimeve për të përmirësuar monitorimin dhe menaxhimin e pronave me qira në përputhje me ligjin, duke siguruar që të gjitha procedurat të zbatohen për të minimizuar humbjet financiare dhe për të përmirësuar transparencën në administrimin e pronave publike.

# *Kapitulli IV*

---

## *REKOMANDIMET E AUDITIMIT*



## Përmbledhje për zbatimin e rekomandimeve

Rëndësia e raporteve të auditimit qëndron në identifikimin e dobësive në sistemet e qeverisjes, veçanërisht të sistemeve financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si një mekanizëm për sanimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase dhe efektive në arritjen e objektivave. Analizat në këtë fushë kanë rezultuar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm.

Pas pranimit të RVA-së për vitin 2022, Qeveria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Në nivel të auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Krahasuar me vitin 2022, numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të organizatave buxhetore është zvogëluar, megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet jo i kënaqshëm, ku numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është në nivel prej 46% (përfshirë edhe NP), pjesa tjetër e rekomandimeve janë në proces të zbatimit ose nuk janë zbatuar ende.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit.

Ndikimi i auditimit, matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe është treguesi më i mirë nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar parregullsitë. ZKA-ja, përmes auditimeve individuale bën edhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak, duke i pasqyruar qartë fushat në të cilat janë marrë masa dhe veprime përmirësuese, si dhe fushat ku nevojiten veprime shtesë për përmirësime të më tutjeshme.

Në Raportin Vjetor të Auditimit për RVF-BRK 2023 janë dhënë gjithsej 19 rekomandime për Qeverinë.

Shtojca I e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA-2022, ndërsa Tabela 40 dhe 41 paraqesin statistikën e rekomandimeve për organizatat individuale.

## 1. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2022

Qeveria e Kosovës në tetor 2023 kishte aprovuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore (OB) për zbatimin e tij. Niveli i zbatimit të rekomandimeve do të monitorohet nga një mekanizëm i cili përcaktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në koordinim dhe me mbështetjen e Zyrës së Kryeministrit.

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve tjera, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një nivel të kënaqshëm të zbatimit të rekomandimeve.

Nga gjithsej 29 rekomandime të dhëna në RVA-në 2022, prej tyre dy (2) janë zbatuar, dy (2) ishin në proces të zbatimit, 15 nuk ishin zbatuar dhe 10 nuk aplikohen më (të njëjtat janë fuzionuar me rekomandime tjera). Shtojca i paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA 2022.

Moszbatimi i rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë dhe parregullsitë e caktuara të përsëriten veçanërisht në fushat, si:

- Mangësitë në përgatitjen e PVF-ve;
- Dobësi në procedurat e prokurimit;
- Mangësi në menaxhimin e pasurisë;
- Mangësi në menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, obligimeve; detyrimeve kontigjente;
- Dobësi në procedurat e subvencioneve; dhe
- Funksionimi jo i mirë i Komiteteve të auditimit dhe NJAB-ve.

## 2. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2022

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të përhershëm të auditimit. Vlerësimi se si dhe sa janë zbatuar ato, bëhet për secilën organizatë buxhetore gjatë auditimit të rregullt dhe rezultatet për vitin paraprak, paraqiten në raportet e auditimit për vitin vijues.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për gjendjen e rekomandimeve të vitit 2022 dhe 2021, të cilat janë të kategorizuara sipas organizatave të audituara.



Në vijim është paraqitur tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindjet e zbatimit të tyre.

Tabela 40 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2022

Subjektet e audituara	Nr. i rekomandimeve në 2022	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më <sup>25</sup>	Rekomandimet për zbatim	Të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara	
	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	166	11	155	76	49%	21	14%	58	37%
Institucionet e pavarura	53	1	52	31	60%	5	10%	16	31%
Institucionet e nivelit lokal	372 <sup>26</sup>	12	360	140	39%	19	5%	201	56%
Ndërmarrjet Publike	152	15	137	79	58%	10	7%	48	35%
Gjithsej rekomandimet	743	39	704	326	46%	55	8%	325	46%

Tabela 41 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2021

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve në 2021	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më	Rekomandimet për zbatim	Të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara	
	Nr.	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	185	5	180	88	49%	20	11%	72	40%
Institucionet e pavarura	55	1	54	39	72%	3	6%	12	22%
Institucionet e nivelit lokal	409	3	406	186	46%	33	8%	187	46%
Ndërmarrjet Publike	187	8	179	104	58%	70	39%	5	3%
Gjithsej rekomandime	836	17	819	417	51%	126	15%	276	34%

25 Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më - rrjedhin si rezultat i fuzionimit të tyre apo ndryshimeve të akteve ligjore

26 Në RVA për vitin 2022 janë raportuar 352 rekomandime të dhëna. Në këtë numër janë përfshirë edhe 20 rekomandime të dhëna në raportet e auditimit për vitin 2021, për komunat: Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, për arsye se në këto kumuna nuk është kryer auditimi për vitin 2022. Kështu që vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna është për 372 rekomandime.

Siç shihet edhe nga tabelat më lart, numri total i rekomandimeve të dhëna për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ka pasur një rënie nga 836 rekomandime të dhëna në 743 rekomandime, ndërsa numri i rekomandimeve të pazbatuara është rritur nga 34% në 46%. Prandaj niveli i rekomandimeve të pazbatuara apo që nuk ka filluar zbatimin është jo i kënaqshëm.

Vlenë të theksohet se në raportet e auditimit të performancës për vitin 2022, janë dhënë 195 rekomandime. Lidhur me rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Kosovës për auditimet e performancës, në këtë sezone audituese, Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka kryer ndonjë auditim përcjellës të rekomandimeve për të vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre.

Në përgjithësi, organizatat buxhetore përgatisin plane të veprimit për zbatim të rekomandimeve, megjithatë nuk ndjekin ndonjë proces formal të monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e përgjegjësisë për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim, identifikohen dhe adresohen.

Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha OB-të.

### 3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës kishte dhënë rekomandime për katër (4) raporte të auditimit të shqyrtuara për: Universitetin e Prishtinës, Telekomin e Kosovës, SHSKUK dhe RTK. ZKA ka trajtuar zbatimin e këtyre rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi, ku nga 10 rekomandime të dhëna, katër (4) rekomandime ishin zbatuar, tre (3) rekomandime në proces të zbatimit dhe tre (3) rekomandime nuk ishin zbatuar. Shtojca II paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Kosovës.

Po ashtu, dy (2) rekomandime që janë për ZKA-në lidhur me Procesin e shitjeve direkte nga AKP dhe rekomandimi që në Raportin vjetor për vitin 2023, të raportojë për shumën e subvencioneve që Qeveria ka ndarë për ndërmarrjet publike dhe të bëjë kategorizimin se për çka janë shfrytëzuar ato mjete, janë zbatuar plotësisht.

Përveç këtyre, Kuvendi i Kosovës kishte dhënë rekomandime edhe për raporte të auditimeve të performancës: “Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare”, “Funksionimi i Sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga donatorët për vitin 2021”, “Performanca financiare dhe operative e NP Trepça sha”, “Menaxhimi i projektit Bashkimi i qytetit të Ferizajit”, “Sistmi për Menaxhimin e Pagave”.

Lidhur me rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Kosovës për auditimet e performancës, në këtë sezone audituese, Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka kryer ndonjë auditim përcjellës të rekomandimeve për të vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. ZKA do të kryej kohë pas kohe auditime përcjellëse të zbatimit të rekomandimeve në të cilin do të përfshihen më shumë raporte se sa të një sezone audituese gjithashtu pas një planifikimi do të përfshihen edhe rekomandimet e KMFP-së dhe Kuvendit të Kosovës.

## 4. Ndikimi i auditimit

Raportet e ZKA-së kanë për synim nxitjen e ndryshimeve në sektorin publik duke përmirësuar qeverisjen në aspektin e menaxhimit financiar. Veprimet të cilat do të mund të ndërmerren si rezultat i procesit të auditimit do të bëjnë që pasqyrat financiare të paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të situatës financiare të organizatës buxhetore, duke rritur në këtë mënyrë cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar të ofruar.

Ndikimi i auditimit, matet me nivelin se si organizatat buxhetore janë korrigjuar nga çështjet apo rekomandimet që i kemi dhënë në vitin e kaluar, dhe është treguesi më i mirë nëse menaxhmenti po përmirëson politikat, proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku parregullsitë janë identifikuar.

Në përgjithësi ndikimi i auditimit në shumicën dërmuese të subjekteve të audituara ishte në përmirësimin e cilësisë të raportimeve financiare.

### Niveli Qendror

Bazuar në raportet e auditimit vërehen progres në përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar, me theks të veçantë në fushën e pasurive dhe të detyrimeve kontigjente.

Në fushën e pasurive si rezultat i auditimeve janë hasur përmirësime në regjistrat e pasurive, korrigjimin e vlerës së projekteve kapitale të mbajtur si investime në vijim, si:

- Projekti "Autostrada R6 Prishtinë – Hani i Elezit" në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), i mbajtur si investim në vijim është regjistrua si pasuri në përdorim, duke aplikuar zhvlerësimin (vlera e projektit 705,313,524€) me ndikim rreth 40,000,000€;
- Bartja e pasurive (19 shkollave) nga MASHT (17,827,579€); ME (10,000,000€), MKRS (994,306€), MMPHI (1,608,395€) dhe MINT (2,730,986€) të cilat kishin ndikimin në vlerë të përbashkët prej 30,430,280€; dhe
- Në SHSKUK janë evidente përmirësimet në mbajtjen e regjistrit të stoqeve, të cilat kishin ndikuar vlerën totale të këtij regjistri për 3,427,790€ dhe përmirësime të regjistrimit të tokës me ndikim 1,000,000€ në regjistër.

Më tej, për shkak të veprimeve të ndërmarra lidhur me prezantimin e drejtë të vlerës së detyrimeve kontigjente në PFV është vërejtur përmirësim i prezantimit të tyre në vlerë 4,741,000€ në ME, 1,590,000€ në MPB dhe 4,268,962€ në Fondin e Sigurimit Shëndetësorë (FSSH).

### Niveli Lokal

Në nivelin lokal, ndikimet përmes auditimeve në vlera më të theksuara janë evidentuar te Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Komuna e Novobërdës, të cilat kanë përmirësuar dukshëm çështjen e menaxhimit të pasurive duke i regjistruar pronat (tokat dhe objektet) të cilat nuk ishin të regjistruara në regjistrat kontabël të pasurive në vlerë totale për 221,434,089€.

- Komuna e Mitrovicës- ka arritur që nga viti 2022 të rrisë vlerën e pasurive në regjistra për 74,312,661€.
- Komuna e Novobërdos - ka arritur që nga viti 2022 të rrisë vlerën e pasurive në regjistra për 147,121,428€.

Po ashtu, përmes auditimit tone, kemi ndikuar që Komuna e Prishtinës të përmirësoj procesin e raportimit për kategorinë e detyrimeve kontigjente për 16,843,833€ në raport me vitin e kaluar.

## Ndërmarrjet Publike

Raportet e auditimit kishin ndikuar që ndërmarrjet të përmirësohen në proceset e menaxhimit dhe të raportimit financiar si, prezantimin e drejtë të investimeve në vijim, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportin vjetor brenda afatit kohor, prezantimin e saktë të detyrimeve kontigjente, rivlerësimi i pasurive ka ndikuar që vlera e pasurive e prezantuar në PFV të jetë më e lartë, azhurnimi i kontratave të punës, hartimi i rregulloreve të brendshme për menaxhimin e aktiviteteve në ndërmarrje.

---

*SHTOJCAT*











# Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2022






## Legjenda:









Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA-në 2022	Statusi
1 Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të siguroj se janë përmbushur kërkesat për raportim të plotë dhe të saktë në pasqyrat e shpalosjeve (anekseve).	I pazbatuar
2 Qeveria e Kosovës	Përmes ministrive përkatëse duhet të siguroj veprimet të mëtejshme për angazhimin e të gjithë të punësuarëve duke siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë, si dhe monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Pjesërisht i zbatuar
Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore		
3 Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të siguroj që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarrje, se janë bërë analiza të hollësishme dhe përgatitjet e duhura lidhur me projektet, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondëve.	I pazbatuar
4 Qeveria e Kosovës	Ngecjet apo dështimi në mos fillimin apo mos realizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjtat të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.	I pazbatuar
5 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MFPT-ja në bashkëpunim me ministrinë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuar, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MFPT-ja duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave.	I pazbatuar
6 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Të ofroj udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohen nga huamarrjet. MFPT duhet të filloj procedurat e negociimit vetëm nëse janë kryer të gjitha përgatitjet për fillimin e zbatimit të projektit dhe të ofroj siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i këtyre projekteve do të bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur.	Nuk është i aplikueshëm (është përfshirë në rekomandimin nr.3)

Analiza e buxhetit të shtetit			
7	Qeveria e Kosovës	Të sigurohet se ligji për ndarjet buxhetore dhe plotësim ndryshimet dërgohet në Kuvend së bashku me tabelat me ndryshim/plotësime për parashikimet fiskale.	I zbatuar 
8	Qeveria e Kosovës	Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së pasurisë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale.	I pazbatuar 
9	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të siguroj kontrolle efektive në proceset e buxhetimit me qëllim që shpenzimet të jenë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të LMFP-së dhe SNKSP-ve.	I pazbatuar 
10	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT të siguroj se planifikimi dhe realizimi i buxhetit bëhet sipas kodeve funksionale përkatëse në mënyrë që shpenzimet të paraqesin gjendjen e saktë të tyre sipas planit kontabël.	I pazbatuar 
Pasuritë			
11	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes MFPT duhet të sigurojë trajnime të mjaftueshme për zyrtarët e pasurisë dhe ZKF-të lidhur me procesin e regjistrimit të pasurive dhe prezantimin e saktë të tyre në Pasqyra financiare individuale.	Pjesërisht i zbatuar 
12	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes MPB-së duhet të sigurojë përdorimin e aplikacionit e-pasuria nga të gjitha organizatat buxhetore.	I pazbatuar 
Llogaritë e Arkëtueshme			
13	Qeveria e Kosovës	Qeveria në koordinim me MFPT dhe MAPL duhet të rivlerësojë mekanizmat aktual për inkasimin e borxheve, strukturën e tyre, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe. Po ashtu, duhet siguroj raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme.	I pazbatuar 
Detyrimet e Papaguara dhe ato Kontigjente			
14	Qeveria e Kosovës	MFPT duhet të vendos kontrolle përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe aty ku vëren devijime nga afatet ligjore të ndërmerren masa.	I pazbatuar 







15	Qeveria e Kosovës	Që përmes Ministrisë së Drejtësisë (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinim me zyret ligjore të organizatave buxhetore të verifikojë vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalesjet në RFV-të të jenë të sakta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korigjohen.	I pazbatuar 
Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përbarimore			
16	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes institucioneve relevante të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime të panevojshme nga proceset eventuale gjyqësore. Po ashtu, përmes akterëve të përfshirë në procesin e shpronësimit të ndërmarrë masa në evitimin apo zgjidhjen e kontesteve të shumta gjyqësore.	I pazbatuar 
17	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministri në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të siguroj që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përbarimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përbarimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.	I pazbatuar 
Të dhënat e punësimit			
18	Qeveria e Kosovës	Ministri, duhet të sigurojë se raportimi i të punësuarve aktual prezanton numrin real të të punësuarëve në administratën publike duke përfshirë të gjithë nëpunësit të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me organizatat buxhetore përkatëse dhe janë pjesë e sistemit të menaxhimit të pagave (Payroll).	I zbatuar 
Sistemi i auditimit të brendshëm			
19	Qeveria e Kosovës	Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta përmbushin përmes mënyrave tjera të parapara me rregullore.	I pazbatuar 

20	Qeveria e Kosovës	Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së, dhe që këto komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së, po ashtu të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA.	I pazbatuar 
Auditimet e Performancës <sup>27</sup>			
21	Qeveria e Kosovës	T'i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës, prokurimit dhe teknologjisë së informacionit si dhe të përgatisin dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt për veprimet përmirësuese.	Nuk është i aplikueshëm 
Ndërmarrjet Publike <sup>28</sup>			
22	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Që t'i forcojnë masat e llogaridhënies ndaj Bordeve Drejtuese dhe menaxhmentit, ku me rastin e shqyrtimit të pasqyrave financiare, të rishikojnë në detaje përmbajtjen e informatave në pasqyrat financiare, dhe të sigurohen se ato janë pa gabime, janë të mbështetura me evidencat kontabël dhe se i përmbushin të gjitha kërkesat e kornizës e zbatueshme të raportimit financiar.	Nuk është i aplikueshëm 
23	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Që përmes Bordeve Drejtuese ndërmerren masa që procesi i rivlerësimit të kryhet brenda një afati optimal. Duke qenë se arsyeja kryesore për mos kryerje të vlerësimit ishte mungesa e fondeve, Qeveria dhe komunat duhet ta mbështesin financiarisht këtë proces.	Nuk është i aplikueshëm 
24	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve	Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojnë se raportet vjetore, përfshirë edhe atë financiar, miratohen deri më 15 mars të vitit vijues, të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, dhe të njëjtën ditë pasqyrat financiare duhet të jenë të gatshme për auditim nga auditori i jashtëm.	Nuk është i aplikueshëm 
25	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve	Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojë se të analizohen shkaqet që kanë shkaktuar humbjet e deritanishme, dhe varësisht nga faktorët e identifikuar, të propozohen politikat dhe masat përmirësuese, si dhe të analizohet shuma e detyrimeve të pa paguara, dhe ato të paguhen në mënyrë që të shmangen ankesat/procedurat gjyqësore nga furnitorët.	Nuk është i aplikueshëm 






<sup>27</sup> Rekomandimi ju ka adresu subjekteve të auditura, të cilat janë të informuara për ndërmarrjen e veprimeve.



<sup>28</sup> Rekomandimet e mëposhtme për NP që janë me statusin "Nuk është i aplikueshëm" janë të pëfshira në këtë raport tek rekomandimi në Kapitullin III pika 2. Kjo për arsye se, individualisht të njëjtat janë adresuar tek Bordet Drejtuese dhe menaxhmentit të NP përkatëse.

26	Qeveria e Kosovës	Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura/ligjore në mënyrë që të qartësohet statusi i pronave të cilat shfrytëzohen nga ndërmarrjet publike, si dhe të procesi i planifikimit të prokurimit të jetë më gjithëpërfshirës. Po ashtu të siguroj që për pozitat me Ushtrues Detyre të zhvilloj procedura te rekrutimit me qëllim që të plotësohen me kontrata të rregullta dhe të fuqizoj kontrollet e brendshme në mënyrë që të pamundësojnë që punonjësit në pozitat e njëjta të paguhen me grada të ndryshme si dhe respektimin e kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të proceduarve të konkursit publik.	Nuk është i aplikueshëm 
27	Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve	Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojë se pasuritë e ndërmarrjeve harmonizohen me raportet e komisioneve te inventarizimit, të mbikëqyrë në mënyrë pro aktive të procesin e ekzekutimit të kontratave, të ndërmerr veprime korrigjuese që faturimi i klientëve të bëhet saktë. Po ashtu, të analizohet struktura dhe vjetërsia e llogarive të arkëtueshme	Nuk është i aplikueshëm 
28	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve	Që përmes Bordeve Drejtuese të marrin masat e përgjegjesisë së menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, me fokus të veçantë përcaktimin e qartë të një plani të veprimit, afatin kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të ZKA-së.	Nuk është i aplikueshëm 
Zbatimi i rekomandimeve			
29	Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të vendos një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve. Me OB-të, t'i diskutoj të gjitha masat efektive që mund ta përmirësojnë procesin, në veçanti fuqizimin e masave që forcojnë llogaridhënien dhe parandalojnë ngeçjet në zbatimin e rekomandimeve. <sup>29</sup>	Nuk është i aplikueshëm 

<sup>29</sup> Rekomandimet janë dhënë te secila pjesë e raportit dhe të gjitha janë për monitorim dhe zbatim

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës pas shqyrtimit të raporteve të auditimit

Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna nga Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike	Progresi në zbatimin e rekomandimeve
Shyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të UP-së për vitin 2021		
1 UP	Planifikimi buxhetor që bëhet për investimet kapitale në UP, procesi të jetë gjithëpërfshires për të gjitha njesitë akademike e që përfshin zhvillimin e buxhetit nga poshtë-lartë dhe se kërkesat buxhetore duhet t'i paraprijë një analizë e mirfilltë. Të përfshihet në planin strategjik orientimet për investimet kapitale në Universitetin e Prishtinës i cili i skadon afati në vitin 2022. Ka qenë planifikimi për vitet (2020-2022).	I Zbatuar 
2 UP	Rektorati i Universitetit të Prishtinës ti angazhojë të gjitha kapacitetet ligjore, nese ka mungesë të angazhojë ekspert të jashtëm ose ta angazhojë Avokatin e Popullit në mënyrë që të bëjë përfaqësim kualitativ ligjor në seancat gjyqësore në lidhje me çështjen e Kishës Ortodokse Serbe e ndërtuar në Kampusin e UP-së.	I pazbatuar 
3 UP	Rektori duhet ti intensifikojë punët dhe të kërkojë raportim 6 mujor nga komisioni i formuar, nëse është nevoja të themelohet edhe komisioni i ri ndërinstucionalë në menyrë që të definohet pronësia e pronave të UP-së me Komunën e Prishtinës, kufijtë kadastral, kalimi i atyre pronave në pronësi të UP-së, si dhe regjistrimi në gjeoportalin shtetëror.	Pjesërisht i pazbatuar 
Shyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të RTK-së-së për vitin 2022		
1 RTK	Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim me Bordin e RTK-së, t'i analizojë mundësitë, që në një afat sa më të shpejtë, RTK-ja ta ketë një objekt të përhershëm, që i plotëson kushtet e funksionimit të televizionit publik.	I pazbatuar 
Shyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të RTK-së-së për vitin 2021		
1 Telekom i Kosovës	Bordi i Drejtorëve të bëjë plan strategjik 2- vjeçar, për përmirësim të performancës financiare, për zhvillim strategjik të kompanisë, për zbatim të planeve dhe arritje të rezultatit pozitiv financiar.	Pjesërisht i zbatuar 

2	Telekomi i Kosovës	Të forcohen kapacitet e zyrës ligjore, në përfaqësim ligjor të kompanisë, nëse ka nevojë edhe angazhim të ekspertëve ligjorë ndërkombëtarë.	I zbatuar 
3	Telekomi i Kosovës	Qeveria të vazhdojë mbështetjen financiare për Telekom, në harmoni me planin strategjik dhe nga Bordi të kërkohen raporte financiare 6- mujore, për rezultate konkrete financiare.	Pjesërisht i zbatuar 
Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2021			
1	SHKSUK	Ministria e Shëndetësisë të sigurojë që emërimi i anëtarëve të Bordit të bëhet në pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.	I zbatuar 
2	SHKSUK	Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë kontrole të shtuara, sa i përket përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave vjetore financiare. Bordi dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë që zyrtari kryesor financiar të ketë përgatitjen profesionale, njohuritë dhe trajnimet e nevojshme, për të kuptuar dhe zbatuar drejt kërkesat e raportimit financiar. Pasqyrat vjetore financiare duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të mirëfilltë nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Drejtorëve.	I pazbatuar 
3	SHKSUK	Planifikimi i investimeve kapitale në spitalet rajonale, SHSKUK dhe identifikimi i nevojave për resurse njerëzore të bëhet në harmoni të plotë dhe bashkëpunim të ngushtë me MSH-në.	I zbatuar 

## Shtojca III: Llojet e opinioneve për OB-të e audituara në tri vitet e fundit

Tabela nr. 42 – Opinionet e auditimit të nivelit qendror për tri vite

Nr.	Subjektet e audituara	Opinionit i auditimit		
		2023	2022	2021
1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
2	Zyra e Presidentit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
3	Zyra e Kryeministrit	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
4	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
5	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
6	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
7	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
8	Ministria e Shëndetësisë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
9	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
10	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
11	Ministria për Komunitete dhe Kthim	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
12	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
13	Ministria e Ekonomisë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
14	Ministria e Punëve të Brendshme	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
15	Ministria e Drejtësisë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
16	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
17	Ministria e Mbrojtjes	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
18	Ministria e Zhvillimit Rajonal	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
19	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar I Kosovës	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
20	Fondi i Sigurimit Shëndetësor	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
21	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
22	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
23	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
24	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar

25	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
26	Agjencia Kosovare e Privatizimit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
27	Organi Shqyrtues i Prokurimit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
28	Universiteti i Prishtinës	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
29	Gjykata Kushtetuese	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
30	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
31	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
32	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
33	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
34	Këshilli Prokurorial i Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
35	Agjencia për Informim dhe Privatësi	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
36	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
37	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
38	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
39	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
40	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
41	Komisioni i Pavarur për Media	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
42	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
43	Insitucioni i Avokatit të Popullit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
44	Akademia e Drejtësisë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
45	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
46	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
47	Radio Televizioni i Kosovës	Kualifikuar	Kualifikuar	I kundërt
48	Fondet në Mirëbesim	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
49	Dogana e Kosovës <sup>30</sup>	-	Pamodifikuar	Pamodifikuar
50	Administrata Tatimore e Kosovës	-	Pamodifikuar	Pamodifikuar
51	Agjencia për Ndhmë Juridike Falas	-	Pamodifikuar	Pamodifikuar
52	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	-	Pamodifikuar	Pamodifikuar

30 Në vitin 2023, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë audituar në kuadër të MFPT-së; Agjencia për Ndhmë Juridike Falas në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe AMKMK në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Tabela nr. 43 – Opinonet e auditimit të nivelit lokal për tri vite

Nr.	Subjektet e audituara	Opinioni i auditimit		
		2023	2022	2021
1	Glogoc	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
2	Fushë Kosovë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
3	Lipjan	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
4	Obiliq	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
5	Podujevë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
6	Prishtinë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
7	Shtime	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
8	Graçanicë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
9	Dragash	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
10	Prizren	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
11	Rahovec	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
12	Suharekë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
13	Malishevë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
14	Mamushë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
15	Deçan	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
16	Gjakovë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
17	Istog	Pamodifikuar	Kualifikuar	I kundërt
18	Klinë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
19	Pejë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
20	Junik	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
21	Mitrovicë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
22	Skenderaj	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
23	Vushtrri	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
24	Gjilan	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
25	Kaçanik	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
26	Kamenicë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
27	Novo Bërd	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
28	Shtërpçë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
29	Ferizaj	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
30	Viti	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
31	Partesh	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
32	Hani i Elezit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
33	Klllokot	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
34	Ranillug	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
35	Zubin Potok	Kualifikuar	/	Kualifikuar
36	Zveçan	Kualifikuar	/	Kualifikuar
37	Mitrovica Veriore	Kualifikuar	/	Kualifikuar
38	Leposaviq	Kualifikuar	/	Kualifikuar



# Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinionëve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA

(shkëputur nga SNISA 200)

## Forma e opinionit

### Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(ëve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ëve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

## Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

## Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a. Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b. Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c. Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

## Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe i përhapur.

## Konkluzionet e auditimit

- **Konkluzioni i Pamodifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit;
- **Konkluzioni i Kualifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit, përveç ndonjë çështjeje të caktuar e cila përshkruhet te baza për konkluzion të pajtueshmërisë;
- **Konkluzioni i kundërt** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse nuk janë në pajtim me kriteret e përcaktuara të auditimit; dhe

- **Mohimi i konkluzionit** - Paraqet gjendjen kur auditori për shkak të pamundësisë për marrjen e dëshmive të duhura dhe pa pajtueshmërive të përhapura në shumë fusha, nuk është në gjendje të nxjerrë konkluzion lidhur me pajtueshmërinë.

## Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'Theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

# Shtojca V: Letër Konfirmimi/Komentet

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Nisje Org. Org. Jedini Org. Unit:	01/150	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.:	2172/24
M. i fazeve Broj stranica No. pages:	AM	Data Datum Date:	28.08.2024
PRISHTINËJA			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera –  
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

LETËR E KONFIRMIMIT PËR ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin vjetor të auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31.12.2023 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Nuk pajtohem me disa nga gjetjet dhe rekomandimet në përmbajtjen e Raportit. Gjetjet për disa pjesë janë jo-materiale kurse për disa të tjera janë probleme historike e të cilat nuk janë pasqyruar si të tilla. Detajet lidhur me këto mospajtime janë bërë të ditura përmes komenteve me shkrim të dërguar nga Ministria;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

  
 Hekuran Murati  
 Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Datë: 28 Gusht 2024, Prishtinë

Baza Ligjore për raportim financiar	Kërkesat nga Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik	Kommenti nga MFPT	Përgjigjet dhe Komentet e ZKA-së
<p><b>IPSAS -SNKSP.</b></p> <p>LMFPP, ne nenin 1.pika "2" dhe neni 46 pika "C" përcaktohet parimi i kontabilitetit te cilin e zbaton Qeveria e Kosovës për raportim, gjegjësisht: Baza e kontabilitetit dhe raportimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës sipas LMFPP është baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këto pasqyra financiare paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme dhe lëvizjen e gjendjes së parasë së gatshme.</p>	<p><b>Pasqyrat obligative sipas IPSAS-SNKSP</b></p> <p>IPSAS: faqe, 2218 paragrafi 1.3.4 Një njësi ekonomike duhet të përgatisë dhe paraqesë pasqyrat financiare të cilat përfshijnë komponentët e mëposhtëm:</p> <p>Një pasqyrë e arkëttimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme. Gjendjet e parave të gatshme të kontrolluara nga njësi ekonomike;</p> <p>Një Pasqyrë e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme (ne rastet kur buxheti publikohet).</p> <p>Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese;</p> <p><b>Anekse/informacione shtesë jo-obligative sipas IPSAS-SNKSP</b></p> <p>IPSAS: faqe, 2220 paragrafi 1.3.10 Njësitë ekonomike që raportojnë duke përdorur bazën e parasë së gatshme të kontabilitetit shpesh mbledhin informacion mbi zërat që nuk njihen në kontabilitetin e mjeteve monetare.</p>	<p>Qeveria gjegjësisht MFPT ka zbatuara kërkesat e LMFPP dhe SNKSP (parimi i parasë së gatshme) dhe ne draft RVA 2023 shihet dhe konfirmohet se Pasqyrat Financiare janë ne harmoni me LMFPP dhe SNKSP/IPSAS dhe te dhënat e prezantuara ne RVF 2023 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.</p> <p>Të dhënat ne Anekset e RVF sipas pjesës 2 të SNKSP-ve me bazë të parasë së gatshme ku njësitë ekonomike mund të japi informacion mbi zërat nuk njihen ne kontabilitetin e parave të gatshme dhe nuk janë pjesë që konsolidohen ne Pasqyrat Kryesore Financiare gjegjësisht në Pasqyrat obligative sipas IPSAS-SNKSP dhe nuk do duhej te ndikonin opinionin e auditimit për PF 2023.</p>	<p>Bazuar në LMFPP respektivisht paragrafi 1.2, obligon raportimin e shpalosjeve (pikat v,vi,vii). Gjithashtu edhe Rregullorja për raportim financiar 01/2017 paragrafi 2.3 definon llojet e raporteve që duhet përgatitur nga ana e OB-ve.</p> <p>Kërkesat e kornizës së zbatueshme të raportimit financiar përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e PF si edhe atë çfarë është një paketë e plotë e PF. Përveç kësaj neni 47 i LMFPP obligon Auditorin e Përgjithshëm (ZKA-në) që të jep opinion pikërisht mbi këto deklarata nëse prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.</p> <p>Sipas SNA 700 par. A26 Opinioni i auditorit mbulon setin e plotë të PF siç përcaktohet nga Korniza e Zbatueshme e Raportimit Financiar. Pasi që sipas legjislacionit tonë ekzistojnë dy pjesë të deklaratave financiare (pjesa e tabelave te bazuara në kesh dhe pjesa e raporteve ku përfshihen zërat zakonisht materiale siç janë pasuritë, llogarite e arkëtueshme, të pagueshme ose kontingjencat) si pjesë integrale e kompletit (setit) te PF atëherë objekt i auditimit do të jenë gjithë kompleti i PF duke marr parasysh materialitetin.</p>

Shembuj të llojit të informacionit që mund të mblidhet përfshijnë detaje të:

- a. Të arkëtueshmet, të pagueshmet, huazimet dhe detyrimet e tjera, aktivet jo-monetare dhe të hyrat dhe shpenzimet e grumbulluara;
- b. Angazhimet dhe detyrimet kontingjente; dhe
- c. Treguesit e performancës dhe arritjen e objektivave të ofrimit të shërbimeve.

Nuk ka ndryshim në raport.

# Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë

## Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

	Shënim	2023	2022	2021
		Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
<b>PRANIMET</b>				
Tatimet Direkte				
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	184,864	159,942	113,946
Tatimi në të ardhura personale	3	255,941	215,560	189,521
Tatimi në pronë	4	46,085	34,554	36,258
Tatime tjera direkte	5	3,403	3,773	2,440
		490,294	413,829	342,165
Tatimet Indiekte				
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	1,365,580	1,220,007	1,038,218
Detyrimi doganor	7	156,214	132,663	124,606
Akciza	8	554,989	517,264	501,295
Tatime tjera indirekte	9	101	313	565
		2,076,882	1,870,248	1,664,685
Kthimet tatimore				
Kthimet tatimore	10	-61,277	-67,069	-58,912
		-61,277	-67,069	-58,912
Të hyrat jo-tatimore				
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	148,074	149,311	129,563
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	62,511	55,596	57,271
Taksa koncesionare	13	25,980	18,404	16,972
Renta minerare	14	26,722	29,857	19,235
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	3,594	3,365	3,074
Të hyrat nga dividenda	16	-	-	10,000
		266,881	256,532	236,116
Huamarrja				
Huamarrja e jashtme shtetërore	17	96,745	98,198	117,334
Pranimet për shërbimin e nënhuazimeve	18	8,216	8,149	8,005
Huamarrja e brendëshme shtetërore	19	-141,805	5,854	144,247
		-36,845	112,201	269,586
Grantet dhe ndihmat				
Grantet e përcaktuara të donatorëve	20	13,823	9,738	16,800
Grantet e BE-së për energjinë	21	67,500	-	-
Grantet për mbështetje buxhetore	22	-	10,250	-
		81,323	19,988	16,800
Pranimet tjera				
Fondi i depozitave	23	4,547	5,548	4,462
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	24	37,877	11,387	11,387
Të hyrat e dedikuara	25	5,958	5,888	4,645
Financimi i njëhershëm i AKP-së	26	-	-	39
		2,865,640	2,628,552	2,490,973
<b>Gjithsej Pranimet</b>				
<b>PAGESAT</b>				
Opëracionet				
Paga dhe shtesa	27	767,305	653,436	668,124
Mallëra dhe shërbime	28	397,978	337,414	306,255
Shërbime komunale	29	28,779	25,952	25,287
		1,194,062	1,016,802	999,666
Transferet				
Subvencione dhe transfere	30	1,079,450	1,065,195	842,897
Shpenzimet kapitale				
Prona, impiantet, pajisjet, transferet	31	560,868	422,579	423,941
Pagesat tjera				
Pagesa e borxhit	32	89,163	83,322	111,192
Kredidhënia për ndërmarrjet publike	33	1,947	35,724	-
Kthimet e fondeve dhe depozitave	34	508	1,386	1,044
		2,925,998 <sup>1</sup>	2,625,008	2,378,740
<b>Rritje/(Zbritje) në para të gatshme</b>		-60,358	3,544	112,233
<b>Para të gatshme në fillim të vitit</b>	<b>35</b>	<b>445,734</b>	<b>442,189</b>	<b>329,955</b>
<b>Para të gatshme në fund të vitit</b>	<b>35</b>	<b>385,375</b>	<b>445,734</b>	<b>442,189</b>

<sup>1</sup> Përfshihen shpenzimet nga vendimet gjyqësore dhe përbarimore në shumë prej 51.9 milionë euro, detajet sipas kategorive në shenimet 27 deri 31.

## Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

	Shënim	2023				2022		2021	
		Realizimi	Buxheti	Buxheti	Ndryshimet	Realizimi	Realizimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	A	A	A	A
		'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €
<b>RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME</b>									
Tatimet direkte		490,294	504,516	504,516	14,223	413,829	342,165	342,165	
Tatimet indirekte		2,076,882	2,097,299	2,097,299	20,417	1,870,248	1,664,685	1,664,685	
Kthimet tatimore		-61,277	-76,380	-76,380	-15,103	-67,069	-58,912	-58,912	
Të hyrat jo-tatimore		266,881	261,200	261,200	-5,680	256,532	236,116	236,116	
Grantet dhe ndihmat <sup>2</sup>		81,323	97,500	97,500	16,177	19,988	16,801	16,801	
Huamarrja		-36,845	554,880	554,880	591,725	112,201	269,586	269,586	
Pranimet tjera <sup>3</sup>		48,382	42,377	42,377	-6,005	22,823	20,533	20,533	
<b>Gjithsej Pranimet</b>		<b>2,865,640</b>	<b>3,481,392</b>	<b>3,481,392</b>	<b>615,752</b>	<b>2,628,552</b>	<b>2,490,973</b>	<b>2,490,973</b>	
<b>RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME</b>									
Paga dhe shëtesa		766,557	768,935	745,528	2,378	652,641	667,312	667,312	
Mallra dhe shërbime		394,950	463,799	459,410	68,850	333,374	302,410	302,410	
Shpenzime komunale		28,778	34,168	34,136	5,390	25,950	25,287	25,287	
Subvencione dhe transfere		1,078,206	1,157,938	1,100,284	79,732	1,064,068	842,570	842,570	
Shpenzime kapitale		554,433	857,004	819,948	302,570	419,253	419,807	419,807	
Rezerva		-	357	5,442	357	-	-	-	
Interesi		42,215	46,855	46,855	4,640	35,039	30,881	30,881	
Të tjera <sup>4</sup>		60,859	189,411	173,255	128,552	94,684	90,473	90,473	
<b>Gjithsej Pagesat</b>		<b>2,925,998</b>	<b>3,518,467</b>	<b>3,384,858</b>	<b>592,469</b>	<b>2,625,008</b>	<b>2,378,740</b>	<b>2,378,740</b>	
<b>Rritja/(Zbritja) e parasë së gatshme</b>	36	<b>(60,358)</b>	<b>(37,075)</b>	<b>96,534</b>	<b>23,283</b>	<b>3,544</b>	<b>112,234</b>	<b>112,234</b>	

<sup>2</sup> Te planifikimi buxhetor përfshihen grantet e përcaktuara të donatorëve (12 milionë euro) si dhe grantet për mbështetje buxhetore (85.5 milionë euro, përkatësisht 75 milionë euro, si grante nga BE për energjinë), si fonde të planifikuara për pranim në vitin 2023.

<sup>3</sup> Përfshihen, të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, financimi i njëhershëm nga AKP dhe pranimet nga deponatat.

<sup>4</sup> Përfshihen pagesat e kryeqjësë, nen-huazimeve, granteve të përcaktuara të donatorëve, diskonti i letrave me vlerë, pagesat për antarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e deponitave (neto).



## Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

		2023	2022	2021
	Shënim	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
<b>Pasuritë financiare - paraja e gatshme</b>				
Banka Qendrore e Kosovës	37	345,232	419,664	423,322
Kuotat në IFN	38	8,395	8,210	3,734
Fondi në mirëbesim për zhvillim	39	3,566	3,256	2,636
Paratë e gatshme në transit	40	22,894	10,845	6,946
Llogaritë e Ambasadave të Republikës së Kosovës	41	3,899	2,527	2,068
Paratë e gatshme në dorë (arka) dhe avance te hapura	42	1,389	1,233	3,484
<b>Gjithsej pasuritë financiare dhe para të gatshme</b>		<b>385,375</b>	<b>445,734</b>	<b>442,189</b>
<b>Qëllimet specifike</b>				
Të përcaktuara nga donatorët	43	17,472	15,505	15,818
Të hyrat vetanake - niveli qendror	44	3,027	2,584	1,436
Të hyrat vetanake - niveli lokal	45	81,387	90,005	80,078
Fondi në mirëbesim për zhvillim	46	3,510	7,974	7,354
Të hyrat e dedikuara	47	3,431	2,285	467
Grantet (kontigjenca) e BE-së për energji	48	22,740	-	-
Të tjera	49	29,262	24,807	19,812
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	50	6,226	16,177	5,131
		167,056	159,337	130,095
<b>Bilanci i pashpërndarë i parasë së gatshme</b>		<b>218,320</b>	<b>286,396</b>	<b>312,094</b>
<b>Gjithsej Bilanci i Fondeve</b>	35	<b>385,375</b>	<b>445,734</b>	<b>442,189</b>

Zyra Kombëtare e Auditimit  
Lagjja Arbëria  
Rr. Ahmet Krasniqi, 210  
10000 Prishtina  
Republika e Kosovës